

**PROGRAME PËR PUNË
ME PRINDËRIT NË KOPSHTE
PËR FËMIJË**

Shkup, 2024

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen financiare dhe të ekspertëve nga projekti i BE-së "Rritja e cilësisë së edukimit dhe kujdesit parashkollor" EuropeAid/139823/IH/SER/MK

Titulli:

PROGRAME PËR PUNË ME PRINDËRIT NË KOPSHTË PËR FËMIJË

Botues:

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Për botuesin: Ministri Fatmir Limani

Autorë:

Olgica Stojiq

Renata Dedova

Redaktor:

Prof. Dr. Alma Tasevska

Përpunimi kompjuterik:

TEDI TREJD KOM sh.p.k. Shkup

Përkthimi dhe lektura:

KONTINEO sh.p.k. Shkup

Shtypshkronja:

TEDI TRADE COM sh.p.k. Shkup

Tirazhi:

100 kopje

CIP - Katalogimi në botim Biblioteka Kombëtare dhe Universitare

"Shën Kliment Ohridski", Shkup

ISBN: 978-608-249-615-3

COBISS.MK-ID 64684293

Viti dhe vendi i botimit: 2024, Shkup


Shënim

Përmbajtja e këtij programi është përgjegjësi e vetme e Archidata s.r.l. dhe partnerët e saj në konsorcium dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtje

| | |
|--|-----|
| PROGRAMI PËR PRINDËRIM POZITIV | 5 |
| 1.Hyrje..... | 6 |
| 2.Bazat teorike të programit për prindërim pozitiv | 8 |
| 2.1. Çfarë është prindërimi pozitiv?..... | 9 |
| 2.2.Vlerat themelore të programit - pranimi i fëmijës dhe pjesëmarrja | 11 |
| 2.3 E drejta e fëmijës dhe prindit për mbështetje | 13 |
| 3.Shtyllat kyçe të programit | 15 |
| 3.1. Për kë është i dedikuar?..... | 16 |
| 3.2. Kujdesi për shëndetin mendor të prindërve | 17 |
| 3.3. Ngritja e rrjetit për mbështetje ndër-sektoriale | 18 |
| 4. Programi i punëtorisë për prindër | 20 |
| 4.1. Qëllimi i programit | 20 |
| 4.2. Programi është dedikuar | 20 |
| 4.3. Të ftuarit e prindërve | 20 |
| 4.4. Struktura e trajnimit | 20 |
| 4.5. Vlerësimi | 21 |
| 4.6. Diseminimi | 21 |
| 5.Fletë pune | 32 |
| PROGRAMI PËR MBËSHTETJE TË FAMILJES PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË FËMIJËVE NË SHTËPI | 47 |
| 1.Hyrje..... | 48 |
| 2.Bazat teorike të programit | 50 |
| 2.1. Vlerat themelore të programit - pranimi dhe pjesëmarrja | 51 |
| 2.2. Çfarë është të mësuarit përmes pjesëmarrjes në rutina? | 52 |
| 2.3. Çfarë është të mësuarit përmes lojës? | 54 |
| 2.3.1. Leximi me fëmijën..... | 56 |
| 2.4. E drejta e fëmijës dhe prindërve për mbështetje | 58 |
| 3.Mbështetja kryesore e programit | 60 |
| 3.1. Kujt i dedikohet programi? | 60 |
| 4.Programi i punëtorive për prindërit..... | 62 |
| 4.1. Qëllimi i programit | 62 |
| 4.2. Grupi i synuar | 63 |
| 4.3. Prindërit mund të ftohen në trajnim | 63 |
| 4.4. Struktura e trajnimit | 63 |
| 4.5. Vlerësimi | 65 |
| 4.6. Diseminimi | 65 |
| 4.7. Rekomandim | 65 |
| 5.Fletë pune | 73 |
| PROGRAM SPECIFIK PËR MBËSHTETJE TË PRINDËRVE TË FËMIJËVE ME PENGESA NË ZHVILLIM | 91 |
| 1.Hyrje..... | 92 |
| 2.Bazat teorike të programit | 94 |
| 2.1. Marrëdhëniet dhe kujdesi cilësor janë themeli i zhvillimit të fëmijës | 94 |
| 2.2. Vlerat thelbësore të programit | 95 |
| 2.3. Rutinat në familje dhe lojërat si mundësi për zhvillim | 99 |
| 2.4. E drejta e mbështetjes për prindin dhe fëmijën | 101 |
| 3.Mbështetja kryesore e programit | 103 |
| 3.1. Për kë është ky program? | 104 |
| 4.Programi i punëtorive për prindër | 105 |
| 4.1. Qëllimi i programit dhe rezultatet për prindërit..... | 105 |
| 4.2. Grupi i synuar | 105 |

| | |
|--|------------|
| 4.3. Thirrja e prindërve në trajnim | 105 |
| 4.4. Struktura e trajnimit | 106 |
| 4.5. Vlerësimi | 106 |
| 4.6. Shpërndarja/diseminimi | 106 |
| 4.7. Rekomandim | 107 |
| 5.Fletë pune | 113 |
| PROGRAM SPECIFIK PËR MBËSHTETJE TË PRINDËRVE TË FËMIJËVE NGA MJEDISE TË NDRYSHME SHUMËKULTURORE | |
| 1.Hyrje..... | 122 |
| 2.Bazat teorike të programit..... | 123 |
| 2.1. Marrëdhëniet dhe kujdesi cilësor janë themeli i zhvillimit të fëmijës..... | 123 |
| 2.2. Vlerat thelbësore të programit | 124 |
| 2.3. Rutinat familjare si mundësi për zhvillim..... | 126 |
| 2.4. E drejta e mbështetjes për prindin dhe fëmijën | 127 |
| 3.Mbështetja kryesore e programit | 129 |
| 3.1. Për kë është ky program? | 130 |
| 4.Programi i punëtorive për prindër | 131 |
| 4.1. Qëllimi i programit dhe rezultatet për prindërit..... | 131 |
| 4.2. Grupi i synuar | 131 |
| 4.3. Thirrja e prindërve në trajnim..... | 131 |
| 4.4. Struktura e trajnimit | 131 |
| 4.5. Vlerësimi | 132 |
| 4.6. Shpërndarja/diseminimi | 132 |
| 4.7. Rekomandim | 132 |
| 5.Fletë pune | 140 |
| Literatura | 160 |



PROGRAMI PËR PRINDËRIM POZITIV



1. Hyrje

Mbështetja prindërore bazohet në dinjitetin e barabartë të prindërve dhe fëmijëve, si dhe në ndërveprimin cilësor ndërmjet fëmijës dhe prindërve nga njëra anë dhe praktikuesit me prindërit nga ana tjetër. Programi për prindërim pozitiv, si pjesë përbërëse e këtij koncepti, përmban pikënisje teorike dhe strategji konkrete që do t'i ndihmojnë prindërit të zhvillojnë aftësitë prindërore dhe aftësitë për ndërveprim pozitiv me fëmijët. Ekziston një konsensus i fortë se prindërit janë mësuesit kryesor dhe më të rëndësishëm të fëmijëve. Që nga lindja e fëmijës, familja është e përfshirë në zhvillimin dhe mësimin e fëmijës, ndërsa sot, kur prindërit përballen me sfida të shumta në jetën bashkëkohore, prindërimi meriton më shumë mbështetje. Programet për mbështetje të prindërimit në kopshte, ndër të tjera, kanë pikënisjen e tyre në të kuptuarit e faktit se mësimi dhe zhvillimi më i hershëm i fëmijës ndodh në familje dhe se përmes kontekstit familjar themeli i të mësuarit dhe zhvillimit të fëmijës ndërtohet në të gjitha kontekstet tjera, ndër të cilat kopshti është ndër të parët. Duke pasur parasysh se zhvillimi i hershëm është një periudhë e mundësive më të mëdha dhe ndjeshmërisë më të madhe, sa më shpejt të ofrohet mbështetje për pjesëmarrje cilësore të prindërve në nxitjen e zhvillimit dhe të nxënies të fëmijës, aq më të qëndrueshme mbeten efektet pozitive tek fëmija. Për të siguruar barazi dhe sinergji të praktikave edukative të prindërve dhe edukatorëve, është e nevojshme që programet për mbështetje të prindërimit të integrohen në programin ekzistues të institucioneve parashkollore, si specifike dhe të larmishme (KËSHILLIMORE PËR PRINDËRIT). Një mbështetje e tillë prindërore nxit zhvillimin e hershëm të çdo fëmije, kontribuon në realizimin me sukses të objektivave të programit të institucioneve parashkollore, përmirësimin dhe promovimin e shërbimeve dhe është bazë për bashkëpunim cilësor dhe partneritet me familjen, pasi riafirmon rolin e prindërve, duke bërë përpjekje që prindërit të ndërtojnë dhe avancojnë aftësitë e inkurajimit të mbështetjes dhe kujdesit. Kështu, programet mbështetëse bëhen të disponueshme për të gjithë prindërit, duke respektuar specifikat e kontekstit familjar dhe duke forcuar kapacitetin dhe ndjeshmërinë e profesionistëve/praktikuesve në kopsht për të punuar me prindërit. Kjo konfirmon rëndësinë e rolit të prindërve dhe kujdestarëve në krijimin e një mjedisi stimulues në kopsht dhe në shtëpi dhe përvojat e pasura të fëmijëve që nga mosha më e vogël.

Programi për prindërim pozitiv promovon universalitetin, orientimin drejt marrëdhënieve, rregullimin e intensitetit të mbështetjes, përqendrimin në nevojat e familjes dhe mbështetjen e përfshirjes së të dy prindërve në përkujdesë. Si koncept, ai përmban një sërë masash që merren me një qëllim - promovimin e prindërimit pozitiv, respektivisht ndërtimin e marrëdhënieve cilësore midis prindit dhe fëmijës, sepse marrëdhëniet janë themeli i zhvillimit. Programi është hartuar përmes një qasjeje universale që synon të mbështesë prindërit dhe kujdestarët në krijimin e një mjedisi stimulues për zhvillimin e fëmijës në të gjitha fushat (konjitive, emocionale, sociale, motorike dhe të ato të të folurit), si një mbështetje e njehershme për promovimin e mirëqenies së familjes dhe tejkalimin e sfidave me të cilat përballen shumica e familjeve në Maqedoninë e Veriut. Njëkohësisht, programi mundëson që tek prindërit të cilët kanë aftësi të çrregulluara të sigurohet pjesëmarrja e fëmijës në rutina dhe të mësuarit përmes lojës (stresi prindëror, ndjeshmëri më e ulët, shëndeti mendor i prindërve, stili i prindërimit, etj.), të planifikohet në mënyrë ekipore një mbështetje më intensive familjare. Duke pasur parasysh mundësinë e zbatimit të një qasjeje të diferencuar për mbështetjen e familjes, programi respekton kontekstin familjar dhe shumëllojshmërinë kulturore të familjeve. Pranimi i fëmijës lidhet në mënyrë negative me stresin - edhe atë zhvillimor (prindëror) edhe atë jo zhvillues. Në rrezik nga mospranimi janë të gjithë familjet të cilat ballafaqohen me stres më intensiv në përgjithësi, e në veçanti me atë që lidhet me kujdesin për fëmijët (pengesa zhvillimore të fëmijës, dhuna në marrëdhëniet ndër-prin-

dërore, përjashtim nga marrëdhënia ndër-prindërore, konteksti i ngjizjes - shtatzënia e padëshiruar...). Në këto familje nevojitet të punohet në mënyrë më intensive në pranimin e fëmijës, por edhe në pranimin e vetes si prind. Programi në veçanti i thekson pasojat e dëmshme nga dënimi fizik dhe mundëson zhvillim të programeve specifike për dhënien e mbështetjes prindërore, fëmijëve me pengesa në zhvillim, si dhe prindërve nga mjedise të ndryshme shumë-kulturore. Po ashtu, është hartuar të jetë elastike, kështu që organizata dhe institucione të ndryshme (OJQ, shoqata) në komunitet, mund të zbatojnë programin dhe ta integrojnë atë në ndërhyrjet dhe shërbimet ekzistuese për prindërit, duke ndërtuar Rrjet për mbështetje të vendosjes së partneriteteve në komunitetin lokal. Prandaj, programi është ndërveprues, në sajë të një hapësire të re për punë me familjet, që nuk nënkupton “të pritët” që familjet ti shprehin problemet, por ka për qëllim parandalimin dhe përmirësimin, si dhe dukshmërinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve për mbështetje të familjes në mënyrë që i gjithë publiku të jetë i vetëdijshëm për to dhe të sigurojë koordinimin e shërbimeve dhe burimeve. Programi e ndryshon perspektivën e punonjësve profesional në kopsht, sepse kërkon rishqyrtimin e praktikave personale dhe ndryshim të përqendrimit drejt anëve të forta të familjes, nën supozimin që të gjithë familjet, bile edhe ato më të cenueshmet, kanë kapacitet të nxisin zhvillimin e fëmijës. Ndjenja e efikasitetit dhe kompetencës në rolin e prindit është një nga rezultatet e programit, që kërkon të menduarit e përhershëm, ndjekje dhe vlerësim të programit, me qëllim të ndërtimit të kompetencave praktike dhe refleksive dhe përgjegjësi profesionale të të gjithë të punësuarve në kopsht.

Mirë se vini në Programin për prindërim pozitiv!

2. Bazat teorike të programit për prindërim pozitiv

Rëndësia e marrëdhënies prind-fëmijë në fëmijërinë e hershme - Hulumtimet tregojnë që zhvillimi i trurit është kumulativ dhe shumë i ndjeshëm ndaj ndikimeve nga mjedisi, kështu që përvojat e hershme, mjedisi dhe marrëdhëniet e vendosin bazën për zhvillimin e mëvonshëm. Mësimi dhe zhvillimi nuk mund të shihen të veçuara nga mjedisi fizik dhe psikik, ku **marrëdhëniet** luajnë rol kyç në mësim. Është e njohur që çdo ndërveprim (pozitiv, negativ, ose i munguar) kontribuon për zhvillimin e trurit të fëmijës dhe i vendos bazat për mësimin e mëvonshëm. Fëmija e përjeton botën përmes marrëdhënieve të cilat i vendos dhe zhvillon, ndërsa këto marrëdhënie e formësojnë dhe e përcaktojnë zhvillimin dhe të nxëniet e tij. Duke filluar nga ndërlidhja me kujdestarin primar në moshën më të hershme, përmes marrëdhënieve të cilat fëmija i zhvillon me të moshuarit tjerë dhe fëmijët, marrëdhëniet janë bazat fillestare dhe mbështetja mbi të cilat bazohet i tërë zhvillimi dhe mësimi.

Si ndërtohet marrëdhënia? Aftësia për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie është një proces i përjetshëm, por fillimi i saj disa nis para lindjes së fëmijës dhe mund të shihet në ditët dhe javët e para të jetës së foshnjës. Pas lindjes, fëmija është në mënyrë biologjike i “programuar” për ndërlidhje shoqërore. Fëmijët lindin si qenie shoqërore - ata janë të orientuar ndaj të tjerëve dhe në lidhje me ta janë të përgatitur të komunikojnë dhe të marrin pjesë në ndërveprim me mjedisin, por edhe të fillojnë, presin dhe të kërkojnë një ndërveprim të tillë (Shonkoff, Phillips, 2000; Dalli, White, Rockel, Duhn, 2011; Center for developing child, 2004–2020).

Sipas teorisë së ndërlidhjes afektive, lidhshmëria zhvillohet midis prindit dhe fëmijës, ndërsa fillon si një grup sinjalesh të lindura që thërrasin prindin pranë fëmijës (qarje, buzëqeshje, kontakt vizual etj.), përmes përsëritjes së vazhdueshme të ndërveprimeve (sinjalet dhe përgjigjet e prindërve ndaj tyre), me kalimin e kohës zhvillohet një lidhje afektive, në të cilën kontribuojnë aftësitë njohëse dhe emocionale të fëmijës dhe përvoja e kujdesit të butë (Berk, 2008). Cilësia e ndërveprimeve është bazë për formimin e lidhshmërisë së sigurt afektive, e cila konsiderohet për bazë të zhvillimit të kapacitetit për besim, marrëdhënie të qëndrueshme dhe cilësore gjatë tërë jetës, por edhe për funksionim shoqëror të shëndetshme dhe emocionale (de Wolf, van Ijzen-doorn, 1997; Cummings, Cummings, 2002; Esposito et al, 2017.). Marrëdhëniet cilësore të cilët e mbështesin mirëqenien dhe kompetencat e fëmijës nënkuptojnë lidhje afektive me një qenie tjetër njerëzore, qoftë prind, fëmijë tjetër, kushëri, fqinj, edukator ose cilido qoftë person tjetër që ka një rol të rëndësishëm në jetën e fëmijës. Mungesa e marrëdhënies së tillë me së paku një person, e ngadalëson zhvillimin dhe mund të ketë numër të madh të pasojave negative. Vendosja e marrëdhënieve të forta afektive, po ashtu e mbështet dhe fuqizon gatishmërinë e fëmijës të zbulojë, njoftojë dhe ti rishqyrtojë veçoritë e ndryshme të mjedisit të menjëhershëm fizik, social dhe simbolik dhe për t'u zhvilluar dhe mësuar përmes këtij procesi. Provat nga hulumtimet tregojnë se efektet më pozitive në zhvillimin e fëmijës fitohen nëse marrëdhëniet me fëmijën janë të *ngrohta, të kujdesshme, të përgjegjshme dhe të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe veçoritë e fëmijës*. (Shonkoff, Phillips, 2000).

Çfarë është kujdesi cilësor? – Pikëpamja bashkëkohore e prindërimit në fushën e zhvillimit të hershëm përmes konceptit të **kujdesit stimulus**, përcakton komponentët më të rëndësishëm të kujdesit cilësor për fëmijën. Ky koncept thekson se, për mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve, nga fëmijëria më e hershme është i rëndësishëm mjedisi në të cilin bashkohen **kujdesi për-kujdesës**, i cili është i orientuar kah nevojat fiziologjike, emocionale dhe sociale të fëmijës, si dhe nevojës së tij për pavarësi, dhe **kujdes stimulus**, i cili siguron mundësi për mësim i cili bazohet në hulumtim, lojë dhe pjesëmarrje. Koncepti i kujdesit stimulus (Britto PR, Lye SJ, Proulx K, et al., 2017) dallon pesë fusha të kujdesit stimulus, të cilat ndërthuren njëra me tjetrën: kujdesi për

shëndetin, kujdesi për të ushqyerit, kujdesi i përgjegjshëm, siguria, mundësitë e të mësuarit në fëmijërinë e hershme. Në të njëjtën kohë, përqendrimi i prindit në nevojat e fëmijës, aftësinë e tij për të vërejtur, njohur, kuptuar dhe për t'iu përgjigjur atyre, respektivisht **përgjegjshmëria**, njihet si çelësi i konceptit. Përgjegjshmëria nuk ka të bëjë vetëm në orientimin drejt nevojave fiziologjike të fëmijës, por edhe ndaj mënyrës në të cilën prindi i përmbush nevojat e fëmijës – mënyra në të cilën e ushqen fëmijën, mënyra në të cilën bisedon me të, mënyrën në të cilën e përfshin dhe në të cilën i mbështet kontaktet e tij shoqërore, që paraqet një nga themelet për zhvillim të sigurisë emocionale në marrëdhëniet e prindit dhe fëmijës. Përpos në lojëra, përgjegjshmëria është e dukshme edhe në fjalimin që i drejtohet fëmijës, qasja e prindit në të ushqyerit e fëmijës (Black, Aboud, 2011) dhe në një sërë ndërveprimesh tjera të cilat kontribuojnë për një mjedis stimulues (Richter, 2004; Eshel, Daelmans, Cabral deMello, Martines, 2006).

2.1. Çfarë është prindërimi pozitiv?

Kur flasim për prindërim pozitiv, në fakt flasim për kuptimin ose vizionin për prindërimin mbi bazat e Konventës së KB për të drejtat e fëmijës, por edhe mbi njohuritë shkencore për kujdesin cilësor ndaj fëmijës, që supozon përmbushjen e nevojave themelore psikologjike të fëmijës për lidhje, kompetenca dhe autonomi dhe nënkupton përfshirjen, krijimin e strukturave, si dhe mbështetjen për mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve. Prindërimi pozitiv ka të bëjë me një lloj të prindërimit në të cilin sjellja prindërore është e orientuar drejt interesit më të mirë të fëmijës dhe e cila është e ndjeshme, plotësuese dhe jo agresive, dhe e vendos theksin në njohjen e gabimeve dhe orientimin drejt mënyrave për përmirësimin e këtyre gabimeve, sepse ato janë të rëndësishme edhe për zhvillimin e mëtutjeshëm (Rodrigo, 2010). Njëri nga përkufizimet për prindërim pozitiv thotë se ajo është një marrëdhënie e vazhdueshme e prindit dhe fëmijës apo fëmijëve, e cila përshin kujdes, mësim, udhëheqje, komunikim dhe përmbushje të vazhdueshme të nevojave të fëmijës. Në një studim gjatësor shtatëvjeçar (anketë e përsëritur) Pettit, Bates dhe Dodge (1997), e hulumtonin ndikimin e stilit pozitiv prindëror tek fëmijët e moshës parashkollore. Prindërimi mbështetës u lidh me përshtatjen më të mirë më vonë në shkollë dhe me më pak probleme në sjellje. Për më tepër, ky lloj prindërimi në fakt zbuti ndikimin negativ të faktorëve të rrezikut si varfëria, stresi në familje dhe prindërimi i vetëm në problemet shtesë të sjelljes së fëmijëve. Këto dhe studime të tjera të shumta tregojnë se marrëdhënia midis fëmijës dhe prindit është e një rëndësie vendimtare për zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe socializimin e tij të suksesshëm. Prindërimi pozitiv bazohet në mësimet e psikologjisë zhvillimore dhe teorisë së mësimin social dhe mbështetet në qëndrimin se fëmijët vijnë në botë me veglat dhe kapacitetet themelore për të arritur rrugëtimin e tyre të rritjes dhe zhvillimit optimal. Kur prindërit posedojnë njohuri të caktuara për zhvillimin e fëmijës, veçanërisht kur janë të vetëdijshëm për kthesat zhvillimore dhe kuptojnë se çfarë fshihet pas sjelljeve të caktuara, ata janë të aftë tu përgjigjen sfidave të prindërimit. Prindërit e tillë në mënyrë më precize i përcaktojnë aftësitë e fëmijës së tyre, janë më tolerantë dhe i mbështesin shkathtësitë e fëmijëve të tyre. Ata reagojnë ndaj fëmijës së tyre dhe komunikojnë me të me ndjeshmëri emocionale, ndërsa ambienti karakterizohet me ngrohtësi. Ata krijojnë lidhje me fëmijët e tyre dhe i forcojnë marrëdhëniet përmes bisedës, leximit ose rrëfimit të tregimeve. Po ashtu, ata krijojnë mjedis optimal dhe (më të) përshtatshëm për mësim, ashtu që fëmijëve u vënë në dispozicion materiale të cilat janë të përshtatura për moshën e tyre dhe nivelin e zhvillimit të tyre momental. Rezultati është që fëmijët e atillë kanë të arritura më të mira - siç janë nota më të mira në shkollë, vetëbesim më të madh, funksionim më të mirë social dhe më pak probleme në sjellje - meqenëse kanë kontroll më të mirë emocional të sjelljes.

Prindërimi pozitiv nënkupton që fëmija të jetë i sigurt, i shëndetshëm, nevojat e tij për ushqim adekuat dhe të llojllojshëm të jenë të përmbushura, prindi të ndjek fëmijën dhe të reagojë ndaj nevojave dhe interesimeve të tij, ta mbështes në hulumtim dhe komunikim me mjedisin e tij.

Njëri nga pesë komponentët e kujdesit stimulues (Black, et al., 2017), mbi të cilën mbështetet programi, është komponenti për **mundësi për mësim të hershëm** dhe ka të bëjë me të gjithë mundësitë e disponueshme për përfshirje të fëmijëve në ndërveprim me njerëz dhe objekte në mjedis. Në këtë komponentë theksi është vënë në rëndësinë e sigurimit të mundësive për lojë, bisedë dhe lexim me fëmijën, pjesëmarrje në rutina familjare, në aktivitetet në amvisëri dhe familje, si dhe sigurim të qasjes dhe përfshirjes në programet për mësim të hershëm (edukim parashkollor dhe arsimi).

Komponentë e rëndësishme e kujdesit stimulues në program është edhe **kujdesi reagues**, me të cilin sigurohet siguria emocionale të fëmijët, mirëqenia mendore dhe shëndeti i përgjithshëm. Shkencat neurologjike tregojnë se ky komponent, si një aspekt i kujdesit stimulues, është thelbësor për zhvillimin e shëndetshëm të trurit, ndërsa kujdesi joadekuat prindëror mund të shkaktojë stres emocional dhe ankth tek të porsalindurit, foshnjat dhe fëmijët e vegjël, gjë që më vonë ndikon në strukturën dhe funksionin e trurit, e me vetë këtë edhe ndaj zhvillimit të mëtejshëm gjatë gjithë jetës. Në fëmijërinë e hershme, fëmijët mbështeten në shkathtësitë e prindërve të tyre që ti njohin dhe përmbushin në kohë dhe në mënyrë adekuate nevojat e tyre. Këto nevoja kanë të bëjnë me të ushqyerit dhe sigurinë, si dhe me përfshirjen sociale, stimulimin konjitiv, rregullimin dhe kanalizimin e ndjenjave. Kur prindi i mbikëqyr, ndjek dhe i kupton sinjalet e fëmijës, atëherë mund të reagojë ndaj tyre në mënyrë të qëndrueshme dhe adekuate, duke i dhënë mundësi fëmijës të hulumtojë dhe të mësojë për veten dhe botën. Për këtë arsye, kjo komponentë e kujdesit stimulues në fakti e përcakton cilësinë e ndërveprimit me prindin/kujdestarin. Reagimi i prindit nënkupton që ai ti vërejë dhe përgjigjet ndaj sinjaleve të fëmijës, siç janë: buzëqeshja, lëvizja, zëri, gjestet dhe kërkesat verbale. E sipërpërmendura, shpesh shihet si një proces në tre hapa: mbikëqyrje (prindi i vëren shenjat e fëmijës), interpretim (prindi i interpreton shenjat në mënyrë të drejtë) dhe veprimi (sjellja e prindit me të cilën reagon në mënyrë adekuate ndaj nevojave dhe sinjaleve të fëmijës). Në këtë mënyrë nxitet zhvillimi i hershëm i fëmijës, për të cilën prindi jep mbështetje. Prindërimi adekuat kontribuon për sigurinë emocionale, stimulon besim dhe ndjenë të përkatësisë, e ndërton bazën për kompetenca socio-emocionale (p.sh. vetëkontroll, motivim për veprim, aftësi për veprim të qëllimshëm). Kur prindërit janë të ndjeshëm dhe përgjegjës në marrëdhëniet me fëmijën, fëmijën njohin siguri, parashikim dhe ngrohtësi në sjellje dhe ndërtohet një lidhje e sigurt afektive e cila i mundëson fëmijës të hulumtojë dhe mësojë. Së bashku me mjedisin e tij, para së gjithash familja përmes marrëdhënieve me të, fëmija ndërton njohuri për veten dhe botën rreth tij - për gjësendet të cilat e rrethojnë, hapësirën, të moshuarit rreth tij dhe marrëdhënien me to. Fëmijët mësojnë përmes situatave të cilat janë të rëndësishme për to dhe të cilat kanë kuptim logjik, prandaj është me rëndësi që fëmija të ketë lidhje në të cilat ai ndjen siguri dhe mirëqenie - si dhe liri për të hulumtuar dhe për të marrë pjesë në jetën familjare. Në moshë të hershme, çdo situatë shihet si mundësi për mësim. Domethënë, fëmija mëson përmes situatave të ndryshme - lojë (e cila i mundëson të hulumtojë, të jetë kreativ, të komandojë me objektet rreth tij), pastaj mëson përmes ritualeve të ndryshme dhe rutinave në familje, si dhe në situata jetësore në të cilat merr pjesë e tërë familja.

Pjesëmarrja e fëmijëve në të gjithë situatat me të cilat ballafaqohen u mundëson të shkëmbejnë përvoja dhe ndjenja, që po ashtu u ndihmon të ndërtojnë marrëdhënie me të tjerët. Fëmijët janë të gatshëm të mësojnë që nga lindja dhe kanë rol të rëndësishëm në formësimin e mësimin të tyre, ndërsa rol të tillë kanë edhe në ndërveprimet me prindërit, në të cilat zhvillohet mësimi. Në moshën më të hershme, shkathtësitë dhe kapacitetet përfitohen përmes ndërveprimeve të tilla - përmes të qeshurit, kontakteve me sy, të folurit dhe të kënduarit, afërsisë fizike, modelimit dhe imitimit, si dhe përmes lojërave të thjeshta. Këto ndërveprime u ndihmojnë fëmijëve të mësojnë për të tjerët, prandaj fëmijët kanë nevojë për kujdes adekuat në mjedis familjar, përmes përfshirjes në aktivitetet dhe marrëdhëniet e përditshme me të tjerët - që u jep fëmijëve përvoja të rëndësishme nga fëmijëria e hershme. Ndërveprimet cilësore me të moshuarit, si dhe me hapësirën

dhe materialet përreth tyre, e mbështesin zhvillimin e fëmijëve në persona të shëndetshëm dhe të lumtur - tani dhe në të ardhmen. Mundësimi i mësimit të tillë të hershëm kontribuon për mirëqenien e përgjithshme, shëndetin fizik dhe mendor, arritjet akademike më tej gjatë jetës.

2.2. Vlerat themelore të programit - pranimi i fëmijës dhe pjesëmarrja

Vlerat themelore të programit janë *pranimi i fëmijës dhe krijimi i mundësi për pjesëmarrje të fëmijës*. Pranimit të fëmijëve, shkathtësive, interesimeve, reagimeve të tij, u paraprin lidhja me fëmijën (gatishmëria e prindit për të investuar emocionalisht te fëmija), si dhe ndjekja e sjelljes së fëmijës (sinjalet), e me këtë edhe njoftim me fëmijën. Lidhja, ndjekja dhe pranimi i fëmijës janë themeli mbi të cilin më vonë ndërtohet shkathtësia e prindit për të krijuar mundësi për mësim dhe zhvillim. Prindërimi kërkon edhe një hap para në kuptimin e fëmijës si vetvetiu kompetent dhe me vlerë. Fotografia e fëmijës si qenie kompetente, e pasur me potencial, pjesëmarrës aktiv në shoqëri, qenie për lojë dhe qenie e dedikuar për mësim, janë vlerat të cilat duhet ti këmbëjnë edhe prindërit edhe punonjësit profesional. Kompetenca e fëmijës nuk është diçka që fëmija e posedon vetvetiu, por kompetenca ndërtohet përmes marrëdhënieve me të moshuarit dhe varet nga cilësia e këtyre marrëdhënieve, respektivisht nga ajo se sa inkurajuese dhe mbështetëse janë këto marrëdhënie. Që fëmija të mund të manifestojë potencialin e tij, duhet të ketë mjedis stimules dhe mbështetës dhe duhet të jetë i mbrojtur nga dënimi fizik. Fëmija lind kureshtar dhe ka motivim të lindur për të mësuar dhe kuptuar, por fëmija mëson në ato situata të cilat janë të lozonjare dhe të bazuara në vullnetarizëm, iniciativë, dinamizëm, negociim, përkushtim, çiltërsi dhe pyetje. Fëmija është një qenie shoqërore, e përqendruar në marrëdhëniet me të rriturit dhe pjesëmarrës aktiv në proceset në familje dhe kopsht, si komunitete ku ai bën pjesë. Fëmija duhet të shihet si diçka e shkathtë dhe kompetente për t'iu përgjigjur nxitjes nga mjedisi ose reagimit të prindit, por meqë fëmija nuk komunikon vetëm me fjalë por edhe në mënyrë jo verbale, baza e këmbimit është lidhja midis fëmijës dhe prindit, që i bën ata të koordinuar në iniciimin, kuptimin dhe kthimin e përgjigjes. Kur fëmija shihet si kompetent dhe pranohet si i tillë, me përqendrim në forcat, aftësitë, shkathtësitë dhe potencialin e tij, PRAKTIKAT EDUKATIVE të të moshuarve mund të ofrojnë shumë mundësi për PJESËMARRJE të fëmijës në jetën e familjes dhe në kopsht.

Fëmijët zhvillojnë dhe ndërtojnë kuptim dhe njohuri, pritje dhe shkathtësi në mënyrë të integruar, përmes lidhjeve dhe përvojës kontekstuale. Pa dallim nëse bëhet fjalë për mjedis familjar, kopsht, mjedis shoqëror ose komunitet më të gjerë, natyra dhe cilësia e marrëdhënieve të cilët vendosen me fëmijën dhe ato të cilët i vendos fëmija, janë bazë për mësim dhe zhvillim të suksesshëm. Reagimi i të moshuarve dhe veprimet e tyre ndikojnë në ndjenjën e vetëbesimit te fëmija, aftësia për mësim dhe ndjenjës në rritje të përkatësisë ndaj një komuniteti të caktuar. Këto ndërveprime, po ashtu u japin të moshuarve mundësi për mësim, për zhvillim dhe për ndryshim, duke e njohur përmes tyre fëmijën, veten dhe natyrën dhe rëndësinë e funksionimit të njeriut. Fëmija mëson përmes marrëdhënieve me njerëz, vende dhe gjëra, e njofton dhe e kupton botën përmes aktiviteteve personale në ndërveprim dhe komunikim me të tjerët. Përvoja nga **pjesëmarrja** në aktivitete të përbashkëta, edhe me të moshuar edhe me bashkëmoshatar, e nxit zhvillimin e fëmijës. Marrëdhëniet janë bazë dhe kontekst i përhershëm në të cilin fëmija mëson se si veprimet e tij ndikojnë në reagimet e të tjerëve, se si të hulumtojë në mënyrë të sigurt mjedisin e tij dhe si ti interpretojë dhe të ballafaqohet në mënyrë konstruktive me një spektër të gjerë ndjenjash, mendimesh dhe përvojash. Marrëdhëniet e ndërtojnë besimin dhe vetëbesimin e tyre për të vendosur lidhje të menduara me fëmijë dhe të moshuar tjerë, si dhe me vende, gjëra dhe njerëz në bashkësinë e tyre. Përmes pjesëmarrjes në familje, me familjarë, bashkëmoshatarë nga rrethi i menjëhershëm, fëmijët mësojnë vlera, besime dhe praktika të cilët e lidhin mjedisin e tyre shoqëror dhe u mundësojnë të kontribuojnë për komunitetin. Fëmija mëson jo vetëm nga ajo që e

shih dhe përjeton rreth tij, por edhe nga aktivitetet e tij, por edhe nga mënyra në të cilën e trajtojnë të tjerët. Të qenit anëtar i familjes dhe bashkësisë, i ndihmon fëmijës të zhvillojë vlera, duke e formësuar fëmijën si individ. Lidhja me të tjerët dhe ndjenja e autonomisë zhvillohen së bashku. Përmes lidhjeve afektive të sigurta, ndjenjës për forcë identiteti personal dhe grupor, fëmijët zhvillojnë vetë respekt, pavarësi, këmbëngulje dhe qëndrueshmëri (aftësi të kundërvihen, ti zvogëlojnë dhe ti tejkalojnë pasojat e rrezikshme nga vështirësitë dhe të ndërtojnë qasje konstruktive ndaj problemeve). Qëndrueshmëria e përfshin aftësinë e fëmijës për tu ballafaquar me presionet, streset dhe sfidat e përditshme, të vendos qëllime të qarta dhe reale, të zgjedh probleme, të jetë i suksesshëm me të tjerët dhe të respektojë veten dhe të tjerët. Fëmijët komunikojnë me grupe dhe individ të ndryshëm shoqëror, ballafaqohen me përvoja të ndryshme në mjedise të ndryshme, si dhe me kalime në situata dhe mjedise të reja. Aftësia për përshtatje ndaj ndryshimeve përcaktohet nga ajo se sa mirë ndjehet fëmija - i kënaqur me veten, i pranuar dhe i fuqishëm dhe anasjelltas. Suksesi në ballafaqimin me ndryshimet e fuqizon mirëqenien e fëmijës, vetëbesimin dhe identitetin pozitiv. Kompetencat e fëmijës janë në proces të zhvillimit dhe si të tilla nuk janë diçka që fëmija e posedon vetvetiu, por manifestohen nëpërmjet marrëdhënies midis fëmijës dhe kontekstit në të cilin mbështetet kompetenca. Me fjalë tjera, kompetencat fëmijërore janë pjesë e sistemit të fëmijës - kontekst, ndërsa kur dhe si do të manifestohen varet nga cilësia e kësaj marrëdhënie - sa stimulues dhe mbështetës është. Nga këtu rrjedh se marrëdhëniet e fëmijëve dhe të moshuarve janë kyçe si rregullues kritik të zhvillimit. Pjesëmarrja e fëmijës është e përcaktuar nga qëndrimet dhe besimet e prindërve për prindërimin dhe mënyrën në të cilën prindërit i kuptojnë rolet e tyre, gjë që e përcakton stilin e tyre të prindërimin dhe stimulimin e mjedisit në të cilin rriten fëmijët. Prandaj në praktikë gjejmë variante të ndryshme të kapaciteteve prindërore për krijimin e kontekstit familjar stimulues, ndërsa fëmijët rriten në mjedise që mund dukshëm të dallojnë lidhur me cilësinë dhe stimulimin e tyre. Teoria e Roner për **pranimin** dhe refuzimin nga ana e prindërve bazohet në teorinë e socializimit dhe zhvillimit jetësor (Rohner and Khaleque, 2010) dhe i parashih mënyrat në të cilat pranimi dhe refuzimi prindëror ndikojnë në zhvillimin emocional, konjitiv dhe bihevioral të fëmijës, lidhur me një dimension, e ai është ngrohtësia prindëror - si refuzim prindëror dhe pranim prindëror. Dimensioni i pranimit është i lidhur me lëvdata dhe afërsi përmes puthjes, përqaimit dhe përkëdheljes. Pranimi si aftësi për inkurajim cilësor që bazohet në pranim, kuptim, lidhje dhe besim, u mundëson prindërve të krijojnë një mjedis stimulues i cili kontribuon për zhvillim optimal të fëmijës.

Pjesëmarrja është proces i vendosjes së përbashkët për gjëra që na prekin dhe ndikojnë në jetët tona dhe komunitetin në të cilin jetojmë. Të moshuarit duhet ti shohin fëmijët si kompetentë, për interesat, nevojat dhe dëshirat e të cilëve pikërisht ata duhet të mbajnë llogari. Nuk ekziston kufi i poshtëm i të drejtës për pjesëmarrje - fëmijët mund të marrin pjesë në çfarëdo moshe. Mënyra në të cilën fëmijët marrin pjesë duhet të jetë e përcaktuar sipas kapaciteteve të tyre zhvillimore, përvojës dhe interesimeve. Edhe foshnjat, edhe fëmijët e vegjël kanë mendimin e tyre dhe aftësinë për tu shprehur, ndërsa ajo që ndryshon me moshën, janë format e të shprehurit. Nga lindja, fëmijët fillojnë të zhvillojnë aftësi dhe kompetenca pjesëmarrëse. Respektimi i kompetencave dhe aftësive të fëmijëve nga ana e të moshuarve të afërm dhe në mjedis, e rrit dhe mbështet zhvillimin e tyre. Kapacitetet e fëmijëve shpesh nënvlerësohen, meqë të moshuarit i shohin nga perspektiva e tyre dhe për atë shkak se të moshuarit nuk ia dalin të krijojnë mjedis në të cilin fëmija do të mund ti artikulojë pritjet, qëndrimet dhe kompetencat e tij. Kur fëmijëve u jepen mundësi për pjesëmarrje, ata zhvillojnë nivele më të larta të kompetencës, që nga ana tjetër e rrit cilësinë e pjesëmarrjes. Fëmijët mësojnë përmes pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta (rutina familjare, rituale, lojëra) me të moshuar dhe fëmijë të tjerë. E drejta për pjesëmarrje për fëmijën do të thotë zbulim i botës përmes përvojës së drejtpërdrejtë me njerëz, fëmijë tjerë, ngjarje, mjete, ide dhe të drejtë për zgjedhje. E drejta për pjesëmarrje do të thotë përfshirje në procesin e vendimmarrjes, nga mikro-plani (çfarë do të luajnë) deri te makro-plani. Fëmijët kanë nevojë

për mundësi për: pjesëmarrje aktive; të jenë të përfshirë në vendimmarrje dhe zgjedhje; të shkëmbejnë informata dhe të marrin pjesë në dialog me fëmijë tjerë dhe të moshuar; të ndjejnë respekt reciprok dhe shkëmbim; të konsultohen dhe të ndjejnë se ndjenjat dhe mendimet e tyre janë të rëndësishme; të shohin që idetë, pritjet dhe ndjenjat e tyre shpijnë drejt ndryshimit; se me pjesëmarrjen e tyre kontribuojnë për diçka që e bëjnë të moshuarit dhe konsiderojnë se është e rëndësishme dhe kuptimplotë. Përmes marrëdhënive pjesëmarrëse, fëmija: e fuqizon ndjenjën për mirëqenie dhe vetë respekt; zhvillon aftësi metakognitive për arsyetim, mendim, planifikim dhe parashikim; mëson si të riprodhojë praktikën përmes lojës dhe me kalimin e kohës ta transformojë; mëson si të shprehet, ti kuptojë të tjerët; mëson për ndërvarësinë, shkëmbimin, përzgjedhjen dhe vendin e tij në botë; mëson si ti zgjidh problemet dhe të ndërmerë përgjegjësi dhe të ndërtojë kuptim dhe qëllim.

Përpos mënyrës së kuptimit të fëmijës, në pjesëmarrjen e fëmijës ndikojnë edhe njohuritë e prindërve dhe edukatorëve për atë se si mëson fëmija dhe cilësia e marrëdhënies me fëmijën dhe rreth fëmijës. Mjedisi i cili siguron dhe promovon pjesëmarrje të fëmijëve, i fuqizon aftësitë e fëmijëve dhe krijon mundësi për fëmijët të praktikojnë pjesëmarrjen, gjë që e bën këtë një normë shoqërore. Pjesëmarrja nga fëmijëria e hershme zhvillon vetë-efikasitet, vetëbesim, përvetësim të aftësive dhe njohurive të cilët sigurojnë pjesëmarrje në jetën e mëtejme, zhvillim të vlerave personale, përvojë të përmbushjes dhe njohje të të drejtave personale (jo ata ligjore, por në marrëdhëniet ndër-njerëzore).

2.3 E drejta e fëmijës dhe prindit për mbështetje

E drejta e çdo fëmije për mjedis stimulues buron nga fakti që zhvillimi i hershëm është periudhë e ndjeshmërisë më të madhe dhe mundësive më të mëdha për mësim dhe zhvillim. Mbështetja për zhvillim të hershëm është njohur si një nga prioritetet e:

Konventa e KB për të drejtat e fëmijës thekson që fëmija ka të drejtë të zhvillohet “deri në masën më të lartë të mundur” dhe se vendet nënshkruese duhet të sigurojnë “ndihmë adekuate për prindërit dhe kujdestarët ligjor në kryerjen e obligimit të tyre për edukim të fëmijëve dhe të sigurojnë zhvillim të institucioneve, objekteve dhe shërbimeve për kujdes të fëmijëve”.

Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara përkujton se “nëse fëmijët e vegjël me aftësi të kufizuara identifikohen herët dhe marrin mbështetje, është më e besueshme se ata pa problem do të kalojnë drejt arsimit parashkollor dhe fillor përfshirës”. Kjo konventë e thekson edhe rolin e familjes në zhvillimin e fëmijës dhe rolin e shtetit në sigurimin e mbështetjes për familjen.

Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm (OZhQ) theksojnë se investimi në zhvillimin e hershëm të fëmijëve është bërë jo vetëm qëllim në vete, por edhe kusht për arritjen e shumë qëllimeve tjera për zhvillim të qëndrueshëm: çrrënjësja e varfërisë dhe urisë dhe përmirësimi i të ushqyerit të fëmijëve, sigurimi i jetës së shëndetshme, sigurimi i mësimit gjatë tërë jetës, arritjes së barazisë gjinore dhe zvogëlimi të pabarazisë. Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm e përfshijnë qëllimin specifik për zhvillim të hershëm fëmijëror në vijim: “Deri në vitin 2030 të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë kanë qasje në zhvillim cilësor të hershëm fëmijëror, kujdes dhe arsim parashkollor, si përgatitje për arsim fillor”. Në këtë kuptim, qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm paraqesin mundësi historik për tu dhënë përparësi investimeve në zhvillimin e hershëm fëmijëror.

Udhëzimet e OKB-së për kujdes alternativ të fëmijëve theksojnë se “organizatat dhe organet kompetente duhet ti investojnë të gjitha përpjekjet për të parandaluar ndarjen e fëmijëve nga prindërit dhe kujdestarët e tyre primar, përpos nëse kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës” (neni 154.).

Në kohët moderne, kur prindërit përballen me sfida të shumta, mbështetja e prindërve është më se e nevojshme. Mbështetja e prindërimit është një seri aktivitete të ndryshme dhe

komplekse që mund të synojnë aspekte të ndryshme të prindërimit. Moran (2004) e përkufizon mbështetjen prindërore si çdo ndërhyrje për prindërit që synon të reduktojë rrezikun, të promovojë mbrojtjen dhe mirëqenien e tyre sociale, fizike dhe emocionale. Programi i Prindërimit Pozitiv thekson se procesi i të mësuarit për prindërimin është shumë më tepër se edukim, pasi ai i ndihmon prindërit të pohojnë veten në rolin e tyre prindëror dhe të përmirësojnë prindërimin e tyre. Forma më e zakonshme e ofrimit të mbështetjes për prindërit është një program në grup, i cili përkufizohet si një proces që përfshin zgjerimin e njohurive dhe të kuptuarit, marrjen e njohurive dhe aftësive për zhvillimin e prindërve dhe fëmijëve të tyre dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Kur flitet për një program prindëror efektiv, në literaturë paraqiten dy modele, tradicionale dhe bashkëkohore. Qëllimi më i spikatur i programeve të prindërimit në modelin tradicional është mësimi i prindërve. Sot, prindërit duhet të shihen si njerëz që kanë kapacitetin për të mësuar nga përvoja e përditshme në rolin e tyre prindëror. Prandaj, qëllimi përfundimtar i programit të prindërimit në modelin bashkëkohor është “ndërtimi i kapaciteteve”, me synim forcimin e kapaciteteve të prindërve që synojnë aktivizimin e fuqive, mundësive dhe kompetencave prindërore për ndryshim. Nën ndikimin e konstruktivizmit, njohuritë prindërore konsiderohen si një ndërtim social, dhe programet e prindërimit si një proces bashkëpunues që inkurajon prindërit të reflektojnë dhe interpretojnë përvojën dhe të kërkojnë zgjidhje të mundshme (Ibid.). Supozohet se kapacitetet reflektuese prindërore përfaqësojnë një katalizator potencial për ndryshimet në marrëdhënien prind-fëmijë (Slade, 2006), kështu që koncepti i prindërimit reflektues merret si pikënisja bazë e qasjes më të re në kuptimin e zhvillimit të kompetencave prindërore. Theksi vihet në një kuptim më të thellë të fëmijës duke reflektuar mbi përvojat e mëparshme në situata të ndryshme. Në këtë mënyrë, ndryshimet në sjelljen e prindërve ndodhin si rezultat i të menduarit të tyre jo vetëm për sjelljen e fëmijës, por edhe për ndjenjat, synimet, madje edhe për përvojat e tij (po aty). Ekzistojnë lloje të ndryshme të programeve të prindërimit (Bunting, 2004), njëri prej të cilëve është i bazuar në marrëdhënie dhe synon të inkurajojë prindërit të zhvillojnë aftësi të reja në dëgjimin dhe komunikimin me fëmijët dhe të kuptuarit e sjelljes në kontekstin e marrëdhënieve me anëtarët e tjerë të familjes dhe në mjedis. Disa nga programet që bëjnë pjesë në këtë kategori janë trajnimi për efektivitetin e prindërimit dhe programet e prindërimit pozitiv.

3. Shtyllat kyçe të programit

Programi për prindërim pozitiv, si pjesë përbërëse e këtij koncepti, ofron një qasje prindërore, koncept edukativ dhe strategji specifike që mbështesin zhvillimin e vlerave prindërore, njohurive, aftësive për ndërveprim pozitiv me fëmijët.

Prindërimi pozitiv nënkupton nxitje (*mësim në rutina dhe mësim përmes lojës*) dhe praktikë edukative (*pjesëmarrje e fëmijës në jetën familjare dhe prindërim pa dënim-pozitiv*). Prindërimi pozitiv bazohet në pjesëmarrjen e fëmijës në jetën e familjes dhe të kopshtit, gjë që kërkon që kultura e kopshtit dhe e familjes të kenë të njëjtat pikënisje. Për fëmijën, situata e të nxënit, mbi të gjitha, nënkupton ekzistencën dhe disponueshmërinë e një NXITJE interesante që e fton fëmijën të bëjë pyetje. Më pas, nënkupton edhe mundësi që fëmija të gjejë përgjigjen ndaj pyetjes së tij, duke ndjekur *kureshtjen* e tij të natyrshme, interesin e tij, duke e zbatuar atë që di, *duke hulumtuar në mënyrë aktive*, duke u përpjekur dhe manipuluar me atë që ai e konsideron si faktorë kyç të dukurisë që e ka zgjuar interesimin e tij. Fëmija *menaxhon në mënyrë aktive* me procesin e tij njohës. Ai e ndryshon realitetin dhe e përshtat atë me vetveten, në mënyrë që të jetë më e lehtë për të gjetur një "emër" për atë që përpiqet të kuptojë, për të krijuar rrethana në të cilat mund të shijojë të mësuarit dhe në të cilat të mësuarit çon në rezultate të besueshme. Nuk ka asnjë stimulim që në vetvete do të çojë në një kapërcim zhvillimi nëse nuk shoqërohet nga një i moshuar që di ta emërtojë, të ofrojë kuptim, ta drejtojë fëmijën përmes përvojës, të zgjerojë lojën, të zgjerojë kureshtjen dhe hulumtimin e fëmijës. Një fëmijë mëson më së miri në marrëdhëniet e karakterizuara nga besimi, siguria, ngrohtësia dhe respekti për këndvështrimin e fëmijës. Kjo lloj marrëdhënieje midis prindit dhe fëmijës ushqen vullnetin e fëmijës për të mësuar me dhe nga dikush.

Si koncept, ai përmban një sërë masash që ndërmerren me një qëllim - promovimin e prindërimit pozitiv, pra ndërtimin e marrëdhënieve cilësore midis prindërve dhe fëmijëve, sepse marrëdhëniet janë themeli i zhvillimit. Masat përfshijnë strategji të ndryshme të mbështetjes së prindërve që përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e prindërve për rëndësinë e një mjedisi stimuluës në shtëpi, ofrojnë mbështetje për të mësuarit dhe zhvillimin e fëmijës në shtëpi (pjesëmarrja në rutina dhe të mësuarit përmes lojës) dhe ndërtojnë një rrjet mbështetës për mirëqenien emocionale të prindërve. Programi është hartuar përmes një qasjeje universale që synon të mbështesë prindërit dhe kujdestarët në krijimin e një mjedisi stimuluës për zhvillimin e fëmijës në të gjitha fushat (konjitive, emocionale, sociale, motorike dhe të të folurit).

Programi për prindërim pozitiv promovon universalitetin, orientimin e marrëdhënieve, rregullimin e intensitetit të mbështetjes, përqendrimin në nevojat e familjes dhe mbështetjen e përfshirjes së të **dy prindërve** në kujdes. Efektet e përfshirjes së babait dihet se janë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës, si dhe për zhvillimin, identitetin e vetë baballarëve dhe cilësinë e marrëdhënieve brenda familjes (Carbera, Shannon, Tamis-Le Monda, 2007).

Programi në veçanti thekson pasojat e dëmshme të ndëshkimit fizik - programi përqendrohet në vitet e hershme dhe rolin e rëndësishëm të prindërve dhe kujdestarëve në formimin e një mjedisi stimuluës, ndërsa mungesa e njohurive për zhvillimin e fëmijës dhe aftësitë e pamjaftueshme të prindërve janë arsyt kryesore për **ndëshkimin fizik** të fëmijëve. Mospranimi i fëmijës dhe mosrespektimi i këndvështrimit të fëmijës, sjell pritshmëri të papërshtatshme nga fëmija, gjë që i bën prindërit më të prirur për të reaguar dhunshëm. Prindi është një "pasqyrë" për fëmijën - reagimi i prindit i jep kuptim sjelljes dhe përvojës së fëmijës. Njohja e mirë e fëmijës dhe përmbushja adekuate e nevojave të fëmijës janë parakusht për veprimet edukative të fëmijës. Marrëdhënia e fëmijës me prindërit e tij është mjeti më i fuqishëm për ndikim ndaj fëmijës dhe

ky mjet është në duart e prindërve. Prindërimi pozitiv i mbështet prindërit në zbatimin e strategjive të pa dhunshme për edukim, përmes zhvillimit të dy aftësive të rëndësishme - *pranimi i fëmijës dhe udhëheqja e fëmijës nëpër situata* (dhënia e strukturës). *Pranimi i fëmijës do të thotë që fëmija ka përjetim se është i dashur* (shprehja e dashurisë), pa marrë parasysh rrethanat. Prindi i njeh dhe i kupton aftësitë dhe sjelljen e fëmijës së tij, di të vendosë veten në vendin e fëmijës dhe të mendojë se si mendon fëmija në atë moshë, mendon për nevojat e fëmijës sipas moshës së tij dhe mendon se si ndihet fëmija. Mund të njohë nevojën, iniciativën dhe interesin për sjelljen e fëmijës. *Udhëzimi i fëmijës nëpër situata* do të thotë t'i japësh fëmijës udhëzime të qarta për sjelljet e pritshme, të sigurta dhe të dobishme, t'i shpjegosh fëmijës arsyet e kërkesës së prindit, ta mbështesësh fëmijën dhe ta ndihmosh atë të tejkalojë me sukses sfidat, të jetë një model pozitiv dhe të zgjidhë sfidat bashkërisht. Edukatorët dhe kujdestarët mund ti mësojnë prindërit për këto aftësi dhe të modelojnë strategji të përshtatshme jo të dhunshme dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve.

3.1. Për kë është i dedikuar? - Programi përqendrohet tek **prindërit** - përmes leximit të përbashkët, lojës me fëmijën, vizita shtëpiake, rutina familjare, krijohen mundësi që prindërit të mësojnë për zhvillimin e fëmijëve, nevojat dhe kujdesin cilësor për fëmijën, të rishqyrtojnë dhe analizojnë përvojën e tyre për kujdesin ndaj fëmijës, të mësojnë si të krijojnë kushte më të mira për zhvillim të fëmijës (presin përgjigjen e fëmijës dhe e mbështesin pjesëmarrjen e tij), ta pranojnë fëmijën, të zhvillojnë gatishmëri dhe shkathtësi që ti ndjekin nevojat dhe reagimet e fëmijës, duke u mbështetur në iniciativën e fëmijës, i ofrojnë fëmijës mundësi për ndërveprim në të cilin fëmija do të mësojë për veten dhe për botën përmes lojës, me se do të krijojë bazë për marrëdhënie të sigurta, të ngrohta dhe përvoja pozitive për fëmijën.

Prindërit bëhen pjesëmarrës aktiv në jetën e kopshtit, duke intensifikuar dhe diversifikuar format dhe mënyrat e përfshirjes së prindërve në punën e kopshtit. Kjo siguron pjesëmarrje më të madhe të prindërve dhe gjetje të përbashkët të strategjive të duhura për rritjen dhe edukimin e fëmijës në institucion, por edhe brenda familjes. Kjo është thelbësore për prindërit me fëmijë në rrezik, të cilët, për arsye të ndryshme, nuk mund të krijojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijës së tyre.

Programi pritet të krijojë një kulturë të të mësuarit të vazhdueshëm dhe të përkushtimit për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në kopshte, bazuar në parimet e forcimit të praktikuesve në fushën e kompetencave relacionale. Koncepti i kompetencave relacionale u zhvillua si një pikënisje bazë teorike për ndërtimin e kompetencave të praktikuesve për të bashkëpunuar dhe përfshirë prindërit në punën me prindërit. Kompetencat relacionale nënkuptojnë gatishmërinë dhe aftësinë e profesionistit për të vëzhguar individin (fëmijë apo të rritur) sipas karakteristikave të tij personale dhe për të përshtatur sjelljen në përputhje me rrethanat, me udhëzim dhe autenticitet në kontakt, duke zhvilluar kështu aftësinë profesionale për të marrë përgjegjësinë e plotë për cilësinë e lidhjes. Prandaj, është e rëndësishme të punohet për rritjen e ndërgjegjësimit për pozicionin e dikujt në marrëdhëniet e krijuara me prindërit dhe rritjen e ndjeshmërisë për të dëgjuar më me kujdes dhe për të kuptuar perspektivën e prindërve dhe specifikat e kontekstit familjar. Çdo situatë komunikimi me prindërit duhet të synojë gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët e cila do ti përfshijë më shumë vetë prindërit në zhvillimin e një ndërveprimi më stimulues me fëmijën. Praktikuesit do të mbështeten në forcimin e kapaciteteve të tyre (shkathtësitë, përvojën dhe aftësitë) në procesin e zbatimit të formave dhe skenarëve të zhvilluar të punëtorive.

Programi e ka në fokus edhe **komunitetin lokal** - organizata të ndryshme, institucione publike, ente, organizata joqeveritare dhe shoqata, të cilët mund ta integrojnë programin në shërbimet ekzistuese, të ofrojnë vullnetarë dhe të promovojnë prindërim pozitiv, që informatat

për programin të depërtojnë deri te çdo prind. Është shumë e rëndësishme që të gjithë profesionistët që hyjnë në komunikim me prindërit, t'i njoftojnë ata me programet në kopsht, të ndihmojnë në regjistrimin e fëmijës në kopsht dhe të inkurajojnë familjet t'i shfrytëzojnë ato. Planifikimi për rritjen e përfshirjes së prindërve do të kryhet sipas specifikave dhe nevojave të secilit grup veç e veç (prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara zhvillimore, prindër në rrezik social, prindër në rrezik ekonomik, prindër nga zonat rurale, prindër nga komuniteti rom). Është e nevojshme të krijohet një mjedis në të cilin prindërit respektohen, mirëprehen, dëgjohen dhe janë pjesëmarrës aktivë në përmbushjen e nevojave të fëmijës së tyre - jo dikush që i thuhet "se si duhet".

3.2. Kujdesi për shëndetin mendor të prindërve - nuk është e mundur të krijohen kushte të mira për zhvillimin e fëmijës nëse prindërit dhe kujdestarët nuk kujdesen për ta dhe nuk janë me ta, me intensitetin që u nevojitet, për sa kohë që i zhvillojnë aftësitë për kujdes cilësor ndaj fëmijës. Ka prova që mirëqenia emocionale e prindërve/kujdestarëve dhe shëndeti mendor i prindërve janë kritike për sigurimin e kujdesit cilësor dhe zhvillimit të fëmijëve. Në mënyrë që prindërit të kujdesen mirë për fëmijët e tyre, ata duhet të kenë të tjerë që i mbështesin dhe kujdesen për ta. Prandaj, kujdesi për mirëqenien emocionale dhe shëndetin mendor të prindërve përfshin fuqizimin e prindërve për t'u kujdesur për veten, për të kërkuar mbështetje dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre për të tejkaluar sfidat e prindërimit. Mbështetja është e rëndësishme kur aftësitë e prindit për të ofruar mësim nëpërmjet lojës ose pjesëmarrjen e fëmijës në rutinat familjare janë të dëmtuara. Kujdesi për një fëmijë me pengesa në zhvillim, shëndetin mendor të prindërve, *stresi prindëror*, mospranimi i fëmijës dhe rolit të prindërve janë vetëm pjesë e arsyeve kur mbështetja duhet të intensifikohet dhe orientohet. Kur prindërimi është me veçori gjinore, gratë mbajnë peshën kryesore, gjë që kufizon mbështetjen dhe pjesëmarrjen e baballarëve në perkujdesje. Vetëm një prind që ka mundësinë për ndërveprim me fëmijën mund të ofrojë kujdes stimules, dhe për këtë arsye është e rëndësishme që me programin të promovohet dhe të mbështetet **përfshirja e baballarëve** në kujdesin e fëmijës dhe të përfshihen prindërit, d.m.th., si nënat dhe baballarët.

Pranimi i fëmijëve lidhet negativisht me stresin prindëror. Kujdesi për një fëmijë është stresues, fëmijët varen nga prindërit dhe mund të jenë rraskapitës. Shumica e prindërve përpiqen të bëjnë më të mirën për fëmijën e tyre, por ka prova që ata nuk mund ta bëjnë këtë pa mbështetje. Një sërë faktorësh ndikojnë në cilësinë e pjesëmarrjes së të moshuarit në lojën e fëmijës dhe në gatishmërinë për të ofruar një mjedis edukues dhe stimules për fëmijën. Dhe ndërsa një fëmijë, pas lindjes, do të jetë në gjendje dhe do të jetë i gatshëm të thërrasë prindërit/kujdestarët e tij në një ndërveprim cilësor, të moshuarit mund të mos e dinë ose të mos jenë në gjendje ta njohin atë thirrje, t'i përgjigjen asaj ose të marrin pjesë në ndërveprim dhe ta mbështesin dhe ta mbajnë atë. Stresi prindëror mund të vijë ose nga prindi ose nga fëmija. Që nga lindja e fëmijës, kur foshnja nuk fle dhe nuk ka rutina, refuzon ushqimet që nuk janë të qumështit, deri në 2 dhe 3 vjeç kur fëmija teston kufijtë, deri në shkuarje në kopsht ose më vonë në shkollë, prindërit përballen me stres. Ata pushtohen nga emocione të pakëndshme, kujdesen me më pak cilësi për fëmijën dhe janë më pak të ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijës, vazhdimisht vënë në dyshim kompetencën e tyre. Ata kanë nevojë për mbështetje për të përvetësuar strategjitë për kapërcimin e emocioneve të pakëndshme, për t'i kanalizuar ato, për të kërkuar ndihmë nga familja e gjerë, për të kërkuar burime në komunitet, për të pasur një person të besuar i cili mund të jetë punonjësi profesionist në kopsht, si mbështetja e parë. Është e rëndësishme të jesh një hap përpara prindërve dhe të veprohet në përputhje me stresin të cilin e përjeton prindi (t'i mundësojë prindit strategji për tejkalimin e zemërimit) dhe të mundësojë ndërveprim, lidhje dhe një marrëdhënie cilësore midis prindit dhe fëmijës.

3.3. Ngritja e rrjetit për mbështetje ndër-sektoriale në komunitet është veçanërisht e rëndësishme kur aftësitë e prindërve për të krijuar një mjedis stimulues janë të dëmtuara (prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara zhvillimore, prindër nga grupet e cenueshme), dhe veçanërisht kur fëmijët janë të ekspozuar ndaj strategjive të prindërimit të dhunshëm). Programi mundëson zhvillimin e programeve specifike për të mbështetur prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara zhvillimore, si dhe prindërit me prejardhje të ndryshme shumë-kulturore. Ai është projektuar gjithashtu për të qenë elastik, në mënyrë që institucionet dhe organizatat e ndryshme (OJQ, shoqata) në komunitet të mund ta zbatojnë programin dhe ta integrojnë atë në ndërhyrjet dhe shërbimet ekzistuese për prindërit, duke ndërtuar një Rrjet Mbështetës për të krijuar partneritete në komunitetin lokal.

Institucioni parashkollor duhet të realizojë bashkëpunim dhe partneritet me institucionet e mbrojtjes sociale dhe sektorin e shëndetësisë, si dhe me të gjitha organizatat që merren me kujdesin e fëmijëve dhe familjeve në nivel lokal, përmes hartëzimit të burimeve në komunitet. Komuniteti ka efekte të shumëfishta në familje, kushtet dhe mënyrat e rritjes së fëmijës përmes kulturës, nivelit ekonomik të zhvillimit dhe rrethanave të përgjithshme shoqërore, por edhe familja bashkëkohore ka nevojë për mbështetjen e komunitetit në rritjen e fëmijës. Si familja ashtu edhe fëmija janë të përfshirë në lloje të ndryshme shërbimesh, programesh dhe shërbimesh në komunitet - nga sistemi shëndetësor, institucionet parashkollore, oferta kulturore, deri te hapësirat e hapura të destinuara për fëmijët, si parqet, fushat, këndet e lojërave. Cilësia e marrëdhënieve, si nga këndvështrimi i fëmijës edhe nga i të moshuarit, formësohet, mbështetet ose dëmtohet nga natyra e marrëdhënies së krijuar në nivel të komunitetit. Nga këndvështrimi i komunitetit, këto marrëdhënie duhet të kenë këto cilësi: qasje e integruar, qasje gjithëpërfshirëse, partneritet. Qasja e integruar buron nga nevojat shumëdimensionale të fëmijëve dhe familjeve dhe nga funksioni shumëdimensional i rritjes dhe edukimit të fëmijëve. Rritja e një fëmije të vogël përfshin një sërë aspektesh - kujdesin, kujdesin shëndetësor, edukimin, mësimin, ushqimin, rekreacionin, socializimin dhe depërton në fusha të ndryshme të veprimit publik: sociale, shëndetësore, arsimore, kulturore. Baza për një qasje të integruar në praktikën sociale të kujdesit ndaj fëmijëve është: të shihet edukimi dhe arsimimi i fëmijëve si një përgjegjësi e përbashkët sociale (shteti, familja, kopshti, shkolla, komuniteti lokal); e drejta për qasje universale në program (fëmijë me aftësi të kufizuara zhvillimore, fëmijë me prejardhje të ndryshme sociale, etnike, gjeografike dhe kulturore); mbulimi i fëmijëve (nga lindja deri në moshën shkollore); nevoja për të diversifikuar format e punës me fëmijët dhe familjet (zhvillimi i formave të ndryshme, për shembull, kopshte gjithë-ditore, kopshte gjysmë-ditore, grupe lojërash, programe të specializuara, këshillim...), si dhe promovimi i rëndësisë së rolit të prindërve në mësimin dhe zhvillimin e fëmijës. Në nivelin e sistemit të arsimit dhe edukimit parashkollor, integrimi nënkupton zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të pajtueshëm reciprokisht, i cili siguron vazhdimësi horizontale dhe vertikale dhe përfshin të gjitha programet që ofrojnë kujdes dhe edukim për fëmijët nga lindja deri në moshën tetë vjeç, pavarësisht se kush i organizon ato, kush i financon ato, sa është kohëzgjatja e orarit të punës apo përmbajtja e programit (OECD, 2001).

Familje të ndryshme kanë nevojë për lloje të ndryshme të mbështetjes, e cila arrihet përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit. Shembuj të formave të bashkëpunimit që janë në dispozicion të kopshteve janë:

- Komunikimi me shkrim - promovimi i rëndësisë së zhvillimit të hershëm, kuptimi i potencialit të lojës, ndërtimi i imazhit të fëmijës, rëndësia e pjesëmarrjes, promovimi i strategjive të prindërimit jo të dhunshëm, rëndësia e të lexuarit me fëmijën, pjesëmarrja e fëmijës në rutina, ndikimi i stresit prindëror në cilësinë e kujdesit, shqetësimi për mirëqenien emocionale të prindërve/kujdestarëve
- Komunikimi i drejtpërdrejtë - që përfshin përdorimin e rutinave të përditshme në kopsht (pranim, largim nga puna) për të modeluar pjesëmarrjen e fëmijëve në

jetën e kopshtit; vizita në shtëpi (loja e përbashkët me fëmijën, pjesëmarrja e fëmijëve në rutinat familjare, leximi me fëmijën, bërja e lodrave), këshillimi individual me familjen (tejkalimi i stresit prindëror, (mos) pranimi i diagnozës dhe paaf-tësisë së fëmijës), vlerësimi i multikulturalizmit, rutinat e përditshme, harta e burimeve të komunitetit, takime tematike me familjet, seminare

- Pjesëmarrja e prindërve në punën e kopshtit dhe vendimmarrja në kopsht – mobilimi i përbashkët i një vendi p.sh. për lexim me fëmijën në kopsht.
- Aktivitete për prindër (prindër ndaj prindit) - klub familjar, udhëtime të përbashkëta, lexim i përbashkët

4. Programi i punëtorisë për prindër

4.1. Qëllimi i programit është prindërit të përvetësojnë strategji konkrete të cilat e mbështesin zhvillimin e vlerave prindërore, njohurive, aftësive për ndërveprim pozitiv me fëmijët.

Gjatë punëtorisë prindërit do të kenë mundësi:

- ti rishqyrtojnë praktikatat e tyre personale prindërore
- të këmbëjnë përvoja me prindërit
- të mësojnë nga njëri-tjetri
- të lidhen dhe të ndjejnë përkatësi dhe pranim
- të komunikojnë hapur dhe të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në jetën në kopsht
- të përfitojnë shkathtësi për prindërim pozitiv
- të përfitojnë aftësi për strategji të jo dhunshme
- të kujdesen për veten e tyre
- të përvetësojnë strategji për tejkalimin e stresit prindëror
- të kuptojnë rëndësinë e „ndarjes“ së kujdesit dhe pjesëmarrjes së baballarëve

4.2. Programi është dedikuar për të gjithë prindërit, edhe nëna edhe baballarë, kujdestarë, dhe birësues të fëmijëve në moshë të hershme. Trajnimit mund ta realizojnë punonjës profesional, si çift drejtues, të cilët kanë kryer trajnime për trajnerë të Programit për prindërim pozitiv, të cilët kanë përvojë dhe aftësi në udhëheqjen e punëtorive dhe janë të motivuar për të mësuar dhe zhvilluar kompetenca në mbështetjen e prindërimit. Pas trajnimit, trajnerët duhet të njihen plotësisht me Programin dhe në 15 ditët e ardhshme, në përputhje me kontekstin e kopshtit, të organizojnë grupe prindërisht.

4.3. Të ftuarit e prindërve në trajnim është i mundur përmes komunikimit me gojë dhe shkrim, afisheve, fletëpalosjeve, përmes grupeve në Viber, me publikimin e ftesave në ueb faqen e kopshtit, përmes mbledhjeve prindërore, me shfrytëzimin e burimeve për informim në bashkësinë lokale. Nëse ka nevojë, rekomandohet të organizohet përkujdesja e fëmijëve në kopsht gjatë kohës së realizimit të punëtorive. Thelbi i punëtorisë për prindërit është përqendrimi në arritjen e qëllimit dhe përmbajtjes së punëtorisë, duke ndërtuar në të njëjtën kohë një atmosferë pozitive përmes respektit dhe përkatësisë.

4.4. Struktura e trajnimit

Temat e punëtorisë janë:

1. *Fotografia e fëmijës tim*
2. *PNP (ndërlidh, ndjek, prano)*
3. *Ti inicio – unë përgjigjem*
4. *Të drejtat e fëmijës – përgjegjësi e të moshuarve*
5. *Si mëson fëmija ime?*
6. *Babai dhe nëna*
7. *A ka dalë dajaku nga parajsja?*
8. *Kujdesemi për prindin – kujdesemi për fëmijën*
9. *Çfarë ndodh kur prindi duhet të shkojë në punë?*
10. *Prindërit janë partnerë të kopshtit*

10-të punëtoritë kanë një rrjedhë kuptimplotë drejt arritjes së qëllimit të përcaktuar dhe nuk mund të realizohen veçmas apo me radhitje të ndryshme. Përgatitja e çiftit prindëror nënkupton posedimin e njohurive dhe aftësive për prindërim pozitiv, ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësisë së përbashkët për rezultatet dhe arritjen e qëllimit. Është mirë të ndërrohen udhëheqësit e punëtorisë, gjë që sjell dinamikë në punë. Është e dëshirueshme të shkruhet një raport për punëtorinë menjëherë pas realizimit të saj. Hapësira duhet të jetë e këndshme, mjaftueshëm e madhe. Numri i prindërve në punëtori nuk duhet të jetë më i madh se 15, mënyra e realizimit është një herë në muaj, në kohë të përcaktuar me prindërit. Punëtoritë nuk duhet të zgjasin më tepër se 1,5 orë.

Struktura e punëtorisë përbëhet prej:

Pjesa hyrëse – njohje reciproke, njohje me temën dhe qëllimin e punëtorisë, marrëveshje e përbashkët për rregullat e punës (pushimi, përdorimi i celularit, adresa, leja për të bërë fotografi, etj.), si dhe rregullat për respektimin e ndërsjellë, dëgjimin e të tjerëve, etj.

Pjesa qendrore

- prezantim i shkurtë profesional (kontribut me shkrim ose prezantim)
- lojë me role
- aktivitete dhe ushtrime (shpesh janë fletë pune ose kontribut me shkrim)
- këmbim përvojash, mendim, diskutim në nivel të grupit ose në grupe të vogla (çifte, treshe, katërshe)

Pjesa përfundimtare përfshin lojë për relaksim ose aktivitete për rumbullakim të temës dhe dhënie të *detyrës së shtëpisë*, me të cilën fillon punëtorja e radhës. Nuk është e domosdoshme të insistohet që të gjithë “të provojnë” aftësinë e përfituar në shtëpi, por është e dëshirueshme që gjatë 10-të punëtorive, secili të ketë mundësi të prezantojë këndvështrimet dhe njohuritë e tij për fëmijën në nivel të gjithë grupit.

4.5. Vlerësimi - në fund të ciklit prej 10 punëtorive, prindërve u jepet fleta e vlerësimit, i hartuar për vlerësimin e efekteve nga punëtoritë. Për çiftin drejtues hartohet fletë e veçantë për vlerësim. Të dy metodat për vlerësim do të jenë në formë të shkallëve për vlerësim dhe do të përpunohen në mënyrë sasiore, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të Programit në bazë të rezultateve të fituara.

4.6. Diseminimi i programit nënkupton krijimin e një bërthame të kopshteve, të cilët do të jenë modele për zgjerimin e programit në kopshtet tjera të cilët nuk janë përfshirë në trajnimin e parë. Punonjësit profesional nga kopshtet tjera përmes vizitave dhe shkëmbimeve horizontale do të kenë mundësi të realizojnë programin në kopshtet e tyre, duke e respektuar kontekstin dhe kulturën e kopshtit.

| | |
|------------------------------|--|
| Tema 1. | Fotografia e fëmijës sime |
| Qëllimi | Rishqyrtimi i bindjeve personale për fëmijën |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 1: „Bingo“ - për secilin • FP 2: „Fotografia e fëmijës sime“ - për secilin • FP 3: „Përshkrimi i fëmijës sime“ - për secilin • pajisje për shkrim - për secilin • bojëra - për secilin • marker - 1 • letër e madhe - 1 • shirit ngjitës - 1 |
| Aktiviteti hyrës (20 min.) | <p>Trajneri dhe pjesëmarrësit qëndrojnë në rreth. Trajneri prezanton veten dhe falënderon pjesëmarrësit për praninë. Pastaj shkurtimisht e sqaron programin dhe qëllimet e tij dhe se si është parashikuar të punohet (sa punëtori, kohëzgjatja e tyre, metodat e punës, cila është dinamika e takimeve).</p> <p>Pastaj bashkërisht vendosen rregulla të cilat do të vlejnjë për të gjithë punëtoritë me qëllim të sigurimit të punës së suksesshme dhe ndjenjës së mirë tek të gjithë pjesëmarrësit (arritja në kohë, pjesëmarrja aktive në aktivitete, shprehja e lirë e mendimit, respektimi i mendimit të tjetrit, përdorimi i celularëve, fotografimi...) dhe të njëjtat shënohen shkurtimisht në letër të madhe e cila ngjitet në një vend të dukshëm në hapësirë.</p> <p>Pastaj secili e pranon FP 1 dhe e plotëson në mënyrë të pavarur. Pasi të kenë përfunduar të gjithë, ngrihen dhe pas shenjës së dhënë shpejt kërkojnë dikë me përgjigje të ndryshme nga i veti në fushë të caktuar, dhe pastaj tjetri nënshkruhet në atë fushë. Pjesëmarrësi i njëjtë mund të nënshkruhet vetëm dy herë në fletën e dikujt tjetër. Pas grumbullimit të njërit nënshkrim, shpejtë kërkohet nënshkrimi i radhës për fushën tjetër. Çdoherë kur dikush do të grumbullojë nënshkrime në një radhë (horizontale, vertikale apo diagonale), bërtet me zë “Bingo!”</p> <p>Pas dhjetëra minuta, loja ndërpritet dhe zhvillohet diskutim i shkurtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kush i posedon të gjithë 16 bingot (15, 14... e me radhë teposhtë)? 2. Për çfarë e kishit më të lehtë të gjeni dikë t’ju nënshkruhet? E për çfarë e kishit më të vështirë? |
| Aktiviteti kryesor (40 min.) | <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth. Çdokush pranon FP 2 dhe në mënyrë të pavarur e vizaton fëmijën e tij, pastaj ndër fotografinë shkruan një porosi të shkurtër inkurajuese ose motivuese drejtuar fëmijës në të folur të drejtpërdrejtë, dhe me të cilin ai dëshiron të mbështesë udhëtimin e tij nëpër jetë. Pastaj një nga një ua paraqet vizatimin të tjerëve duke thënë: "Ky është ... (emri i fëmijës)" dhe lexon porosinë.</p> <p>Pastaj çdokush pranon FP 3 dhe në mënyrë të pavarur e plotëson në mënyrë që në fushën përkatëse shkruan atë që fëmijës së tij nuk i pëlqen/nuk i pëlqen të shohë, të dëgjojë, të flasë/thotë, të bëjë, por edhe atë që e bën atë të trishtuar, të frikësuar dhe të lumtur. Më pas, në dyshe, ndajnë atë që është shkruar fillimisht për njëren pjesë dhe më pas kalojnë në pjesën tjetër.</p> |

| | |
|------------------------------------|---|
| Diskutim (10 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë mendoni, si i përcakton fotografia për fëmijën pritjet e juaja nga ai? 2. Si e përcaktojnë ato pritje sjelljen tuaj ndaj tij? |
| Aktiviteti përmbyllës (15 min.) | Të gjithë qëndrojnë në rreth, por pranë atij me të cilin paraprakisht kanë punuar në çift. Një nga një, në çift drejtojnë një porosi të shkurtër pozitive lidhur me atë që deri më tani e kanë vërejtur te tjetri personalisht ose me atë që është shkruar dhe këmbyer gjatë punës në FP 3. Të tjerët dëgjojnë me vëmendje dhe duartrokin pas çdonjëres porosi. |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërve u jepet detyrë shtëpie të mbikëqyrin fëmijën e tyre në shtëpi dhe të gjejnë ndonjë aftësi, shkathtësi ose njohuri të cilën ai/ajo e posedon, ndërsa ata deri më tani nuk e kanë vërejtur; të mendojnë se si kjo e ka ndryshuar sjelljen e tyre ndaj fëmijës, e në atë mënyrë ta mbështesin atë. |

| | |
|---------------------------------|--|
| Tema 2. | LNP (lidh, ndjek, prano) |
| Qëllimi | Përvetësimi i aftësive të lidhjes, ndjekjes dhe pranimit |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 4: „Çfarë është prindërimi pozitiv?“ - për secilin • FP 5: „Ketri“ - për secilin grup të vogël • pajisje për shkrim - për secilin grup të vogël • top i vogël - 1 |
| Aktiviteti hyrës (15 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e shtjellon temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth. Në shenjën e dhënë, njëri fillon duke e kaluar topit të vogël tek ai i radhës, e kështu me radhë derisa ai të jetë kthyer te ai i cili e ka filluar aktivitetin pa rënë në tokë. Gjatë kësaj kohe, trajneri e mat kohën. Aktiviteti përsëritet disa herë në përpjekje të arrihet rezultat sa më i mirë i tërë grupit.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth. Trajneri nis bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin në lidhje me detyrën e shtëpisë nga punëtorja paraprake.</p> |
| Aktiviteti kryesor (45 min.) | <p>Secili pranon FP 4, e pastaj trajneri e sqaron.</p> <p>Pastaj pjesëmarrësit ndahen në grupe më të vogla. Secilit grup pranon nga një FP 5 me detyrë që bashkërisht ta lexojnë dhe tu përgjigjen pyetjeve të parashtruara.</p> <p>Kur të kenë përfunduar të gjithë grupet, në mënyrë alternative njëra pas tjetrës grupet lexojnë nga një situatë dhe përmbledhen përgjigjet e dhëna.</p> <p>Përgjigjet e sakta:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. pranimi 2. lidhja, monitorimi, pranimi 3. pranimi 4. ndjekja/monitorimi 5. lidhja, ndjekja, pranimi |
| Diskutim (15 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Si i dalloni shkathtësitë? 2. Çfarë ishte e vështirë për ju? 3. Si ju ndihmoi përvoja juaj prindërore në dallimin e këtyre shkathtësive? |

| | |
|------------------------------------|---|
| Aktiviteti përmbyllës (10 min.) | Të gjithë qëndrojnë në atë mënyrë që formojnë dy rreshta. Duke filluar nga njëri skaj i dy rreshtave, një nga një kalon mes rreshtave dhe ndalon në të njëjtin resht në fund, ndërsa të tjerët i drejtojnë atij porosi pozitive prindërore gjatë rrugës ("Ti di si ta ndjekësh fëmijën tënd!", "Ti përgjigjesh kur fëmija të parashtron pyetje!" etj.). |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërit kanë detyrë shtëpie që deri te takimi i radhës të ndjekin veten e tyre si prind dhe ti dallojnë situatat në të cilat kanë qenë jashtëzakonisht të suksesshëm si prind. P. sh., „E ndiqja fëmijën dhe pashë që është i trishtuar (qan, vjen në prehër, nuk luan) sepse nuk dolëm jashtë meqë binte shi. Iu afrova, e emërova ndjesinë - "E shoh se je i trishtuar", e përqafova dhe e putha. E di që i pëlqen të vizatojë, kështu që i solla bojëra dhe letra dhe vizatova së bashku.“ |

| | |
|---------------------------------|--|
| Tema 3. | Ti inicio - unë përgjigjem |
| Qëllimi | Përvetësimi i përvojës praktike me mekanizmin: inicio - përgjigju |
| Materiali i nevojshëm | <ul style="list-style-type: none"> • FP 6: „Sinjal-përgjigje“ - për secilin • pajisje për shkrim - për secilin • letër e madhe - 1 • markerë - 1 • shirit ngjitës - 1 |
| Aktiviteti hyrës (15 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë ndahen në çifte. Secili çift qëndron diku lirisht në hapësirë. Në shenjën e dhënë, njëri nga çifti e vendos njërën pëllëmbë të tij në një largesë të shkurtë para fytyrës së tjetrit dhe fillon ta lëviz atë me kujdes në drejtime të ndryshme duke lëvizur edhe vetë në hapësirë. Tjetri duhet me kokë ti ndjek lëvizjet e pëllëmbës duke e ruajtur të njëjtën largesë nga ajo tërë kohën. Pas një kohe, rolet ndërrohen.</p> <p>Pastaj të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri nis fillon bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin në lidhje me detyrën e shtëpisë nga punëtorja paraprake.</p> <p>Pastaj trajneri u kërkon pjesëmarrësve ti numërojnë të gjithë situatat kur fëmija i tyre dëshiron diçka, donë, kërkon, ndërsa ai i shënon shkurtimisht përgjigjet në letër të madhe.</p> <p>Pastaj trajneri e parashtron pyetjen në vijim: „Si e dini, dalloni, shihni kur fëmija juaj inicion diçka?“ dhe i përmbledh përgjigjet.</p> |
| Aktiviteti kryesor (30 min.) | Të gjithë ndahen në çifte. Njëri në secilin grup është në rolin e fëmijës, ndërsa tjetri - prindit, merren vesh cilën lojë do ta luajnë dhe e luajnë njëjtë siç do ta kishin luajtur me fëmijën e tyre. Pas një kohe të caktuar, kërkohet një çift vullnetar për të prezantuar lojën para të gjithëve, ndërsa të tjerëve u jepet FP 6 që ta plotësojnë duke e ndjekur lojën. Në të mund edhe të plotësojnë nëse vërejnë sinjale apo përgjigje të reja. |
| Diskutim (10 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë mendoni, çfarë mëson fëmija për veten atëherë kur presim iniciativë të tij? 2. Çfarë mëson për të tjerët? |

| | |
|----------------------------------|---|
| Aktiviteti përmblyllës (15 min.) | Të gjithë ndahen në grupe të vogla. Secili grup pranon situatë të ndryshme të cilën duhet ta prezantojë para të tjerëve përmes pantonimës, ndërsa të tjerët duhet të qëllojnë për çfarë bëhet fjalë. Situatat janë: <ul style="list-style-type: none"> • gjatë vozitjes në autobus ai frenon papritmas • pritje para bankës ku bën shumë vapë, ndërsa kondicioneri ndalon së punuari • pushim në plazh ku vjen një valë e madhe • përgatitja e ëmbëlsirës, ndërsa ai digjet |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërve u jepet detyrë shtëpie që deri në takimin e radhës të iniciojnë ndonjë nismë në kopsht si grup prindërisht. |

| | |
|----------------------------------|--|
| Tema 4. | Të drejtat e fëmijëve – përgjegjësi e të moshuarve |
| Qëllimi | Kuptimi i mënyrave për realizimin e të drejtave të fëmijës |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 7: „Të drejtat e fëmijëve” - 1 • letër - 2 • pajisje për shkrim - 2 • gërshtë - 1 |
| Aktiviteti hyrës (15 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri fillon bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin në lidhje me detyrën e shtëpisë nga punëtorja paraprake dhe e lëvdon iniciativën e ndërmarrë.</p> <p>Pastaj të gjithë qëndrojnë në rreth. Një nga një e përfundojnë fjalinë: “Meqenëse jam qenie njerëzore, kam të drejtë...”</p> |
| Aktiviteti kryesor (45 min.) | <p>Të gjithë ndahen në grupe të vogla. Secilit prej tyre u jepet nga disa pjesë prej FP 7. Këto pjesë janë prerë më herët, ndërsa pjesët nga secila janë përzier në grumbuj të veçantë dhe ato duhet të bashkohen. Pastaj çdo grup e lexon atë që shkruar në pjesët e tyre para të tjerëve duke theksuar fjalët e nënvizuara.</p> <p>Pastaj të gjithë ndahen në dy grupe. Njëri grup i mbështet të drejtat e fëmijëve, ndërsa tjetra është kundër. Argumentet për qëndrimin e tyre shkurtimisht, së bashku i shënojnë në letër. Pastaj zgjedhin përfaqësuesin e tyre i cili do të jetë mysafir në emision debati të cilin e udhëheq trajneri, ndërsa të tjerët janë publiku. Në një çast të dhënë, mysafiri në emision mund të kërkojë zëvendësim nga dikush tjetër nga grupi i tij. Zëvendësime të tilla secilin grup mund të bëjë dy herë.</p> |
| Diskutim (10 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Si u ndiet kur duhej të mbronit të drejtat e fëmijës? E si kur duhet të jeni kundër? 2. Çfarë ishte e vështirë? Çfarë ishte e lehtë? Pse? |
| Aktiviteti përmblyllës (15 min.) | Të gjithë qëndrojnë në rreth. Trajneri fillon të krijojë një zë - “krisma” alternative me gishtat të cilën e përcjell tek i pari nga ana e tij e djathtë, ndërsa ai pastaj te tjetri pranë tij e kështu me radhë deri te personi i fundit në rreth. Gjatë kohës së përcjelljes së zërit, të gjithë që e kanë pranuar vazhdojnë ta bëjnë këtë deri sa të kenë pranuar një zë të ri. Kur të vijë radha sërish te trajneri i cili ka filluar, a e ndrysho zërin - goditje alternative në gjunjë - dhe e përcjell në të njëjtën mënyrë si dhe në rrethin paraprak, me se të gjithë të tjerët |

| | |
|----------------------------|---|
| | vazhdojnë me zërin e njëjtë dera sa të pranojnë zërin e ri nga ai që është në anën e tyre të majtë. Zërat vijues: trokitje e njëpasnjëshme në dysHEME me këmbë, pastaj duartrokitje. Pasi të përfundohet me duartrokitjen, mundet menjëherë të vazhdohet me zërat e njëjtë, por me renditje të kundërt. Kështu përfitohet përshtypja se bie shi, i cili në fillim është i dobët dhe i qetë, pastaj gjithnjë e më shumë forcohet dhe pasi të ketë përjetuar kulmin (duartrokitja), gradualisht qetësohet. Është shumë me rëndësi që gjatë gjithë kohëzgjatjes së lojës të ketë qetësi të plotë, që të mund të përjetohet efekti i forcimit dhe qetësimit të shiut. |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërve u jepet detyrë shtëpie për të menduar nëse ka një fëmijë në lagjen e tyre, të drejtat e të cilit janë në rrezik. |

| | |
|-------------------------------|---|
| Tema 5. | Si mëson fëmija im? |
| Qëllimi | Fitimi i njohurive mbi shumëllojshmërinë e mënyrave të të mësuarit dhe hulumtimit të fëmijëve |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 8: „Njohuri shkencore për zhvillimin e fëmijës“ - për secilin grup të vogël • letër e madhe - 1 • pajisje për shkrim - për secilin grup të vogël • markerë - 1 |
| Aktiviteti hyrës (15 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë ndahen në treshe dhe qëndrojnë në një hapësirë të zbrazur, të gjerë. Fillimisht sqarohen dy elementet kryesore në aktivitetet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • „shtëpi“ - dy nga treshi qëndrojnë duke u mbajtur me duart e ngritura lartë mbi kokë; • „banor“ - njëri nga treshi qëndron midis të dyve që e përbëjnë „shtëpinë“. <p>Pastaj të tre e bëjnë figurën e vetë të „shtëpisë“ me „banor“ në të. Njëri i cili fillimisht nuk i takon asnjërës treshe, qëndron në mes dhe në mënyrë të qartë jep njërin nga udhëzimeve të mëposhtme të cilin të tjerët duhet shpejtë ta përmbushin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • „Shtëpitë i ndërrojnë banorët!“ - dy nga çdonjëra treshe të cilët e përbëjnë „shtëpinë“ duke u mbajtur akoma për duar e lëshojnë „banorin“ të cilin e kanë dhe me shpejtësi kërkojnë „banor“ të ri; gjatë asaj kohe të gjithë ata që janë „banorë“ qëndrojnë në vend. • „Banorit i ndërrojnë shtëpitë!“ - të gjithë „banorët“ dalin nga „shtëpitë“ e tyre dhe me shpejtësi kërkojnë „shtëpi“ të re; „shtëpitë“ gjatë këtij udhëzimi qëndrojnë në vend. • „Tërmet!“ - të gjithë treshet ekzistuese ndahen dhe formohen treshe tërësisht të reja në të cilat dy janë „shtëpi“, ndërsa një është „banor“ në atë „shtëpi“. <p>Ai i cili jep udhëzim, menjëherë pas dhënies së tij edhe vetë shpejton të hyjë në ndonjë treshe (si „banor“ ose si pjesë e „shtëpisë“, varësisht nga udhëzimi i dhënë). Ai i cili nuk do të jetë në asnjë treshe, ai do të jetë dhënësi i radhës i udhëzimeve.</p> |

| | |
|------------------------------------|---|
| | Pastaj të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri nis bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin në lidhje me detyrën e shtëpisë nga punëtorja paraprake dhe lidhur me atë se si shoqëria mund të ndihmojë në realizimin e të drejtave të fëmijës. |
| Aktiviteti kryesor (45 min.) | Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri i lut pjesëmarrësit të kujtojnë ndonjë situatë në të cilën ata si të moshuar është dashur të mësojnë diçka (vojtje automjeti, punë në kompjuter, përdorim i ndonjë aparati...), dhe i parashtron pyetjet në vijim: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kush ju ka ndihmuar gjatë kësaj? Si? (përgjigjet ndaj pyetjes së dytë shkurtimisht i shënon në letër të madhe) 2. Sa i përgjigjet prindërimi juaja veçorive të „mësuesit të mirë“? Cilën prej tyre e keni më të vështirë për ta realizuar? <p>Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla, ndërsa çdonjërit i jepet nga një FP 8 të cilës duhet bashkërisht ti përgjigjen. Pastaj një nga një, grupet lexojnë nga një pyetje dhe e tregojnë përgjigjen e cila sipas nevojë diskutohet që të arrihet deri te përgjigja e saktë.</p> |
| Diskutim (10 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë mësimi nxorët nga aktiviteti i kaluar? 2. Kur do të donit fëmija juaj të mësojë diçka, çfarë do të kishit ndryshuar në sjelljen tuaj? |
| Aktiviteti përmbyllës (15 min.) | Të gjithë ndalojnë në një rreth me duart e shtrira përpara. Pastaj i mbyllin sytë dhe ngadalë nisen drejt qendrës së rrethit, ku prekin dy pëllëmbë të lira të cilat do të duhet ti kapin. Asnjë dorë nuk duhet të mbetet e lirë, e as po dy duar të kapen për njëri. Kur të gjithë duart të gjenden dhe të kapen, të gjithë i hapin sytë dhe ngadalë fillojnë të zbërthehen, por pa i lëshuar duart. Në fund mund të fitohet një rreth tetëshe ose dy rrethe. Disa mund të mbeten me kurrizin të kthyer kah qendra, por në fund të gjithë duhet të zbërthehen. |
| Detyra shtëpie (5 minuta) | Prindërve u jepet detyrë që në shtëpi të pajisin partnerin e tyre ose dikë tjetër me njohuritë të cilat i kanë marrë në punëtorinë e sotshme, duke qenë kështu mësues të mirë. |

| | |
|-------------------------------|--|
| Tema 6. | Nëna dhe babai |
| Qëllimi | Kuptimi i rëndësisë së përfshirjes së baballarëve në kujdesin për fëmijën. |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • letër - për secilin grup të vogël • pajisje për shkrim - për secilin grup të vogël |
| Aktiviteti hyrës (20 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri nis bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin lidhur me detyrën e shtëpisë nga punëtorja paraprake.</p> <p>Pastaj të gjithë qëndrojnë në rreth. Fillon njëri i cili thotë: “Baba!” duke kthyer njëkohësisht kokën në të djathtë. Kjo është shenjë që ai ndaj të cilit është drejtuar fjala, të njëjtën ta përcjell më tutje në mënyrën e njëjtë. Çdokush ka të drejtë gjatë aktivitetit të thotë: „Shkrip!“ që është shenjë që tani të fillojë fjala “Nënë!” të përcillet në drejtimin e kundërt derisa dikush sërish të thotë: “Shkrip!“, që sërish të ndërrohet fjala dhe drejtimi i përcjelljes. Aktiviteti përmbyllet kur të gjithë në rreth do të shfrytëzojnë nga njëherë të</p> |

| | |
|-----------------------------------|---|
| | drejtën për fjalën “Shkrip!” dhe një fjalë e njëjtë të jetë përcjellë nëpër të gjithë rrethin. |
| Aktiviteti kryesor (50 min.) | Të gjithë ndahen në grupe të vogla. Gjysmës së grupeve u jepet detyrë të përshkruajnë (dhe të shkruajnë në formë të tregimit) një nënë stereotipike dhe se çfarë bën ajo zakonisht (cilat aktivitete tipike i ndërmer, e të cilat lidhen me kujdesin dhe zhvillimin e fëmijës nga lindja, nisje në shkollë, ashtu që çdo fjali duhet ta fillojnë me “Ajo...”. Gjysma tjetër e grupeve punojnë në të njëjtën mënyrë, por përshkruajnë një baba stereotip, ndërsa çdo fjali e fillojnë me “Ai”. Disa aktivitete të mundshme për përfshirje në përshkrim mund të jenë: përgatitja e shujtës, të ushqyerit, të mësuarit e fëmijës të hajë në mënyrë të pavarur, ndërrimi i pelenave, ndërrimi i rrobave, dërgimi në kopsht, lozja, të mësuarit të ecë, ngasë biçikletë, mbajtja e një lapsi me ngjyrë...). Më pas secili grup lexon historinë e tij ashtu siç është shkruar. Pastaj secili grup e lexon tregimin e njëjtë, por në atë mënyrë që gjithkund fjalën “ajo” e zëvendëson me “ai” dhe anasjelltas. |
| Diskutim (10 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Si ju dukën historitë e shtrembëruara? Pse? 2. Pse zakonisht nënat përfshihen në disa aktivitete dhe baballarët në aktivitete të tjera? 3. A ka dallime reale në aftësitë e tyre për kujdesin ndaj fëmijëve?? 4. Si do të ishte ideale? Kur do të ndiheshin më bukur fëmijët? Pse? Nëse do të zhvilloheshin më shumë? 5. Si mund ta ndihmojnë prindërit njëri-tjetrin në përfshirjen e ndërsjellë në aktivitete dhe në shpërndarjen e tyre të barabartë? Çfarë do të përfitonin edhe ata nga një prindërim i tillë i përbashkët? |
| Aktiviteti përmbyllës (5 min.) | Të gjithë ndahen në çifte. Njëri nga çifti fillon me pantonimë të bëjë aktivitete të ndryshme shtëpiake, ndërsa tjetri e imiton atë. Pas pak, rolet ndryshojnë. |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërve u jepet për detyrë të ndajnë përvojat e fëmijërisë me partnerin e tyre ose një person tjetër të rëndësishëm rreth asaj se sa të përfshirë ishin baballarët e tyre në kujdesin për ta kur ata ishin fëmijë. |

| | |
|-------------------------------|--|
| Tema 7. | A ka dalë dajaku nga parajsja? |
| Qëllimi | Përvetësimi i strategjive për edukim pa dhunë |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 9: „Dënimi fizik kundrejt prindërimit pozitiv“ - për secilin • FP 10: “Çfarë në vend të dënimit fizik?” – për secilin • letër e madhe - për secilin grup të vogël • pajisje për shkrim – për secilin • bojëra - për secilin grup të vogël • shirit ngjitës - 1 |
| Aktiviteti hyrës (20 min.) | Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë. Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri nis bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin lidhur me detyrën e shtëpisë nga punëtorja paraprake. |

| | |
|---------------------------------|--|
| | <p>Pastaj çdokujt i jepet FP 9, ndërsa trajneri para të gjithëve e prezanton përmbajtjen e vizatimit për arsyt e dënimit fizik.</p> <p>Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla, dhe secili u përgjigjet pyetjeve në FP, pas së cilës një grup në rreth lexon një nga një ato që janë shkruar derisa të shterohen të gjitha përgjigjet e pyetjes së parë dhe më pas të pyetjes së dytë. Ndërkohë, të tjerët dëgjojnë me vëmendje që të mos ketë përsëritje.</p> <p>Disa nga përgjigjet e mundshme të pranueshme janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. I keqkuptuar, rebel, i frikësuar, i padëshiruar, gabim, i lënduar... 2. Sjellja ndryshon vetëm për momentin, sepse nuk ka përmbajtje që do t'i tregojë fëmijës se si të veprojë ndryshe në të ardhmen. <p>Pastaj trajneri e prezanton edhe pjesën e dytë nga FP e njëjtë për prindërim pozitiv.</p> |
| Aktiviteti kryesor (20 min.) | Çdokujt i jepet FP 10 dhe u përgjigjet kërkesave në të. Pastaj për çdonjërin kërkesë lexohen nga disa përgjigje nga ana e vullnetarëve dhe analizohen me qëllim të fitohen ata që janë të dëshirueshme. |
| Aktiviteti përmbyllës (15 min.) | Të gjithë ndahen në grupe të vogla, pastaj çdonjëri harton nga një afishe me temë: "Ndal dënimit fizik të fëmijëve". Në fund çdo grup e prezanton afishen e vetë para të tjerëve, pastaj ata varen në vend të dukshëm në dhomë. |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërve u jepet detyrë shtëpie që në takimin e radhës të sjellin batanije apo shall të fëmijës, e cila ka ndonjë kuptim të veçantë. |

| | |
|---------------------------------|---|
| Tema 8. | Kujdesemi për prindin – kujdesemi për fëmijën |
| Qëllimi | Forcimi i vetëdijes së prindërve për rëndësinë e kujdesit për veten në kontekst të prindërimit |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • shalle dhe batanije nga fëmijët (të sjella nga pjesëmarrësit) • karrige – më tepër (në varësi nga hapësira) |
| Aktiviteti hyrës (15 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Çdokush shkurtimisht rrëfen kush ia ka dhënë emrin dhe çfarë domethënie ka ai.</p> |
| Aktiviteti kryesor (30 min.) | <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth dhe mbulohen me shallin ose batanijen që kanë sjellë, pastaj një nga një ata tregojnë historinë duke i përfshirë pyetjet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Si mbërriti ajo batanije/shall në shtëpinë tuaj? 2. Për çfarë përdoret shalli/batanija? 3. Çfarë kujtimesh keni me atë? 4. Çfarë ndjenjash ju zgjon? |
| Diskutim (20 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë do të thotë për foshnjën kur e mbështjell/mbulon me një shall/batanije?? 2. Kush është "manteli juaj mbështetës" në prindërimin tuaj në të tashmen? Si? 3. Sa dhe pse është e rëndësishme kjo për ju? |
| Aktiviteti përmbyllës (20 min.) | Të gjithë ndahen në çifte. Njërit në çift i mbyllën sytë me shallin/batanijen e tij dhe tjetri e merr për dore dhe e çon në |

| | |
|----------------------------|--|
| | mënyrë të sigurt përmes një rreshti karrigesh të cilat duhet të kalohen në mënyrë zigzag. Më pas rolet ndryshojnë. |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërve u jepet detyrë shtëpie të mendojnë se për kë janë ata një batanije mbështetëse në familje. |

| | |
|---------------------------------|--|
| Tema 9. | Çka nëse prindi duhet të shkojë në punë? |
| Qëllimi | Vështrime mbi ndikimin e konfliktit të rolit familjar dhe profesional në stresin prindëror |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 11: “Në shtëpi - në punë” - për secilin • pajisje për shkrim – për secilin |
| Aktiviteti hyrës (10 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri nis bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin lidhur me detyrën e shtëpisë nga punëtoria paraprake.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth. Fillon trajneri, i cili i kthyer kah ai pranë tij (por që edhe të tjerët të mund ta shohin), fillimisht bën lëvizje sikur vendos maskë në fytyrë dhe bën ndonjë grimasë. Pastaj me lëvizje pantonimë e “nxjerr maskën” dhe ia “dhuron” personit pranë tij. Personi pranë tij, po ashtu me lëvizje pantonimë e “pranon” maskën dhe e “vendos” në fytyrën e tij, duke e përsëritur grimasën e njëjtë. Pastaj, e “nxjerr” atë maskë edhe e “hedh” pas, ndërsa vetë e „vendos” maskën e vete dhe bën grimasë tjetër, e „nxjerr” maskën dhe ia „dhuron” të ardhshmit. Loja përfundon kur të përfundojë i tërë rrethi dhe kur ai i cili e ka filluar lojën do ta „pranojë” maskën e fundit, do ta përsërit grimasën e njëjtë dhe do ta „hedh” atë maskë.</p> <p>Pastaj trajneri e parashtron pyetjen: „Çfarë mendoni, sa për qind e prindërve sot kanë një konflikt midis roleve familjare dhe atyre profesionale?”</p> |
| Aktiviteti kryesor (15 min.) | <p>Të gjithë ulen në një rreth. Të gjithë pranojnë FP 11 dhe e plotësojnë atë në mënyrë të pavarur duke përshkruar se si duket dita e tyre e zakonshme përmes aktiviteteve specifike që bëjnë në lidhje me shtëpinë dhe punën.</p> <p>Kur të kenë mbaruar, të gjithë duhet të vendosin një rreth pranë periudhës kohore kur janë në shtëpi dhe mendojnë për punën, dhe një trekëndësh - kur janë në punë dhe mendojnë për shtëpinë.</p> <p>Pastaj të gjithë ndahen në çifte dhe tregojnë se çfarë strategjish përdorin për të zgjidhur konfliktin midis rolit të tyre familjar dhe profesional.</p> |
| Diskutim (45 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa të ngjashme dhe sa të ndryshme ishin strategjitë tuaja me ato të partnerin në çift? 2. Çfarë strategjie të re do të dëshironit të provonit për të reduktuar stresin e baraspeshimit të roleve familjare dhe profesionale? Si do t'ju ndihmonte ajo? 3. Si do ta shihet/përjetonte ndryshimin burri/gruaja juaj? 4. Si do të ndikonte ky ndryshim tek fëmija juaj dhe në kujdesin ndaj tij? |

| | |
|-------------------------------------|--|
| Aktiviteti përmblyllës (10 min.) | Të gjithë qëndrojnë në rreth. Njëri qëndron në mes dhe e përfundon fjalinë: „Ti ndërrojnë vendet të gjithë që...” duke thënë diçka konkrete lidhur me rolin familjar ose profesional, reagimet/ndjenjat të cilat shkaktohen gjatë përpjekjes për harmonizimin e tyre, pengesat gjatë kësaj e të ngjashme. Për shembull, „...që kanë një shef që kërkon shumë punë”, „...që dëshirojnë të kalojnë më tepër kohë me fëmijët”, „...të cilët vrapojnë në shtëpi nga puna “ e të ngjashme.). Menjëherë pas kësaj edhe vetë kërkon karrige të lirë për tu ulur. Ai i cili do të mbetet pa karrige, do të jetë i radhës për dhënien e udhëzimeve. |
| Detyra shtëpie (10 min.) | Prindërve u jepet detyrë të mendojnë për një hobi me të cilin do të donin të merren. |


| | |
|-------------------------------------|--|
| Tema 10. | Prindërit janë partnerë të kopshtit |
| Qëllimi | Motivimi i prindërve për pjesëmarrje aktive në kopshtin në komunitet |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 12: „Harta e burimeve në vendin tonë” - për secilin grup të vogël • fletë vlerësimi - për secilin • certifikatë për pjesëmarrje - për secilin • letër e madhe - 1 • pajisje për shkrim - për secilin grup të vogël • markerë - 1 |
| Aktiviteti hyrës (30 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri nis bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin lidhur me detyrën e shtëpisë nga punëtorja paraprake.</p> <p>Pastaj Trajneri ngadalë thotë: „Çdokush në vete le të kujtojë ndonjë situatë nga jeta kur e ka pasur të vështirë... Kujtoni se kush ju ka ndihmuar atëherë... Përshkruajeni atë person!” Atëherë të gjithë hedhin veçori/karakteristika, ndërsa ai i shënon në letër të madhe para të gjithëve.</p> |
| Aktiviteti kryesor (30 min.) | Të gjithë ndahen në grupe të vogla, e pastaj çdokush e plotëson FP 12. Pastaj çdo grup i prezanton përgjigjet e veta para të gjithëve. |
| Aktiviteti përmblyllës (15 min.) | <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri i falënderon të gjithë për pjesëmarrjen në program.</p> <p>Pastaj ai shufrën paraprakisht të ndërtuar nga letra e vendos midis supit dhe mjekrës së tij, ndërsa duart i mbanë pas. Kështu ia kalon shufrën tjetrit pranë tij, pa i shfrytëzuar duart. Dhe kështu me radhë “shufra” kalohet nga njëri te tjetri pa rënë në tokë, deri sa të kthehet sërish tek trajneri.</p> |
| | Prindërve u jepet fletë për vlerësim dhe certifikatë. |

5. Fletë pune


Fletë pune (FP) 1: Bingo

| | | | |
|--|--|--|--|
| ju pëlqen të zgjoheni herët (po ose jo) _____ | keni vëlla/motër (po ose jo) _____ | festa më e rëndësishme në familje _____ | rrjeti social që përdorni më së shumti _____ |
| ushqimi që hani më shpesh _____ | ndiqni politikën (po ose jo) _____ | pini kafe me fqinjët (po ose jo) _____ | shenja në horoskop _____ |
| detyra e shtëpisë që e urreni më së shumti _____ | jetoni në shtëpi apo banesë _____ | aktiviteti i preferuar në kohë të lirë _____ | lloji i preferuar i muzikës _____ |
| ajo që ju mërzit më shumë tek njerëzit _____ | shtetin që dëshironi të vizitoni _____ | paratë nga “java e lotarisë” do ti shpenzonit për _____ | më shumë gëzoheni kur _____ |

FP 2: Fotografia e fëmijës tim



FP 3: Përshkrimi i fëmijës tim



FP 4: Çfarë është prindërimi pozitiv?

Prindërimi pozitiv është:

a) kujdesi prindëror që fëmija të jetë i shëndetshëm, i sigurt, i ushqyer siç duhet

b) prindi të **monitorojë** fëmijën dhe t'u **përgjigjet** nevojave dhe interesave të tij

| 1-5 | FAZAT |
|-----|--|
| 1 | Prindi lidhet me fëmijën (është i gatshëm të investojë emocionalisht tek ai). |
| 2 | Fëmija ka nevoja (për të ushqyerit, sigurinë, përfshirjen sociale, stimulimin konjitiv, rregullimin dhe kanalizimin e emocioneve). |
| 3 | Fëmija jep sinjale (buzëqeshje, lëvizje, zëra, gjeste, kërkesa verbale). |
| 4 | Prindi monitoron sinjalet që jep fëmija, i interpreton ato dhe reagon në përputhje me rrethanat. |
| 5 | Fëmija mëson dhe zhvillohet. |

Kur prindi e ndjek fëmijën dhe i përgjigjet nevojave dhe interesave të tij, atëherë fëmija ndjen siguri emocionale, ngrohtësi, besim, shëndet fizik dhe mendor, në vend të stresit dhe ankthit.

c) prindi duhet ta **mbështesë** fëmijën për të eksploruar dhe komunikuar me rrethin

| 1-5 | FAZA |
|-----|---|
| 1 | Prindi beson se fëmija mund të zhvillojë shkathtësi të ndryshme. |
| 2 | Prindi krijon mundësi për fëmijën, që në moshë më të hershme, të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në bazë të kapaciteteve zhvillimore, përvojës dhe interesave të tij. |
| 3 | Fëmija merr pjesë në aktivitete të ndryshme. |
| 4 | Prindi monitoron pjesëmarrjen e fëmijës në aktivitete, e nxit dhe nuk i nënvlerëson aftësitë e tij, duke i parë ato nga këndvështrimi i tij. |
| 5 | Fëmija zhvillon aftësitë e tij, ndërsa ato i mundësojnë pjesëmarrje më cilësore në të ardhmen. |

Kur fëmija merr pjesë në aktivitete të ndryshme, ai ndjen se mendimi i tij është i rëndësishëm, zhvillon respekt të ndërsjellë, sheh se pjesëmarrja e tij mund të çojë në ndryshime, kontribuon në diçka që prindërit e konsiderojnë të rëndësishme, zhvillon respekt për veten, arsyetim, të menduarit, planifikim, parashikim, aftësinë për të shprehur, kuptuar të tjerët, realizon ndërvarësinë, ndërton përgjegjësi, mëson të zgjidhë probleme...

FP 5: Ketri

1. Unë jam nëna e Elenës. E lindi kur isha në shkollë të mesme. Ajo është gjithmonë me nënën time. Gjatë një shëtitjeje me të, një ketër u shfaq në një pemë në oborrin e një shtëpie të rrethuar me mur. Unë i thashë: "Shiko, ketri!" Ajo po shikonte diçka përreth, por është shumë e ngadaltë dhe e ngathët, kështu që ketri iku para se të kthehej dhe nuk e pa fare.

Çfarë shkathtësie i mungon nënës? lidhja monitorimi pranimi

2. Unë jam babai i Edonës. Unë punoj shumë në një zyrë si mjek. Gjatë një shëtitjeje me të, në një pemë në oborrin e një shtëpie që rrethohet me një mur të lartë, u shfaq diçka, ndaj Edona më tha: "Babi, është ketri!". Më ngrit që ta shoh!" Po shikoja rezultatet mjekësore që më erdhën në telefonin tim, pastaj përsëri dëgjova: "Më ngrit, më ngrit!" Ajo gjithmonë sheh diçka ndërsa ne ecim, kushedi çfarë ka parë tani.

Çfarë shkathtësie i mungon babait? lidhja monitorimi pranimi

3. Unë jam babai i Burhanit dhe çdo ditë dalim në shëtitje. Gjatë një shëtitjeje me të, një ketër u shfaq në një pemë në oborrin e një shtëpie të rrethuar me një mur të lartë. E di që Burhani i do kafshët dhe është shumë kureshtar, ndaj i thashë: "Eja të të ngrit shpejt, ka një ketër në pemë!" Ai vrapoi drejt meje, por rrëshqiti. Ai shpesh rrezohet sepse është i ngathët. E mbajta që të mos binte dhe ai ishte i lumtur. Vrapuam së bashku duke qeshur dhe ai bërtiste: "Jupiiii, tani do ta shoh!" E ngrita dhe i shpjegoja për ketrin: "Ai është i vogël dhe shumë i shkathët. Do të jesh edhe ti kur të rritesh!"

Çfarë shkathtësie ka babai? lidhja monitorimi pranimi

4. Unë jam nëna e Orhanit. Unë jam e papunë. Derisa po gatuoja drekën, nga dritarja pashë një ketër në pemë, kështu që desha t'ia tregoja organit. I thashë: "Eja të të tregoj një kafshë të vogël, është në pishën tonë!" Ai vizatonte, pra gjithmonë vizaton dhe nuk i intereson asgjë. E mora për dore dhe e çova te dritarja: "Shiko, shiko një ketër!", por ai gjithmonë shikon diçka tjetër. I thashë: "Ketri është vërtet i bukur, ka veshë të bukur dhe bisht, ha lajthi...", por ai nuk më dëgjonte.

Çfarë shkathtësie i mungon nënës? lidhja monitorimi pranimi

5. Unë jam nëna e Sarës. Në një shëtitje me të, pashë një ketër në një shtëpi me një gardh të lartë. I tregova me gisht dhe i thashë: "Shih një ketër, shiko atë në pemë!" Ajo më shikoi mua, pastaj ngriti sytë lart dhe pop shikonte të gjitha pemët përreth. Kuptova që ajo nuk mund të shihte asgjë sepse gardhi ishte shumë i lartë për të. Më pyeti: "Ku është ketri?" Kuptova se duhej ta marrë e ta ngrit. Ajo shikonte me kureshtje dhe më pyeti: "Si është ngjitur aq lart?" Si nuk bie? Çfarë ha ai? A ka ai familje?" Unë iu përgjigja të gjitha pyetjeve të saj. Pastaj sugjerova që kur të kthehem në shtëpi, të vizatojmë ketrin dhe familjen e saj së bashku dhe t'ia tregojmë vizatimin babit dhe gjyshes. Sara po kërcente nga gëzimi.

Çfarë shkathtësie ka nëna? lidhja monitorimi pranimi

FP 6: "sinjal-përgjigje"

| FËMIJA | | PRINDI | |
|--|--|--|--|
| e shikon lodrën | | e emërton lodrën | |
| tregon me gisht nga lodra | | parashtron pyetje | |
| e prek lodrën | | parafrazon/tregon atë që sheh | |
| e merr dhe e bart lodrën | | jep udhëzime | |
| e jep lodrën | | futet në lojë | |
| e emërton lodrën | | pret me durim një përgjigje joverbale nga fëmija gjatë lojës | |
| e fton prindin të luajë në mënyrë joverbale (duke shikuar, duke tërhequr/duke kapur prindin) ose në mënyrë verbale | | përfshin persona të tjerë (fëmijë dhe të rritur) | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

FP 7: Të drejtat e fëmijës

Neni 2 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Të drejtat e Konventës vlejnë për TË GJITHË, pavarësisht nga raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, gjuha, feja, besimi politik ose ndonjë besim tjetër, prejardhja kombëtare, etnike ose sociale, aftësitë, statusi i pasurisë.

Neni 12 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Fëmija ka të drejtë të ketë PIKËPAMJET E TIJ, të drejtën për të shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i VLERËSUAR ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.

Neni 13 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të KËRKUAR, PËR TË MARRË DHE PËR TË PËRCJELLË INFORMACIONE.

Neni 18 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Të DY PRINDËRIT kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësia e tyre është KRYESORE. INTERESAT E FËMIJËS JANË SHQETËSIMI I TYRE THEMELOR.

Neni 19 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Fëmija NUK DËHET TË DËMTOHET. Ajo duhet të mbrohet nga të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi.

Neni 23 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Fëmija me paaftësi mendore ose fizike ka të drejtë për një KUJDES të VEÇANTË, duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë DINJITETIN e tij, që nxisin AUTONOMINË dhe lehtësojnë Pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.

Neni 29 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Fëmija ka të drejtë të zhvillojë POTENCIALIN E PLOTËS TË PERSONALITETIT DHE DHUNTIVE DERI NË MAKSIMUM.

Neni 30 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Fëmija ka të drejtën e KULTURËS, FESË DHE GJUHËS SË TIJ/SAJ.

Neni 15/31 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve

Fëmija ka të drejtë të pushojë dhe ARGËTOHET, të ketë kohë të lirë dhe për rekreacion, TË SHOQËROHET, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

FP 8: Njohuri shkencore për zhvillimin e fëmijës

| | | |
|---|---|---|
| <p>1. Zhvillimi i trurit është kumulativ.</p> <p>Zhvillimi i disa kapaciteteve është baza për zhvillimin e mëvonshëm të kapaciteteve të tjera.</p> | S | P |
| <p>2. Në periudhën e hershme fëmija ka mundësitë më të mëdha për zhvillim.</p> <p>Kur një fëmije i sigurohet zhvillim dhe mësim cilësor më herët, sigurohen rezultate më të qëndrueshme.</p> | S | P |
| <p>3. Mjedisi nuk ndikon në zhvillimin e trurit.</p> <p>Truri i fëmijës nuk zhvillohet në varësi të faktit nëse ka një përvojë pozitive, negative apo mungesë të përvojës fizike/mendore me objekte, vende dhe veçanërisht me njerëz nga mjedisi i tij.</p> | S | P |
| <p>4. Fëmija lind me nevojën për lidhje shoqërore me njerëzit e tjerë.</p> <p>Kultura ndikon më tej se si do të zhvillohet kjo lidhje – cilat rregulla, mënyra dhe natyra e ndërveprimit shoqëror do të ushqehen.</p> | S | P |
| <p>5. Prindërit janë mësuesit më të rëndësishëm të fëmijës.</p> <p>Zhvillimi dhe mësimi i një fëmije ndikohet nga shumë njerëz (të afërm, fqinjë, miq, edukatorë), por më së shumti nga prindërit (nëna dhe babai), ndërveprimi i të cilëve me të është që në moshë të hershme dhe ofron më shumë mundësi për ndikim, ndërsa përvoja prej saj më pas ndikon në ndërveprimet e fëmijës me të tjerët në mjedis.</p> | S | P |
| <p>6. Fëmija zhvillohet më mirë kur mjedisi ka krijuar marrëdhënie të forta afektive me të (kujdes, dashuri, siguri, mbështetje).</p> <p>Fëmija është më i gatshëm të zbulojë dhe vërë në dyshim karakteristikat e ndryshme të mjedisit dhe të zhvillohet përmes atij procesi kur mjedisi ka krijuar me të marrëdhënie të ngrohta, edukative, të përgjegjshme, të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe karakteristikat e fëmijës.</p> | S | P |
| <p>7. Një fëmijë nuk lind kureshtar.</p> <p>Fëmija nuk dëshiron të mësojë dhe e di që në lindje.</p> | S | P |
| <p>8. Fëmija lind me kompetenca.</p> <p>Fëmija nuk zhvillon kompetenca në varësi të cilësisë së lartë që i kërkon mjedisi dhe nëse ai e mbështet zhvillimin e tyre duke e trajtuar fëmijën si plot me potencial për zhvillim.</p> | S | P |
| <p>9. Kur ka harmoni në veprimtaritë edukative në familje dhe kopsht, përfitimet për fëmijën janë më të mëdha.</p> <p>Ndërtimi i bashkëpunimit dhe partneritetit cilësor mes familjes dhe kopshtit mundëson bashkërendimin e veprimeve të tyre, duke nxitur zhvillimin e hershëm të çdo fëmije dhe përparim më të suksesshëm.</p> | S | P |



FP 8: Njohuri shkencore për zhvillimin e fëmijës - përgjigje

| | |
|---|------------|
| <p>1. Zhvillimi i trurit është kumulativ.</p> <p>Zhvillimi i disa kapaciteteve është baza për zhvillimin e mëvonshëm të kapaciteteve të tjera.</p> | <p>S P</p> |
| <p>2. Në periudhën e hershme fëmija ka mundësitë më të mëdha për zhvillim.</p> <p>Kur një fëmije i sigurohet zhvillim dhe mësim cilësor më herët, sigurohen rezultate më të qëndrueshme.</p> | <p>S P</p> |
| <p>3. Mjedisi nuk ndikon në zhvillimin e trurit.</p> <p>Truri i fëmijës nuk zhvillohet në varësi të faktit nëse ka një përvojë pozitive, negative apo mungesë të përvojës fizike/mendore me objekte, vende dhe veçanërisht me njerëz nga mjedisi i tij.</p> | <p>S P</p> |
| <p>4. Fëmija lind me nevojën për lidhje shoqërore me njerëzit e tjerë.</p> <p>Kultura ndikon më tej se si do të zhvillohet kjo lidhje – cilat rregulla, mënyra dhe natyra e ndërveprimit shoqëror do të ushqehen.</p> | <p>S P</p> |
| <p>5. Prindërit janë mësuesit më të rëndësishëm të fëmijës.</p> <p>Zhvillimi dhe mësimi i një fëmije ndikohet nga shumë njerëz (të afërm, fqinjë, miq, edukatorë), por më së shumti nga prindërit (nëna dhe babai), ndërveprimi i të cilëve me të është që në moshë të hershme dhe ofron më shumë mundësi për ndikim, ndërsa përvoja prej saj më pas ndikon në ndërveprimet e fëmijës me të tjerët në mjedis.</p> | <p>S P</p> |
| <p>6. Fëmija zhvillohet më mirë kur mjedisi ka krijuar marrëdhënie të forta afektive me të (kujdes, dashuri, siguri, mbështetje).</p> <p>Fëmija është më i gatshëm të zbulojë dhe vërë në dyshim karakteristikat e ndryshme të mjedisit dhe të zhvillohet përmes atij procesi kur mjedisi ka krijuar me të marrëdhënie të ngrohta, edukative, të përgjegjshme, të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe karakteristikat e fëmijës.</p> | <p>S P</p> |
| <p>7. Një fëmijë nuk lind kureshtar.</p> <p>Fëmija nuk dëshiron të mësojë dhe e di që në lindje.</p> | <p>S P</p> |
| <p>8.Fëmija lind me kompetenca.</p> <p>Fëmija nuk zhvillon kompetenca në varësi të cilësisë së lartë që i kërkon mjedisi dhe nëse ai e mbështet zhvillimin e tyre duke e trajtuar fëmijën si plot me potencial për zhvillim.</p> | <p>S P</p> |
| <p>9.Kur ka harmoni në veprimtaritë edukative në familje dhe kopsht, përfitimet për fëmijën janë më të mëdha.</p> <p>Ndërtimi i bashkëpunimit dhe partneritetit cilësor mes familjes dhe kopshtit mundëson bashkërendimin e veprimeve të tyre, duke nxitur zhvillimin e hershëm të çdo fëmije dhe përparim më të suksesshëm.</p> | <p>S P</p> |

FP 9: Ndëshkimi trupor kundrejt prindërimit pozitiv

1. Si ndihet fëmija kur ndëshkohet fizikisht?

2. A e mëson ndëshkimi fizik fëmijën se si të sillet saktë në të ardhmen dhe të mos përsëris sjelljen për të cilën është dënuar? Pse?



FP 10: Çfarë duhet në vend të ndëshkimit fizik?

Është koha për të fjetur. Lodrat janë shpërndarë kudo nëpër dhomë, pavarësisht se tashmë i keni thënë disa herë fëmijës t'i mbledh. Fëmija refuzon t'i vendosë ato në vend. Si mund ta drejtoni me sukses fëmijën në këtë situatë në vend që të ndëshkohet fizikisht?

- 1. Bëjini të qartë se jeni të zemëruar, përshkruani se cili është problemi dhe sulmoni atë (shpjegoni pasojat që mund të ndodhin për shkak të problemit), jo fëmijën!**

- 2. Bëjini të qarta pritshmëritë tuaja!**

- 3. Tregoni se si mund të zgjidhet problemi tani ose në të ardhmen (mund të futet edhe loja mandej)!**

- 4. Ofroni zgjedhje!**

- 5. (nëse sjellja e padëshiruar vazhdon) Paralajmëroni fëmijën për atë që do të pasojë (pasojë e natyrshme e sjelljes, por assesi ndëshkim fizik)!**

- 6. Nëse sjellja e padëshiruar vazhdon, jini këmbëngulës për atë që u tha më parë.**

FP 10: Çfarë duhet në vend të ndëshkimit fizik? - përgjigje

Është koha për të fjetur. Lodrat janë shpërndarë kudo nëpër dhomë, pavarësisht se tashmë i keni thënë disa herë fëmijës t'i mbledh. Fëmija refuzon t'i vendosë ato në vend. Si mund ta drejtoni me sukses fëmijën në këtë situatë në vend që të ndëshkohet fizikisht?

1. Bëjini të qartë se jeni të zemëruar, përshkruani se cili është problemi dhe sulmoni atë (shpjegoni pasojat që mund të ndodhin për shkak të problemit), jo fëmijën!

Jam shumë i/e zemëruar që po të kërkoj disa herë të mbledhësh lodrat, ndërsa ato janë ende në dysheme, në krevat, në tavolinë. Nëse ato qëndrojnë kështu, dikush mund të pengohet, të shkelë njërën dhe të thyhet, ndërsa nuk mund të shtrihesh rehat në një shtrat plot me lodra.

2. Bëjini të qarta pritshmëritë tuaja!

Është koha për të fjetur dhe duhet t'i vendosësh lodrat në vendet e tyre.

3. Tregoni se si mund të zgjidhet problemi tani ose në të ardhmen (mund të futet edhe loja mandej)!

Mund të luajmë një këngë dhe derisa zgjat kënga – vendos kubet në shportë, librat në raft, shkumësat me bojë në kuti.

4. Ofroni zgjedhje!


Dëshiron së pari t'i heqësh lodrat, pastaj të veshësh pizhamet, apo të veshësh pizhamet së pari dhe më pas të heqësh lodrat?

5. (nëse sjellja e padëshiruar vazhdon) Paralajmëroni fëmijën për atë që do të pasojë (pasojë e natyrshme e sjelljes, por assesi ndëshkim fizik)!

Nëse nuk i vë lodrat në vendin e tyre para se të shkosh në shtrat dhe njëra prej tyre thyhet për shkak të kësaj, nuk do të blejmë një të re këtë muaj. Paratë për këtë janë shpenzuar.

6. Nëse sjellja e padëshiruar vazhdon, jini këmbëngulës për atë që u tha më parë.

FP 11: Në shtëpi – në punë

|  | Aktivitetet që ndërlidhen me shtëpinë ose me punën |
|---|--|
| 06:00-07:00 | |
| 07:00-08:00 | |
| 08:00-09:00 | |
| 09:00-10:00 | |
| 10:00-11:00 | |
| 11:00-12:00 | |
| 12:00-13:00 | |
| 13:00-14:00 | |
| 14:00-15:00 | |
| 15:00-16:00 | |
| 16:00-17:00 | |
| 17:00-18:00 | |
| 18:00-19:00 | |
| 19:00-20:00 | |
| 20:00-21:00 | |
| 21:00-22:00 | |
| 22:00-23:00 | |
| 23:00-24:00 | |

FP 12: Harta e burimeve në vendin tonë

Ju lutemi, renditni më poshtë të gjitha institucionet, kompanitë, OJQ-të, profesionistët që njihni, të cilët mund t'ju ndihmojnë në realizimin e suksesshëm të rolit tuaj si prind!

| |
|-----|
| 1. |
| 2. |
| 3. |
| 4. |
| 5. |
| 6. |
| 7. |
| 8. |
| 9. |
| 10. |
| 11. |
| 12. |
| 13. |
| 14. |
| 15. |
| 16. |
| 17. |
| 18. |
| 19. |
| 20. |
| 21. |

**PYETËSOR PËR PRINDËR PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT
“PRINDËRIMI POZITIV”**

Të nderuar prindër,

Para jush është një pyetësor vlerësimi që është anonim, ndaj ju kërkohet të jepni përgjigje të sinqerta. Përgjigjet do të përdoren ekskluzivisht për vlerësimin dhe përmirësimin e Programit.

Ju lutemi rrethoni një numër në shkallë nga 1 deri në 4 që shpreh më mirë mendimin tuaj për secilin pohim më poshtë.

1-Nuk pajtohem

2-pjesërisht pajtohem


3-Shumë pajtohem

4-Plotësisht pajtohem

Ju falënderojmë paraprakisht!

| | Pohimi | Vlerësimi |
|-----|---|------------------|
| 1. | Programi i përmbushi pritjet e mia | 1 2 3 4 |
| 2. | Punëtoritë më bënë të ri-mendoj prindërimin tim | 1 2 3 4 |
| 3. | Mësova shkathtësi të reja (lidhja, monitorimi, pranimi) | 1 2 3 4 |
| 4. | Shkëmbeva përvoja me prindër të tjerë | 1 2 3 4 |
| 5. | U ndjeva rehat dhe e pranuar nga të tjerët në punëtoritë | 1 2 3 4 |
| 6. | Tashmë fotografia për fëmijën tim është ndryshe | 1 2 3 4 |
| 7. | Tani lexoj më shpesh me fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 8. | Tani e kam të qartë se si të inkurajoj mësimin dhe zhvillimin e fëmijës tim në shtëpi | 1 2 3 4 |
| 9. | Të dashurit e mi shohin një ndryshim | 1 2 3 4 |
| 10. | Ndjej se jam një prind më i suksesshëm | 1 2 3 4 |
| 11. | I identifikoj më mirë nevojat e fëmijës tim | 1 2 3 4 |
| 12. | Luaj më shpesh me fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 13. | Vërej pika të forta tek fëmija im që nuk i njihja më parë | 1 2 3 4 |
| 14. | Fëmija im po sheh një ndryshim | 1 2 3 4 |
| 15. | Di se si stresi ndikon në prindërimin tim | 1 2 3 4 |
| 16. | Kur bëj diçka në shtëpi, di si ta përfshij fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 17. | E kuptova dëmin e ndëshkimit fizik | 1 2 3 4 |
| 18. | I vërej pikat e mia të forta dhe pikat e forta të familjes sonë | 1 2 3 4 |
| 19. | E njoh rëndësinë që të dy prindërit të kujdesen për fëmijën | 1 2 3 4 |
| 20. | Mendoj se si të kujdesem për veten si prind | 1 2 3 4 |
| 21. | Di se çfarë është zhvillimi i hershëm i fëmijës dhe pse është i rëndësishëm | 1 2 3 4 |
| 22. | Si prind kam më shumë vetëbesim | 1 2 3 4 |
| 23. | Në vendim tim, ekzistojnë shumë njerëz dhe burime në të cilat mund të mbështetem | 1 2 3 4 |

Gjithsej, në sa punëtori keni marrë pjesë? -----



PROGRAMI PËR MBËSHTETJE TË FAMILJES PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË FËMIJËVE NË SHTËPI



1. Hyrje

Mbështetja prindërore bazohet në dinjitetin e barabartë të prindërve dhe fëmijëve, si dhe në ndërveprimin cilësor ndërmjet fëmijës dhe prindërve nga njëra anë dhe praktikuesit me prindërit nga ana tjetër. Programi për prindërim pozitiv, si pjesë përbërëse e këtij koncepti, përmban pikënisje teorike dhe strategji konkrete që do t'i ndihmojnë prindërit të zhvillojnë aftësitë prindërore dhe aftësitë për ndërveprim pozitiv me fëmijët. Ekziston një konsensus i fortë për atë se prindërit janë mësuesit kryesor dhe më të rëndësishëm të fëmijëve. Që nga lindja e fëmijës, familja është e përfshirë në zhvillimin dhe mësimin e fëmijës, ndërsa sot, kur prindërit përballen me sfida të shumta në jetën bashkëkohore, prindërimi meriton më shumë mbështetje. Programet për mbështetje të prindërimit në kopshte, ndër të tjera, kanë pikënisjen e tyre në të kuptuarit e faktit se mësimi dhe zhvillimi më i hershëm i fëmijës ndodh në familje dhe se përmes kontekstit familjar themeli i të mësuarit dhe zhvillimit të fëmijës ndërtohet në të gjitha kontekstet tjera, ndër të cilat kopshti është ndër të parët. Programi promovon rëndësinë e zhvillimit të hershëm dhe si një program i hartuar në mënyrë universale, ai mund të zbatohet në çdo familje. Duke qenë se zhvillimi i hershëm është një periudhë e mundësive dhe ndjeshmërisë më të madhe, sa më herët të ofrohet mbështetje për pjesëmarrje cilësore të prindërve në nxitjen e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijës, aq më gjatë zgjasin efektet pozitive tek fëmija. Për të siguruar barazi dhe sinergji të praktikave edukative të prindërve dhe edukatorëve, është e nevojshme që programet e mbështetjes së prindërve të integrohen në programin ekzistues të institucionit parashkollor, si dhe të jenë specifike dhe të larmishme. (KËSHILLIMORE PËR PRINDËRIT). Një mbështetje e tillë prindërore nxit zhvillimin e hershëm të çdo fëmije, kontribuon në realizimin me sukses të objektivave të programit të institucioneve parashkollore, përmirësimin dhe avancimin e shërbimeve dhe paraqet bazë për bashkëpunim cilësor dhe partneritetet me familjen, pasi riafirmon rolin e prindërve, duke bërë përpjekje që prindërit të ndërtojnë dhe avancojnë aftësitë e inkurajimit të mbështetjes dhe kujdesit. Në këtë mënyrë, programet për mbështetje bëhen të disponueshme për të gjithë prindërit, duke respektuar specifikat e kontekstit familjar dhe duke forcuar kapacitetin dhe ndjeshmërinë e profesionistëve/praktikuesve në kopsht për të punuar me prindërit. Në këtë mënyrë afirmohet rëndësia e rolit të prindërve dhe kujdestarëve në krijimin e një mjedisi nxitës në kopsht dhe në shtëpi, si dhe për pasurimin e përvojave të fëmijëve që nga mosha më e hershme.

Programi për mbështetje të familjeve për mësimin dhe zhvillimin në shtëpi promovon universalitetin, orientimin drejt marrëdhënieve, përshtatjen e intensitetit të mbështetjes, me përqendrim në nevojat e familjes dhe mbështetje të përfshirjes së të dy prindërve në kujdes. Si koncept, përmban një sërë masash që ndërmerren me një qëllim të vetëm - ndërtimin e marrëdhënieve cilësore midis prindërve dhe fëmijëve, sepse marrëdhëniet janë themeli i zhvillimit. Programi është hartuar përmes një qasjeje universale që synon të mbështesë prindërit dhe kujdestarët në krijimin e një mjedisi stimulues për zhvillimin e fëmijës në të gjitha fushat (kognitive, emocionale, sociale, motorike dhe të të folurit), si një mbështetje e njëhershme për avancimin e mirëqenies së familjes dhe tejkalimin e sfidave me të cilat përballen shumica e familjeve në Maqedoninë e Veriut. Në të njëjtën kohë, programi mundëson që te prindërit tek të cilët janë çrregulluar aftësitë për ofrimin e pjesëmarrjes së fëmijës në rutinat dhe të mësuarit përmes lojës (prani e neglizhencës dhe ndëshkimit fizik të fëmijës, familjet e varfra, me prindër të pashkolluar ose të papunë, nënat e mitura, veçanërisht nën 15 vjeç, familje në izolim territorial ose shoqëror me aftësi të kufizuara ose me probleme të shëndetit mendor (prindër, familje birësuese), të planifikohet në mënyrë ekipore një mbështetje më intensive e familjes. Duke pasur parasysh mundësinë për zbatim të një qasjeje të diferencuar ndaj mbështetjes së familjeve, programi e respekton kontekstin familjar dhe shumëllojshmërinë kulturore të familjeve. Programi në veçanti e thekson dëmin e ndëshkimit fizik. Po ashtu, është hartuar të jetë elastik, për organizatat dhe institucionet

e ndryshme (OJQ, shoqata), të mund të zbatojnë programin në komunitet dhe ta integrojnë atë në ndërhyrjet dhe shërbimet ekzistuese për prindërit, duke ndërtuar Rrjet për mbështetje të vendosjes së partneriteteve në komunitetin lokal. Prandaj, programi është ndërveprues, në sajë të një hapësire të re për punë me individë, që nuk nënkupton “të pritët” që familjet ti shprehin problemet, por ka për qëllim parandalimin dhe përmirësimin, si dhe dukshmërinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve për mbështetje të familjeve. Programi i ndryshon këndvështrimet e punonjësve profesional në kopsht, sepse kërkon rishqyrtimin e praktikave personale dhe ndryshim të përqendrimit drejt anëve të forta të familjes, nën supozimin që të gjithë familjet, bile edhe ato më të cenueshmet, kanë kapacitet të nxisin zhvillimin e fëmijës. Ndjenja e efikasitetit dhe kompetencës në rolin e prindit është një nga rezultatet e programit, për të cilën nevojitet reflektim i përhershëm, ndjekje dhe vlerësim të programit, me qëllim të ndërtimit të kompetencave praktike dhe reflexive dhe përgjegjësi profesionale të të gjithë të punësuarve në kopsht.

Mirë se vini në Programin për mbështetje të familjes për mësim dhe zhvillim të fëmijëve në shtëpi!

2. Bazat teorike të programit

Rëndësia e marrëdhënies prind-fëmijë në fëmijërinë e hershme - Hulumtimet tregojnë që zhvillimi i trurit është kumulativ dhe shumë i ndjeshëm ndaj ndikimeve nga mjedisi, kështu që përvojat e hershme, mjedisi dhe marrëdhëniet e vendosin bazën për zhvillimin e mëvonshëm. Mësimi dhe zhvillimi nuk mund të shihen të veçuara nga mjedisi fizik dhe psikik, ku **marrëdhëniet** luajnë rol kyç në mësim. Është e njohur që çdo ndërveprim (pozitiv, negativ, ose i munguar) kontribuon për zhvillimin e trurit të fëmijës dhe i vendos bazat për mësimin e mëvonshëm. Fëmija e përjeton botën përmes marrëdhënieve të cilat i vendos dhe zhvillon, ndërsa këto marrëdhënie e formësojnë dhe e përcaktojnë zhvillimin dhe të nxënit e tij. Duke filluar nga ndërlidhja me kujdestarin primar në moshën më të hershme, përmes marrëdhënieve të cilat fëmija i zhvillon me të moshuarit tjerë dhe fëmijët, marrëdhëniet janë bazat fillestare dhe mbështetja mbi të cilat bazohet i tërë zhvillimi dhe mësimi.

Si ndërtohet marrëdhënia? Aftësia për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie është një proces i përjetshëm, por fillimi i saj disi nis para lindjes së fëmijës dhe mund të shihet në ditët dhe javët e para të jetës së foshnjës. Pas lindjes, fëmija është në mënyrë biologjike i "programuar" për ndërlidhje shoqërore. Fëmijët lindin si qenie shoqërore - ata janë të orientuar ndaj të tjerëve dhe në lidhje me ta janë të përgatitur të komunikojnë dhe të marrin pjesë në ndërveprim me mjedisin, por edhe të fillojnë, presin dhe të kërkojnë një ndërveprim të tillë (Shonkoff, Phillips, 2000; Dalli, White, Rockel, Duhn, 2011; Center for developing child, 2004–2020).

Sipas teorisë së ndërlidhjes afektive, lidhshmëria zhvillohet midis prindit dhe fëmijës, ndërsa fillon si një grup sinjalesh të lindura që thërrasin prindin pranë fëmijës (qarje, buzëqeshje, kontakt vizual etj.), përmes përsëritjes së vazhdueshme të ndërveprimeve (sinjalet dhe përgjigjet e prindërve ndaj tyre), me kalimin e kohës zhvillohet një lidhje afektive, në të cilën kontribuojnë aftësitë njohëse dhe emocionale të fëmijës dhe përvoja e kujdesit të butë (Berk, 2008). Cilësia e ndërveprimeve është bazë për formimin e lidhshmërisë së sigurt afektive, e cila konsiderohet për bazë të zhvillimit të kapacitetit për besim, marrëdhënie të qëndrueshme dhe cilësore gjatë tërë jetës, por edhe për funksionim shoqëror të shëndetshme dhe emocionale (de Wolf, van Ijzendoorn, 1997; Cummings, Cummings, 2002; Esposito et al, 2017.). Marrëdhëniet cilësore të cilët e mbështesin mirëqenien dhe kompetencat e fëmijës nënkuptojnë lidhje afektive me një qenie tjetër njerëzore, qoftë prind, fëmijë tjetër, kushëri, fqinj, edukator ose cilido qoftë person tjetër që ka një rol të rëndësishëm në jetën e fëmijës. Mungesa e marrëdhënies së tillë me së paku një person, e ngadalëson zhvillimin dhe mund të ketë numër të madh të pasojave negative. Vendosja e marrëdhënieve të forta afektive, po ashtu e mbështet dhe fuqizon gatishmërinë e fëmijës të zbulojë, njoftojë dhe ti rishqyrtojë veçoritë e ndryshme të mjedisit të menjëhershëm fizik, social dhe simbolik dhe për t'u zhvilluar dhe mësuar përmes këtij procesi. Provat nga hulumtimet tregojnë se efektet më pozitive në zhvillimin e fëmijës fitohen nëse marrëdhëniet me fëmijën janë *të ngrohta, të kujdesshme, të përgjegjshme dhe të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe veçoritë e fëmijës*. (Shonkoff, Phillips, 2000)

Çfarë është kujdesi cilësor? – Pikëpamja bashkëkohore e prindërimit në fushën e zhvillimit të hershëm përmes konceptit të **kujdesit stimulus**, përcakton komponentët më të rëndësishëm të kujdesit cilësor për fëmijën. Ky koncept thekson se, për mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve, nga fëmijëria më e hershme është i rëndësishëm mjedisi në të cilin bashkohen **kujdesi përkujdesës**, i cili është i orientuar kah nevojat fiziologjike, emocionale dhe sociale të fëmijës, si dhe nevojës së tij për pavarësi, dhe **kujdes stimulus**, i cili siguron mundësi për mësim i cili bazohet në hulumtim, lojë dhe pjesëmarrje. Koncepti i kujdesit stimulus (Britto PR, Lye SJ, Proulx K, et al., 2017) dallon pesë fusha të mjedisit nxitës, të cilat ndërthuren njëra me tjetrën: kujdesi për shëndetin,

kujdesi për të ushqyerit, kujdesi reagues, siguria, mundësitë e të mësuarit në fëmijërinë e hershme. Në të njëjtën kohë, çelësi i konceptit është përqendrimi i prindërve te nevojat e fëmijës, aftësia e tij për t'i vërejtur, njohur, kuptuar dhe për t'iu përgjigjur atyre, respektivisht **reagimi**. Reagimi nuk i referohet vetëm përqendrimin në nevojat fiziologjike të fëmijës, por edhe mënyrën sesi prindi i përmbush nevojat e fëmijës - mënyrën se si e lëndon fëmijën, si flet me fëmijën, si e përfshin dhe si e mbështet atë. kontaktet e tij sociale, gjë që paraqet një nga bazat për zhvillimin e sigurisë emocionale në marrëdhëniet midis prindit dhe fëmijës. Përpos në lojëra, reagimi është i dukshëm edhe në fjalimin që i drejtohet fëmijës, qasja e prindit në të ushqyerit e fëmijës (Black, Aboud, 2011) dhe në një sërë ndërveprimesh tjera të cilat kontribuojnë për një mjedis nxitës (Richter, 2004; Eshel, Daelmans, Cabral deMello, Martines, 2006).

Fëmijët mësojnë përmes situatave që janë të rëndësishme për ta dhe që kanë rëndësi personale për ta, dhe për këtë arsye është e rëndësishme që fëmija të ketë marrëdhënie në të cilat ai përjeton siguri dhe mirëqenie - si dhe liri për të hulumtuar dhe për të marrë pjesë në jetën e familjes. Në moshën e hershme, çdo situatë shihet si një mundësi për mësim. Rrjedhimisht, fëmija mëson përmes situatave të ndryshme - lojës (që i mundëson atij të hulumtojë, të jetë krijues, të manipulojë objektet që e rrethojnë), pastaj ai mëson përmes ritualeve dhe rutinave të ndryshme në familje, si dhe në situata të jetës në të cilat e gjithë familja merr pjesë. Programi për mbështetje të familjes për mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve nis nga fakti që mësimi dhe zhvillimi realizohen gjatë gjithë ditës, nëse ekziston një mjedis stimulues. Së këndejmi, programi e thekson rëndësinë për zhvillim të aftësive të prindërve për të krijuar një mjedis të atillë në **shtëpi** edhe në fushat vijuese: *koha e lirë e familjes, pjesëmarrja në rutina, loja e përbashkët, biseda me fëmijën dhe leximi me fëmijën*.

2.1. Vlerat themelore të programit - pranimi dhe pjesëmarrja

Pranimi të fëmijës si kompetent i paraprin aftësia e *lidhjes* me fëmijën dhe *ndjekja/njohja* e fëmijës. Prindi që është i interesuar të investojë emocionalisht tek fëmija, respektivisht që është i lidhur me fëmijën, do ta ndjekë fëmijën: do ti vërejë dhe do ti njohë sinjalet e fëmijës, do t'i interpretojë ato në mënyrë adekuate dhe do të jep përgjigje adekuate; do të krijojë një mjedis stimulues në shtëpi (rutina, lojëra, biseda me fëmijën, lexim me fëmijën, kohë e lirë) dhe do të mbështet interesimin e fëmijës. Vetëm kështu ai do të mund ta pranojë fëmijën, sjelljen e tij, interesimet, aftësitë dhe veten e tij në rolin e prindit. Pranimi i veçorive, ndjenjave dhe mënyrën së sjelljes së vetë, si dhe të njëjtave te fëmija, pa gjykuar, ndihmon në të kuptuarit se prindërimi në vete bart sfida të ndryshme. Pranimi i tillë nuk do të thotë heqje dorë nga përgjegjësia për edukimin dhe drejtimin e fëmijës, por do të thotë njohje se sfidat dhe gabimet janë pjesë përbërëse e prindërimit. Prindërit që besojnë se janë të aftë dhe efektivë, krijojnë ndërveprime me fëmijën në një mënyrë që nxit zhvillim adekuat (Duncan LG, Cootsworth JD, Greenberg MT, 2009).

Pjesëmarrja e fëmijës është e kushtëzuar nga bindjet dhe vlerat që praktikuesit dhe prindërit i kanë për fëmijën. Kur fëmija shihet si një person kompetent dhe pranohet si i tillë, me përqendrim në forcat, aftësitë, shkathtësitë dhe potencialin e tij, praktikant edukative të të moshuarve mund të ofrojnë shumë mundësi për pjesëmarrjen e fëmijës në jetën e familjes dhe në kopsht. Me pjesëmarrjen, fëmijët zhvillojnë një nivel më të lartë të kompetencave, gjë që rrit cilësinë e pjesëmarrjes. Fëmijët mësojnë duke marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta (rutina familjare, rituale, lojëra) me të moshuarit dhe fëmijët e tjerë. Fëmijët kanë nevojë për mundësi për të marrë pjesë aktive, për t'u përfshirë në vendimmarrje, për të shkëmbyer informacion dhe për të marrë pjesë në dialog me fëmijët dhe të moshuarit e tjerë, për të ndjerë respekt dhe shkëmbim të ndërsjellë, për t'u këshilluar dhe për të ndjerë se ndjenjat dhe mendimet e tyre janë të rëndësishme, të shohin se idetë, pritjet dhe ndjenjat e tyre çojnë në ndryshim, në pjesëmarrjen e tyre të kontribuojnë për

diçka që të moshuarit e bëjnë dhe e konsiderojnë të rëndësishme dhe domethënëse. Përveç mënyrës së të kuptuarit të fëmijës, ndaj pjesëmarrjes së fëmijës ndikon edhe njohuria e prindërve dhe edukatorëve për mënyrën se si fëmija mëson, si dhe cilësia e marrëdhënieve me fëmijën dhe rreth fëmijës.

2.2. Çfarë është të mësuarit përmes pjesëmarrjes në rutina?

Të mësuarit e fëmijës nuk nënkupton mësimdhënie e fëmijëve për njohuri dhe aftësi, përmes përfshirjes në shkolla dhe kurse të ndryshme, por zbatim i bindjeve dhe praktikave prindërore në **rutinat familjare**. *Rutinat janë aktivitete të përditshme të vazhdueshme në familje, të cilat janë të pasura me sfida dhe mundësi për mësim-nxënie*. Përderisa për të moshuarit mësim-nxënia do të thotë mësimdhënie, njohuri riprodhuese, përfshirje e fëmijëve në shkolla dhe kurse për përvetësim të njohurive dhe aftësive, për fëmijën gjendja e mësimimit para së gjithash do të thotë ekzistencë dhe dispozicion për NXITJE interesante. Fëmija mëson më së miri në marrëdhënie të cilat karakterizohen me besim, siguri, ngrohtësi dhe respektim të këndvështrimit të fëmijës. Lidhja e këtillë midis prindit dhe fëmijës e nxit gatishmërinë e fëmijës për të mësuar me të moshuarit. Nxitjet "fshihen" në rutinat e përditshme të familjes, në kohën e lirë të familjes, në ritualet e familjes, sepse ato janë të pasura me sfida dhe mundësi për mësim dhe zhvillim. Në këtë mënyrë, pjesa më e madhe e detyrave të shtëpisë mund të bëhen një mundësi për kënaqësi dhe kohë cilësore të kaluar me fëmijën, kohë kur prindërit mund ti kryejnë obligimet e tyre të zakonshme dhe në të njëjtën kohë t'i ofrojnë fëmijës një sërë nxitjesh të çmuara për zhvillim. Përgatitja e vakteve, renditja dhe palosja e rrobave të thata, nderzja e lavatriçes, shkuarja në shitore, paraqesin aktivitete që shumica e prindërve i kryejnë çdo ditë, e disa prej tyre edhe disa herë në ditë. Kur fëmija do të përfshihet në një mënyrë të përshtatshme për moshën, ashtu që së bashku me prindin do të lajë frutat dhe do ti radhis në enë të ndryshme sipas ngjyrës dhe formës, ose, le të themi, duke qëruar një banane dhe duke e shtypur për një smoothie, duke i nxjerrë produktet nga çanta pas blerjes, ose do ti palos çorapet e thara, para fëmijës hapen shumë mundësi për zhvillim të të gjitha aftësive të rëndësishme (besimi dhe siguria të njerëzisë dhe afërt, aftësitë sociale dhe emocionale, kërkuesia dhe iniciativa, pavarësia, aftësitë njohëse dhe motorike). Nga ana tjetër, prindërit në këto situata kanë mundësinë të kryejnë rutinat e tyre të zakonshme dhe në të njëjtën kohë, nëpërmjet stimuljeve të vegjël që nuk kërkojnë kohë apo hapësirë shtesë, të nxisin zhvillimin e fëmijës.

Aktivitetet në të cilat fëmijët marrin pjesë në shtëpi janë pak a shumë të strukturuar (Jaros et al. 2010). Rutinat formale, shumë të strukturuar të mbajtjes së higjienës dhe përgatitjes së vakteve, u mundësojnë fëmijëve jo vetëm të "ushtrojnë" aftësi konkrete, por edhe të kuptojnë korrektësinë, radhitjen e ngjarjeve, aktivitetet elementare, ndërlydhjen e hapave, por edhe rëndësinë e bashkëpunimit. Çdo familje ka po ashtu edhe rutina të pa strukturuar (blerje, shëtitje, lexim, kohë e lirë, etj.) të cilat janë më elastike, spontane dhe mundësojnë një udhëheqje më të madh nga fëmija.

Efektet e pjesëmarrjes së fëmijëve në rutinat dhe ritualet familjare mund të shihen edhe kur bëhet fjalë për zhvillimin e aftësive socio-emocionale të fëmijës, veçanërisht në fushën e rregullimit emocional, shëndetit fizik dhe mendor të fëmijëve, por edhe përshtatjes së fëmijëve dhe familjes në tërësi në momentet e pritshme kalimtare (siç është nisja në kopsht) dhe arritjet akademike të fëmijëve në të gjitha nivelet e arsimit (Ferretti & Bub, 2017; Chen, 2017; Ren & Fan, 2019). Pjesëmarrja e fëmijëve në rutinat dhe ritualet e jetës familjare inkurajohet më rrallë në familjet ku prindërit kanë një nivel më të ulët arsimor (Guichard & Grande, 2019), por edhe në familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zhvillim (Mancini dhe Coster 2004; Rosenberg et al. 2010a). Megjithatë, që rutinat të bëhen mundësi për mësim dhe zhvillim të fëmijës, nevojitet që prindi:

- Ti mbikëqyr me kujdes nevojat e fëmijës, të mbikëqyr se si fëmija i shpreh ato dhe kuptojë sa më mirë mënyrën se si reagon fëmija në situata të ndryshme.
- Vazhdimisht tu përgjigjet sinjaleve të fëmijës dhe ti ofrojë mbështetje që fëmija ti përbush nevojat e tij.
- Në çfarëdo forme të iniciativës nga ana e fëmijës (buzëqeshje, lëvizje, shikim, drejtim me gisht), prindi t'ia rikthejë (me buzëqeshje, me imitim, me drejtim të vëmendjes kah gjësendi i interesimit të fëmijës, me emërtim). Ashtu në mënyrë plotësuese do të zgjerohet ndërveprimi dhe do të mundësohen mundësi plotësuese për nxitje të zhvillimit.
- Me kujdes të ndjek se çfarë është ajo që ia ka tërhequr vëmendjen fëmijës, të mbështes dhe të nxis iniciativën në drejtimin në të cilin udhëzon fëmija. Për shembull, nëse fëmija tregon me gisht kah libri me figura, prindi mund ti thotë: „Shiko, libër me figura, le ta lexojmë së bashku“.
- Ti mundësojë fëmijës të jetë sa të jetë e mundur më i pavarur në aktivitetet të cilat ai dëshiron ti realizojë dhe të jetë mbështetje në atë proces, vetëm për t'ia mundësuar kushtet e nevojshme fëmijës që ta realizojë qëllimin e tij, që është e kundërta e kryerjes së aktiviteteve në vend të fëmijës. Në këtë kuptim, me rëndësi është që prindi të besojë se fëmija është kompetent dhe i aftë, i përgatitur të njohë dhe të zhvillohet.
- Të bisedojë me fëmijën, ti flet fëmijës (ti emërtojë gjërat të cilat fëmija i bën) dhe t'ia përshkruajë fëmijës gjendjet e ndryshme gjatë ndërrimit të veshjes, përgatitës së vakteve, shkuarjes në shitore ose cilitdo aktivitet tjetër.

Përveç marrëdhënies së sigurt me prindërit, respektivisht kujdestarët, me rëndësi është që edhe ambienti i fëmijës të jetë nxitës. Çfarë do të thotë saktësisht kjo? Një mjedis nxitës është i mbushur me mundësi për të mësuar dhe hulumtuar, me përmbajtje që paraqesin mbështetje për zhvillimin e fëmijës dhe që janë të harmonizuara me moshën.

Me pjesëmarrjen në rutina, fëmija ka mundësi të zhvillojë dhe të ndërtojë marrëdhënie me të moshuarit (në treg, në shitore, me fqinjët), të marrë pjesë në vendimmarrje (ulem dhe ha një mollë për një meze të lehtë ose ha një mollë dhe loz) të kontribuojë në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përbashkëta (për shembull duke marrë pjesë në përgatitjen e tryezës së drekës). Rutinat tek fëmija zhvillojnë përgjegjësi, pavarësi dhe ndjenjë të parashikueshmërisë, sigurisë dhe përkatësisë ndaj familjes. Nëpërmjet rutinave, fëmija zhvillon aftësi të ndryshme, duke mësuar përmes imitimit të të moshuarve. Rutinat duhet të jenë një përvojë e këndshme sociale e përbashkët familjare që ofron kënaqësi dhe gëzim në komunikimin me anëtarët e familjes. Pjesëmarrja e fëmijës në rutinat familjare përcaktohet nga mosha e fëmijës dhe është e vlefshme sepse u mundëson prindërve të rishikojnë pasqyrën që e kanë për fëmijën e tyre, duke u përqendruar në pikat e forta dhe aftësitë e fëmijës.

Pjesëmarrja e fëmijës në rutinat e jetës familjare ashtu siç fëmija rritet, ofron gjithnjë e më shumë mundësi për të mësuar përmes lojës. Rutinat e përgatitjes së një vakti, të shkuarit në shitore dhe të tjera, mund të bëhen mundësi për mësim dhe zhvillim kur ato janë të bazuara në lojën me prindin. Prindi i cili do ti mundësojë fëmijës të marrë pjesë në rutinat familjare, do të mundësojë njohje dhe hulumtim të fëmijës në një mënyrë të natyrshme - përmes lojës. Pjesëmarrja e fëmijës në rutinat familjare përcaktohet nga mosha e fëmijës dhe është e vlefshme sepse u mundëson prindërve të rishqyrtojnë imazhin të cilën e kanë për fëmijën e tyre, duke u përqendruar në pikat e forta dhe aftësitë e fëmijës. Në mënyrë që prindi t'i mundësojë fëmijës të marrë pjesë në rutina, përveçse ritmit elastik dhe të vazhdueshëm të rutinave, prindi duhet ta pranojë fëmijën edhe si anëtar kompetent të familjes dhe të dijë të përshtatë pjesëmarrjen e fëmijës me

moshën, karakteristikat, temperamentin dhe interesat e fëmijës. Aftësia e prindit për të mundësuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e një fëmije në rutina mbështetet tek ajo se sa prindi mund të kuptojë këndvështrimin e fëmijës, por po ashtu edhe të njohë se çfarë mundësish për mësim dhe ndërveprim ofron secila prej këtyre rutinave për fëmijën e tyre. Në këtë kuptim, ajo po ashtu mbështetet në pranimin e fëmijës dhe njohjen e interesimeve të fëmijës dhe repertorin e aftësive të fëmijës i cili ndërvepron me mjedisin.

Pjesëmarrja e fëmijës në rutina krijon nxitje të fuqishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e aftësive nga të pesë fushat e zhvillimit të fëmijës. Me pjesëmarrjen e fëmijës, për shembull, në rutinën e banjës, fëmija mund të mësojë të të derdhë ujë, të prekë ujin, të spërkasë, të prekë sapunin dhe shkumën, të emërtojë gjërat, të ndjekë rendin e gjërave gjatë larjes, të mësojë për të nxehtin dhe të ftohtin, të lagëtën dhe të thatën, të mësojë të presë, të jetë i përgjegjshëm, kureshtar e të tjera. Megjithatë, kjo situatë në të cilën merr pjesë fëmija është në fakt e pasur me marrëdhënie, sepse është e mbushur me shkëmbime të qeshurash, biseda, afërsi me prindin, është argëtuese për fëmijën, ka kuptim për fëmijën, fëmija mëson se meriton vëmendje, se të tjerët kujdesen për të, ai mëson për marrëdhëniet me të tjerët dhe botën përreth tij. Larja mund të jetë një mundësi për mësim dhe zhvillim, por vetëm nëse pranë fëmijës ka një prind që di të bëjë që fëmija të marrë pjesë në rutinën e larjes dhe kur rutina ka karakteristika të lojës. Pra, mundësitë e fëmijës për të "përdorur" nxitjet do të varen nga aftësia për kujdesin ndaj fëmijës.

Nxitjet për mësim dhe zhvillim janë të fshehura *në kohën e lirë* të familjes, gjatë shëtitjeve të përbashkëta, daljeve, kur prindi për shembull, bën lojë fjalësh. Duke marrë pjesë, për shembull, në shitblerje, fëmija mund të mësojë se si të planifikojë furnizimet, të bëjë ose të vizatojë një listë ushqimore, të emërojë produktet ushqimore, të praktikojë "vëmendjen e ndarë", të mësojë të mbajë çantën, të mësojë dhe fitojë përvojë si dhe çfarë të pyes të moshuarit në treg, si parashtrohet pyetja dhe si pritet përgjigja, si maten perimet, si të telefonohet në rrugë, çfarë është e sigurt dhe të tjera. Mirëpo, edhe kjo situatë në të cilën fëmija merr pjesë është në të vërtetë e pasur në marrëdhënie, sepse ka shumë shkëmbime, ndërsa fëmija mëson për veten, për botën rreth tij, si dhe për marrëdhëniet. Është aftësia e prindit që ta bëjë shitblerjen një mundësi mësimi dhe zhvillimi.

Nxitjet për mësim dhe zhvillim janë edhe *ritualet e festave*, përgatitja për shtrat, përsëhendetjet, e të tjera, të cilat janë më pak të strukturuar dhe kontribuojnë në një ndjenjë afërsie dhe bashkësie.

Rutinat janë specifike për kontekstin e çdo familjeje, ndërsa profesionistët që punojnë me fëmijët duhet të zhvillojnë një ndjenjë për rutinat familjare, t'i njohin ato dhe të mbështesin prindërit për të mundësuar pjesëmarrjen e fëmijëve në to. Çdo familje ka rutinat e veta dhe secila nga ato rutina nuk duhet të bëhet në mënyrë rutinore, por duhet të mundësojë që rutinat të njihen si mundësi për mësim dhe zhvillim dhe të realizohen në përputhje me modelin e lojës. Në botën bashkëkohore, kur prindërit nuk kanë kohë, por në thelb duan të mbështesin zhvillimin e fëmijës, shndërrimi i rutinave në lojë dhe nxitja e përditshme e zhvillimit dhe mësimi në familje, gjatë tërë ditës, për prindërit, veçanërisht nga ana e grupeve të ndjeshme, paraqet një informacion shumë të rëndësishëm.

2.3. Çfarë është të mësuarit përmes lojës?

Fëmija mëson duke lozur, ndërsa **të mësuarit përmes lojës** do të thotë krijim i situatave në të cilat fëmija mund të luajë me përvojat e përfituara. Shumë argumente të hulumtimeve bashkëkohore shkencore krijojnë hapësirë për njohjen e rëndësisë së shumëfishtë të lojës për të jetuarit, e me këtë edhe për mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të moshuarve. Loja është e ndërthurur fort me kënaqësinë dhe zhvillimin e aftësisë njerëzore për elasticitet (Marjanović, 1987) si dhe mirëqenie (Krnjaja, 2010). Loja është mënyra më e natyrshme për të mësuar një

fëmijë dhe është një qëllim më vete. Loja zë pjesën më të madhe të kohës dhe interesit të fëmijës dhe është mënyra mbizotëruese në të cilën fëmija e kupton veten dhe botën e tij, zhvillohet dhe shprehet (Lester dhe Russell, 2008). Në lojë, fëmija ndërton identitetin dhe marrëdhëniet e tij, hulumton dhe (ri)ndërton kuptimet, krijon simbole, kënaqet dhe gëzohet. Loja ngjall kureshtjen e fëmijës, dëshirën për të hulumtuar dhe ndërtuar mirëkuptim. Në këtë drejtim, *nxitje* për lojë mund të jetë cilido ndryshim, risi, punë interesante nga mjedisi, e cila e tërheq vëmendjen e fëmijës dhe me të cilin fëmija dëshiron të merret.

Nga këndvështrimi i fëmijës, loja mund të ndodhë në çdo kohë dhe kudo, lodrat nuk janë të rëndësishme për lojën, por fëmija mund të luajë me fruta, perime, tenxhere, lugë, kuti, gurë, rërë, degë, gjethe... por edhe me fjalë, personazhe, role, ngjyra, fotografi, libra, karrige, tavolina. Për prindërit, në shumicën e rasteve, loja është lodra e blerë dhe koha e ndarë veçmas, loja ka një strukturë të qartë dhe një qëllim specifik. Loja e fëmijëve të ditëve të sodit është e vetjake, sepse janë të pranishëm vetëm një numër i vogël moshatarësh, loja zhvillohet zakonisht me lodra të gatshme, kryesisht në ambiente të mbyllura. Gjatë lojës, të moshuarit zakonisht janë në rolin e vëzhguesve pasiv dhe aktiv. Mbështetja e prindërve në lojë fillon nga idealizimi, mos-përfshirja në lojë, deri tek ndërhyrjet në të cilat prindi merr rolin drejtues në lojë. Në kushtet e shtëpisë, fëmijët kanë pak mundësi për të luajtur me fëmijë tjerë, kështu që roli i prindërve si bashkë-lojtar dhe partnerë është më i nevojshëm për fëmijët (Gardašević, 2021). Autori thekson se fëmijët sot kalojnë kohën më të madhe në familje, pjesa më e madhe e kësaj kohe kalohet duke luajtur, prandaj është e rëndësishme se sa domethënie i kushtohet lojës së fëmijëve, si e kuptojnë prindërit nevojën e fëmijëve për të luajtur dhe si e mbështesin atë. Në lojë, është e rëndësishme që fëmijës ti jepet kohë e mjaftueshme për të integruar gjithçka që do të dëgjojë, shikojë dhe përjetojë dhe të japë përgjigjen e tij në vazhdim të ndërveprimit. Në atë ndërveprim prindi nuk duhet të ketë rol udhëheqës, edhe pse ka më shumë përvojë dhe njohuri se fëmija. Prindi nuk duhet të drejtojë lojën, por gjatë lojës duhet të jetë me fëmijën, e jo mbi fëmijën. Pasigurinë dhe rrjedhën e lojës ia lëmë situatës dhe iniciativës së fëmijës. Shpesh prindërit nuk përfshihen në lojën e fëmijëve, sepse e konsiderojnë lojën si argëtim, nuk e kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në lojë (Gardašević, 2021). Ndonjëherë përfshihen duke udhëhequr lojën dhe herë si partnerë në lojë, duke promovuar kompetencat e fëmijëve dhe duke mbështetur iniciativën e fëmijës, duke i dhënë mbështetje idesë së fëmijës për t'u realizuar në lojë dhe duke ndikuar kështu në mirëqenien e fëmijës dhe pavarësinë e tij. Roli i prindërve në lojën e fëmijës njihet nga shumë autorë: "Në kontekstin familjar, përfshirja e prindit në lojën e fëmijës çon në një nivel më të lartë cilësor të lojës" (Colić, Milošević, 2019: 161). "Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive e të moshuarve në lojën e fëmijëve është theksuar nga shumë autorë si e rëndësishme për nivelin më të lartë të cilësisë, kohëzgjatjen më të madhe dhe kompleksitetin më të madh të lojës" (Colić, Milošević, 2019:165).

Mbështetja e prindërve për nxitjet në lojë përfaqëson përvetësim të njohurive, një kuptim të përbashkët të vlerës dhe potencialit të lojës dhe rëndësisë së saj në zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijës, si dhe rolin e prindit në lojë. Për shembull, lojërat tipike të një fëmije deri në moshën 3 vjeç nxisin të gjitha fushat e zhvillimit: lojërat me rërë dhe ujë lejojnë në një mënyrë argëtuese të hulumtojnë dhe eksperimentojnë me madhësitë, format dhe peshat, dhe kështu fëmijët e kësaj moshe marrin informacion të rëndësishëm dhe njohuri praktike për botën që i rrethon. Lojërat me aktivitete të tipit "si të", "gjoja", të folurit në telefon, ushqyerja dhe trajtimi i foshnjës, e të tjera, kontribuojnë në zhvillimin e përdorimit të gjuhës, të kuptuarit e të folurit dhe pasurimin e fjalorit. Kujdesi për kukullën kontribuon në zhvillimin emocional dhe në zhvillimin e vetëdijes për të tjerët dhe nevojat e tyre. Lojërat me imitim, siç janë loja e veshjes kontribuojnë në zhvillimin e vetëdijes. Veshja e kukullës, si dhe thjesht hapja/mbyllja e enëve kontribuon në zhvillimin e muskujve të vegjël të duarve dhe zhvillimin e koordinimit të lëvizjeve të gishtërinjve dhe pëllëmbës. Veshja e këpucëve të huaja në lojërat e shtirjes ose aktivitetet gjatë "gatimit" kanë një efekt të dobishëm në zhvillimin e muskujve të mëdhenj të këmbëve dhe krahëve. (Pešikan & Antić, 2012).

Loja është aktivitet argëtues dhe vullnetar, në të fëmija është aktiv - provon, kombinon, eksperimenton, mund ta përsëris kurdo që të ketë dëshirë, mund ta ndryshojë dhe të fus ndonjë risi (të bëjë diçka më ndryshe), në lojë ka këmbim të rëndësishëm social - komunikim, marrëveshje, këmbim të ideve dhe të ngjashme. Programi e promovon idenë se të gjithë fëmijët kanë qasje në lojë me cilësi të lartë, si mundësi për mësim dhe zhvillim të potencialeve në ambientin familjar.

Fëmija është eksperti i lojës dhe fëmija përcakton se si do të zhvillohet loja. Aktivitetet siç janë leximi, këndimi i këngëve dhe vallëzimi, lojërat në këndin e lojërave, shëtitja, janë aktivitete në të cilat lozet. Fëmija mund të fillojë lojën (të shtojë një lodër, ndonjë material, t'i afrohet prindit, të tregojë me gisht, të marrë një send ose lodër, ta trajtojë atë, ta emërtojë, etj.) dhe në këtë mënyrë të thërrasë prindin në lojë. Fëmija mund të luajë i vetëm, loja e tillë është më pak e strukturuar, e **hapur**, ndërsa të moshuarit mund ta bëjnë argëtuese, ta vazhdojnë dhe ta **zgjerojnë** me pjesëmarrjen e tyre, duke shtuar ndonjë material, me qasje ndaj lodrave, me sigurimin e hapësirës për lojë, duke ftuar njerëz tjerë në lojë. Kur të moshuarit i ofrojnë rregullat, lojës i japin strukturë dhe qëllim, por fëmija edhe më tej vendos nëse dëshiron të merr pjesë apo jo, prandaj edhe lojërat e tilla të **drejtuara** mund të jenë shumë argëtuese (si për shembull loja fshihu dhe kërk). Pra, është gjithmonë e rëndësishme fëmijës ti lejohet të zgjedh lojën dhe të marrë vendime lidhur me lojën dhe të hartojë rregullat, me se sigurohet pjesëmarrja e paramenduar e fëmijës dhe ndërtohet një ndjenje respekti dhe sigurie. Fëmija do të mësojë për veten dhe botën përreth tij dhe do të zhvillojë aftësi të ndryshme përmes lojës, gjithmonë me prindërit dhe në ndërveprim me ta. Loja është një aktivitet që nënkupton drejtim diskret nga prindërit/të moshuarit që nuk do të shuajë kureshtjen, kreativitetin dhe dëshirën e fëmijëve për të luajtur, por do t'i ndihmojë fëmijët të organizojnë përvojën e tyre. Për këtë është e nevojshme që të moshuarit të mbikëqyrin dhe ndjekin me kujdes lojën e fëmijës, ta interpretojnë, ta rishqyrtojnë dhe ta thellojnë si dhe ta drejtojnë atë drejt përvetësimit të njohurive dhe aftësive të reja.

Gatehmëria për të kuptuar dhe njohur lojën si gjuhë thelbësore e fëmijës, si mënyrë në të cilën fëmija e kupton më mirë veten dhe botën përreth tij, është një aspekt i rëndësishëm për kuptimin e zhvillimit të hershëm dhe rëndësinë e nxitjes së zhvillimit. Duke i ndërtuar njohuritë për lojën, ndërtohen edhe njohuri për atë se çfarë është në të vërtetë nxitja e zhvillimit dhe si zhvillohet dhe mëson ai fëmijë. Mbështetja e lojës së përbashkët me fëmijën, siç është krijimi i një mjedisi nxitës për fëmijën që në ditën e parë të jetës, është në fakt një dëshirë ti mësojmë prindërit të krijojnë mundësi të cilat e mundësojnë lojën fëmijërore (hapësirë, kohë, disponim). Në mënyrë që prindi të mundësojë të nxënit përmes lojës, ai duhet të dijë se si fëmija mëson dhe të jetë në gjendje të njoh vlerën pedagogjike të lojës, duke arritur një baraspeshë të caktuar midis idealizimit dhe didaktikës së lojës. Prindi rishqyrton se si bindjet, përvojat dhe pritjet e tij formojnë dhe ndikojnë në perceptimin e fëmijës, sjelljen dhe reagimet e tij, respektivisht i rishqyrton përvojat e tij të mëparshme prindërore, mendon për veprimet e tij, i interpreton ato, i kupton arsyet dhe i modifikon në bazë të kësaj. Prindi i cili është i lidhur me fëmijën, e pranon fëmijën, e ndjek fëmijën (i vëren, interpreton sinjalet e fëmijës dhe jep përgjigjen e duhur), kupton këndvështrimin e fëmijës, vëzhgon me kujdes, i përgjigjet fëmijës, kupton se çfarë tregon sjellja e fëmijës, në mënyrë adekuate i interpreton interesat, ndjenjat, opinionet dhe synimet e fëmijës, krijon me mjeshtëri të mësuarit përmes lojës.

2.3.1. Leximi me fëmijën

Leximi me fëmijën është një nga ritualet, i cili ka shumë më tepër efekte sesa zgjerimi i fjalorit, sepse kontribuon në zhvillimin e kujdesit cilësor për fëmijën. Është një lloj mësimi nëpërmjet lojës (duke luajtur me fjalët, personazhet etj.), i cili është një nxitje e plotë vetëm kur përfshin ndërveprim me prindin. Për leximin nuk është e rëndësishme koha e kaluar në lexim, por mënyra e të lexuarit. Megjithatë shumë prindër mund të kuptojnë se leximi i përbashkët është i

rëndësishëm, ata mund të mos e kuptojnë rëndësinë e leximit cilësor ose çfarë është leximi cilësor. *Leximi i përbashkët* është ndërveprim në të cilin të moshuarit lexojnë së bashku me fëmijën (e përfshijnë fëmijën në lexim) dhe me fëmijën bisedojnë për atë që është lexuar, respektivisht për atë që është thënë, gjatë dhe pas leximit (van Kleeck, et al., 1997). Leximi i përbashkët si një mundësi për të mësuar dhe për zhvillimin e fëmijës inkurajon zhvillimin e shkrim-leximit, gjuhës shprehëse, të kuptuarit e të folurit, pasurimin e fjalorit, përvetësimin e fjalëve të ndërlikuara, imagjinatës, mendimit kritik, si dhe paraqet një mundësi për fëmijën të iniciojë, udhëheq, dhe të marrë konfirmimin se ai meriton vëmendjen e të tjerëve, se bota është një vend i sigurt, për të ushtruar "vëmendje e ndarë", përqendrim, për të hulumtuar librin, për të treguar, e të tjera. Shumë prindër, por edhe profesionistë, e shohin leximin si aktivitetin e tyre personal - leximin prindëror të një teksti nga libri, ndërsa detyra e fëmijës është të heshtë dhe të dëgjojë me vëmendje. Roli i fëmijës nuk është pasiv, por aktiv: fëmija vëzhgon dhe hulumton librin, e kap, e prek, e hedh, e hap dhe e mbyll, e fut në gojë, ndërsa roli i prindit është ta inkurajojë. Edhe pse në fillim të njoftimit, prindi e nis leximin, më vonë pjesëmarrja e fëmijës nënkupton që fëmija fillon leximin (do të sjellë, tregojë, marrë librin), që nënkupton se për pjesëmarrjen e tij është e rëndësishme disponueshmëria e librit (që është vetëm një mjet për vëmendje të ndarë) në raft ose në dysheme. Gjithashtu, fëmija ka të drejtë të zgjedh me kë dhe çfarë dëshiron të lexojë. Prindi duhet të mbajë me mjeshtëri kontaktin ballë për ballë (të eliminojë zhurmën, televizorin dhe shpërqendrimet e tjera), të vazhdojë ndërveprimin dhe të sigurojë afërsinë fizike (në mënyrë që ai të shohë fytyrën e fëmijës) si karakteristika të rëndësishme të një ndërveprimi që i mundëson fëmijës kënaqësi në çdo aktivitet, duke përfshirë dhe leximin e përbashkët. Leximi me fëmijën i jep prindit mundësi të ndjek fëmijën, të vërejë sinjalet, të kuptojë sinjalet e fëmijës dhe tu përgjigjet atyre në mënyrë adekuate, duke i ushtruar aftësitë dhe kompetencat e tij prindërore, të zhvillojë gatishmërinë dhe aftësinë për të ndjekur nevojat dhe reagimet e fëmijës, duke u mbështetur në iniciativën e fëmijës, të pres me durim përgjigjen e fëmijës dhe të mbështesë pjesëmarrjen e tij dhe të hedh në këtë mënyrë bazat e marrëdhënieve të sigurta, të ngrohta dhe përvojave pozitive për fëmijën. Një prind që di të bëjë pyetje, të bëjë tinguj të ndryshëm që shoqërojnë fjalimin, ta kthejë tregimin në lojë dhe të përshtat drejtimin e leximit sipas asaj se si fëmijët fitojnë njohje dhe i zgjidhin detyrat, do ta bëjë leximin një mundësi të pasur me nxitje për zhvillim dhe mësim. Prandaj, leximi me fëmijën konsiderohet një formë nxitjeje për zhvillimin, veçanërisht me rëndësi për familjet në rrezik (fëmijë me aftësi të kufizuara në zhvillim, grupe të ndjeshme, mjedise jo stimuluese dhe rurale, etj.). Prindërvet e fëmijëve që në moshë të hershme u theksohet rëndësia e leximit pas lindjes së fëmijës (disa herë në javë nga 15 minuta dhe/ose çdo ditë) dhe u ofrohet mbështetje në zgjedhjen e librave (libra bardh e zi në moshë të hershme). Nuk ka nevojë për një libër me figura apo libër të shtrenjtë për të lexuar me fëmijën, mund të lexoni çfarëdo qoftë që ka familja (qëndisma, broshura shitorësh, receta për ëmbëlsira), por fëmija duhet të ketë dikë pranë tij gjatë leximit, një prind/të moshuar që është i ndjeshëm dhe jep mbështetje, dhe në këtë mënyrë leximi përfshin kënaqësi dhe lojë.

Përmes leximit, fëmija zhvillon aftësitë e të lexuarit, dhe është e rëndësishme që programi të integrohet në punën e bibliotekave dhe librarive në komunitet (vende për lexim të përbashkët për familjet dhe fëmijët) dhe të sajohen biblioteka të hapura në parqe, kopshte, dhomat e pritjes, zyrat postare dhe bankat, në transport publik, qendra shëndetësore, OJQ dhe të tjera (më shumë informacion mund të gjeni në "Teddybear reading center") me qëllim që në komunitet të ofrohen vendeve të ndryshme për lexim me fëmijën, të cilat reduktojnë pabarazinë, varfërinë dhe sigurojnë qasje tek librat për të gjithë familjet. Mund të organizohen edhe fushata për nxitjen e leximit me fëmijën, trajnime të profesionistëve/vullnetarëve si lexues dhe manifestime publike lidhur me leximin (panair libri). Në nivel kombëtar, ministria kompetente në bashkëpunim me ministritë e tjera (për arsimin, kulturë) mund të mbështesë pajisjen e bibliotekave dhe shfrytëzimin e tyre, promovimin e leximit, me pjesëmarrje të figurave të njohura publike dhe mbështetje financiare për familjet e varfra gjatë blerjes së librave.

Leximi me fëmijën mundëson përfshirjen e profesionistëve të ndryshëm (edukatorë, aktivistë, organizata joqeveritare) të cilët janë të trajnuar për zbatim të programit për nxitje të cilësisë së kujdesit ndaj fëmijëve dhe për mbështetje të zhvillimit në fëmijërinë e hershme, duke ndërtuar kështu një rrjet për mbështetje të prindërimit.

2.4. E drejta e fëmijës dhe prindërve për mbështetje

E drejta e çdo fëmije për mjedis stimulues buron nga fakti që zhvillimi i hershëm është periudhë e ndjeshmërisë më të madhe dhe mundësive më të mëdha për mësim dhe zhvillim. Mbështetja e zhvillimit të hershëm është njohur si një nga prioritetet në dokumentet në vijim:

Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve thekson që fëmija ka të drejtë të zhvillohet “deri në masën më të lartë të mundur” dhe se vendet nënshkruese duhet të sigurojnë “ndihmë adekuate për prindërit dhe kujdestarët ligjor në kryerjen e obligimit të tyre për edukim të fëmijëve dhe të sigurojnë zhvillim të institucioneve, objekteve dhe shërbimeve për kujdes të fëmijëve”.

Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara përkujton se “nëse fëmijët e vegjël me aftësi të kufizuara identifikohen herët dhe marrin mbështetje, është më e besueshme se ata pa problem do të kalojnë drejt arsimit parashkollor dhe fillor përfshirës”. Me këtë konventë theksohet edhe roli i familjes në zhvillimin e fëmijës dhe rolin e shtetit në sigurimin e mbështetjes për familjen.

Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm (OZhQ) theksojnë se investimi në zhvillimin e hershëm të fëmijëve është bërë jo vetëm qëllim në vete, por edhe kusht për arritjen e shumë objektivave tjera për zhvillim të qëndrueshëm për çrrënjosjen e varfërisë dhe urisë dhe përmirësimi i të ushqyerit të fëmijëve, për sigurimin e jetës së shëndetshme, sigurimin e mësimin gjatë tërë jetës, arritjen e barazisë gjinore dhe zvogëlimit të pabarazisë. Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm e përfshijnë qëllimin specifik për zhvillim të hershëm fëmijëror në vijim: “Deri në vitin 2030 të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë kanë qasje në zhvillim cilësor të hershëm fëmijëror, kujdes dhe arsim parashkollor, si përgatitje për arsim fillor”. Në këtë kuptim, qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm paraqesin mundësi historike për tu dhënë përparësi investimeve në zhvillimin e hershëm fëmijëror.

Udhëzimet e OKB-së për kujdesin alternativ të fëmijëve theksojnë se “organizatat dhe organet kompetente duhet ti investojnë të gjitha përpjekjet për të parandaluar ndarjen e fëmijëve nga prindërit dhe kujdestarët e tyre primar, përpos nëse kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës” (neni 154.).

Në kohët moderne, kur prindërit përballen me sfida të shumta, mbështetja e prindërve është më se e nevojshme. Mbështetja e prindërimit është një seri aktivitete të ndryshme dhe komplekse që mund të synojnë aspekte të ndryshme të prindërimit. Moran (2004) e përkufizon mbështetjen prindërore si çdo ndërhyrje për prindërit që synon të reduktojë rrezikun, të promovojë mbrojtjen dhe mirëqenien e tyre sociale, fizike dhe emocionale. Programi i prindërimit pozitiv thekson se procesi i të mësuarit për prindërimin është shumë më tepër se edukim, pasi ai i ndihmon prindërit të pohojnë veten në rolin e tyre prindëror dhe të përmirësojnë prindërimin e tyre. Forma më e zakonshme e ofrimit të mbështetjes për prindërit është një program në grup, i cili përkufizohet si një proces që përfshin zgjerimin e njohurive dhe të kuptuarit, marrjen e njohurive dhe aftësive për zhvillimin e prindërve dhe fëmijëve të tyre dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Kur flitet për një program prindëror efektiv, në literaturë paraqiten dy modele, tradicionale dhe bashkëkohore. Qëllimi më i spikatur i programeve të prindërimit në modelin tradicional është mësimi i prindërve. Sot, prindërit duhet të shihen si njerëz që kanë kapacitetin për të mësuar nga përvoja e përditshme në rolin e tyre prindëror. Prandaj, qëllimi përfundimtar i programit të prin-

dërimin në modelin bashkëkohor është “ndërtimi i kapaciteteve”, me synim forcimin e kapaciteteve të prindërve që synojnë aktivizimin e fuqive, mundësive dhe kompetencave prindërore për ndryshim. Nën ndikimin e konstruktivizmit, njohuritë prindërore konsiderohen si një ndërtim social, dhe programet e prindërimit si një proces bashkëpunues që inkurajon prindërit të reflektojnë dhe interpretojnë përvojën dhe të kërkojnë zgjidhje të mundshme (Ibid.). Supozohet se kapacitetet reflektuese prindërore përfaqësojnë një katalizator potencial për ndryshimet në marrëdhënien prind-fëmijë (Slade, 2006), më pas koncepti i prindërimit reflektues (anglisht: "reflective parenting") merret si pikënisje për qasjen më të re në kuptimin e kompetencave prindërore. Theksi vihet në një kuptim më të thellë të fëmijës përmes reflektimit mbi përvojat e mëparshme në situata të ndryshme. Në atë mënyrë, ndryshimet në sjelljen e prindërve ndodhin si rezultat i të menduarit të tyre jo vetëm për sjelljen e fëmijës, por edhe për ndjenjat e tyre, synimet, si dhe për përvojat e tyre (Ibid.).

3. Mbështetja kryesore e programit

Programi për mbështetje të mësimin dhe zhvillimit në shtëpi ofron qasje prindërore, koncept arsimor dhe strategji specifike me të cilat mbështetet zhvillimi i vlerave, njohurive, aftësive prindërore për ndërveprim pozitiv me fëmijët.

Për fëmijën, situata e të nxënit, mbi të gjitha, nënkupton ekzistencën dhe disponueshmërinë e një NXITJE interesante që e fton fëmijën të bëjë pyetje. Më pas, nënkupton edhe mundësi që fëmija të gjejë përgjigjen ndaj pyetjes së tij, duke ndjekur *kureshtjen* e tij të natyrshme, interesin e tij, duke e zbatuar atë që di, *duke hulumtuar në mënyrë aktive*, duke u përpjekur dhe manipuluar me atë që ai e konsideron si faktorë kyç të dukurisë që e ka zgjuar interesimin e tij. Fëmija *menaxhon në mënyrë aktive* me procesin e tij njohës. Ai e ndryshon realitetin dhe e përshtat atë me vetveten, në mënyrë që të jetë më e lehtë për të gjetur një "emër" për atë që përpriqet të kuptojë, për të krijuar rrethana në të cilat mund të shijojë të mësuarit dhe në të cilat të mësuarit çon në rezultate të besueshme. Nuk ka asnjë stimulim që në vetvete do të çojë në një kapërcim zhvillimi nëse nuk shoqërohet nga një i moshuar që di ta emërtojë, të ofrojë kuptim, ta drejtojë fëmijën përmes përvojës, të zgjerojë lojën, të zgjerojë kureshtjen dhe hulumtimin e fëmijës. Një fëmijë mëson më së miri në marrëdhëniet e karakterizuara nga besimi, siguria, ngrohtësia dhe respekti për këndvështrimin e fëmijës. Kjo lloj marrëdhënieje midis prindit dhe fëmijës ushqen vullnetin e fëmijës për të mësuar me dhe nga dikush.

Ky program nënkupton që *nxitjet për mësim dhe zhvillim* gjenden në rutinat, lojërat, leximin me fëmijën në shtëpi (mësimi për rutinat dhe mësimi përmes lojës) meqë janë të pasura me mundësi për zhvillim, por vetëm kur janë të bazuara në ndërveprim me prindin. Së këndejmi, praktika edukative duhet të bazohet në *pjesëmarrjen e fëmijës në jetën e familjes dhe të prindërve pa dënim*. Pjesëmarrja e fëmijës në jetën e familjes dhe kopshtit, kërkon që në kulturën e kopshtit dhe familjes po ashtu të ekzistojnë baza të vlerave.

Si koncept, përmban një grup masash që ndërmerren me një qëllim - promovimin e të mësuarit dhe zhvillimit në shtëpi, përmes krijimit të një mjedisi stimulues. Përveç atij fizik (hapësirë, kohë, lodra, materiale), mjedisi i tillë përmban edhe një komponent më pak të dukshëm, por më të rëndësishëm, përkatësisht marrëdhëniet cilësore në relacionin prind-fëmijë, sepse marrëdhëniet janë themeli i zhvillimit. Këto masa nënkuptojnë strategji të ndryshme për mbështetje të prindërve me të cilët *avancohen njohuritë dhe aftësitë e prindërve për rëndësinë e mjedisit nxitës në shtëpi, i jepet mbështetje mësimin dhe zhvillimit të fëmijës në shtëpi* (përmes mësimin për rutinat dhe mësimin përmes lojës) dhe ndërtohet një rrjet për mbështetje të *mirëqenies emocionale të prindërve në kontekstin e kujdesit për fëmijën me pengesa në zhvillim*. Çdo familje ka rutina, rituale, kohë të lirë, prandaj programi është i menduar si qasje e cila ka për qëllim të mbështes prindërit e fëmijëve me pengesa në zhvillim, në krijimin e mjedisit nxitës në shtëpi, për zhvillim të fëmijës në të gjitha fushat (kognitive, emocionale, sociale, motorike dhe të të folurit). Programi promovon universalitetin, orientimin dhe mbështetjen e përfshirjes së të **dy prindërve** në kujdes.

3.1. Kujt i dedikohet programi?

Programi është i drejtuar kah **prindërit** që nëpërmjet leximit të përbashkët, lojës me fëmijën, rutinave familjare, prindërit të mësojnë për zhvillimin e fëmijës, nevojat dhe kujdesin cilësor për fëmijën, të vënë në dyshim dhe të analizojnë përvojat e tyre në lidhje me kujdesin ndaj fëmijës, të mësojnë se si të krijojnë më mirë kushte më cilësore për zhvillim, të pranojnë fëmijën, të jenë të gatshëm dhe të aftë për të ndjekur nevojat dhe reagimet e fëmijës duke u mbështetur në iniciativën e fëmijës, t'i ofrojnë fëmijës mundësi për ndërveprim brenda të cilit fëmija do të mësojë

për veten dhe botën përmes lojës, leximit dhe bisedës dhe kohës së lirë, të krijojnë baza për marrëdhënie të sigurta, të ngrohta dhe përvoja pozitive për fëmijën.

Prindërit bëhen pjesëmarrës aktivë në jetën e kopshtit, duke intensifikuar dhe diversifikuar format edhe mënyrat e përfshirjes së prindërve në punën e kopshtit. Me këtë sigurohet pjesëmarrja më e madhe e prindërve dhe gjetja e përbashkët e strategjive të duhura për rritjen dhe edukimin e fëmijës brenda institucionit, si dhe brenda rrethit familjar. Kjo është thelbësore për prindërit me fëmijë në rrezik, të cilët, për arsye të ndryshme, nuk mund të krijojnë një mjedis inkurajues për zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijës.

Programi është i dedikuar edhe kah **komuniteti lokal** - organizata të ndryshme, institucione publike, ente, OJQ dhe shoqata, të cilat mund të integrojnë programin në shërbimet ekzistuese, të ofrojnë vullnetarë dhe të promovojnë mësimin dhe zhvillimin në shtëpi, ashtu që informatat për programin të mund të arrijnë deri te çdo prind.

4. Programi i punëtorive për prindërit

4.1. Qëllimi i programit është që prindërit ti përvetësojnë aftësitë prindërore për krijimin e një mjedisi stimulues për mësim dhe zhvillim të fëmijëve **në shtëpi** edhe atë në fushat vijuese: *koha e lirë, pjesëmarrja në rutina, lojë e përbashkët, biseda me fëmijët dhe leximi me fëmijët.*

Në punëtoritë prindërit do të kenë mundësi të:

- Rishqyrtojnë praktikat e tyre prindërore
- Këmbejnë përvoja me prindër
- Mësojnë nga njëri-tjetri
- Fitojnë përvojë praktike për lojën ndërvepruese, leximin me fëmijën
- Krijojnë lidhje në ndjesinë e përkatësisë dhe pranimit
- Komunikojnë hapur dhe të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në jetën e kopshtit
- Përfitojnë aftësi për krijimin e mjedisit stimulues në shtëpi
- Kuptojnë rëndësinë e „ndarjes“ së kujdesit dhe pjesëmarrjes së babait

Rezultatet e programit për prindërit janë si në vijim:

- Zhvillimi i refleksivitetit të prindërve përmes rishqyrtimit të vlerave të prindërimit personal dhe analizës së përvojës së tyre lidhur me kujdesin për fëmijën
- Përfitimi i njohurive për rëndësinë e zhvillimit të hershëm dhe mësimin të fëmijës gjatë zhvillimit të hershëm
- Përfitimi i aftësive për krijimin e kushteve më cilësore për fëmijët për zhvillim dhe mësim (pranimi i fëmijës dhe rolit të tyre si prind dhe pjesëmarrja e fëmijëve)
- Përfitimi i aftësi për lexim me fëmijën, mësim përmes lojës dhe në kuadër të rutinave familjare në shtëpi
- Informimi për programet në kopshte dhe burimet në komunitet

Nga prindërit pritet të:

- Ndjehen më efikas në rolin e tyre të prindit (zvogëlimi i stresit, mbështetje sociale, shëndeti mendor, përfshirja e baballarëve)
- Jenë më të përfshirë në aktivitetet zhvillimore-nxitëse me fëmijën, se sa para trajnimit të praktikuesve (lexim me fëmijën, pjesëmarrja në rutina)
- Përfshihen në mënyrë aktive në lojën me fëmijët
- Në mënyrë adekuate ti njohin dhe interpretojnë shenjat e fëmijës

4.2. Grupi i synuar

Ky program është i dedikuar për të gjithë **prindërit** (nëna, baballarë, kujdestarë, birësues) dhe **fëmijët** që nga mosha e hershme. Numri i prindërve në punëtori nuk duhet të tejkalojë 15, mënyra e realizimit është një herë në muaj në një kohë që do të jetë në marrëveshje së bashku me prindërit. Punëtoritë nuk duhet të zgjasin më shumë se 1.5 orë.

Trajnimin mund ta realizojnë bashkëpunëtorë profesionistë, si drejtues, të cilët e kanë kaluar trajnimin për trajner të Programit për Mbështetje të familjes për mësim dhe zhvillim të fëmijëve në shtëpi, të cilët kanë përvojë dhe aftësi për të udhëhequr punëtoritë dhe të cilët janë të motivuar për të mësuar dhe për të zhvilluar kompetencat për mbështetje prindërore. Thelbin e punëtorive për prindërit e përbën përqendrimi i drejtuesve dhe pjesëmarrësve në realizimin e qëllimit dhe përmbajtjes së punëtorisë, si dhe në ndërtimin e një atmosfere pozitive përmes respektit dhe përkatësisë. Pas trajnimit, trajnerët duhet të familjarizohen plotësisht me programin në 15 ditët e ardhshme dhe në përputhje me kontekstin e kopshtit, ti organizojnë grupet e prindërve. Përgatitja e çiftit të drejtuesve nënkupton njohuri dhe aftësi për nxitjen e zhvillimit në shtëpi, ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësi të përbashkët për rezultatet dhe për arritjen e qëllimit. Është mirë që drejtuesit të ndërrohen gjatë punëtorisë, sepse kjo do të kontribuojë në përmirësimin e dinamikës në punë.

Hapësira duhet të jetë e këndshme, mjaftueshëm e madhe.

4.3. Prindërit mund të ftohen në trajnim përmes komunikimit me gojë dhe me shkrim, afishe, fletushka, përmes grupeve në Viber, duke postuar thirrje në ueb faqen e kopshtit, përmes takimeve me prindër, duke përdorur burimet e informacionit në komunitetin lokal.

4.4. Struktura e trajnimit

5 takimet e para janë punëtori për prindërit me tema që lidhen me kushtet në shtëpi, të cilat mund të bëhen nxitje për mësim dhe zhvillim të fëmijës. Gjatë punëtorive, prindërit i rishqyrtojnë bindjet e tyre dhe praktikën e prindërimit.

Struktura e 5 takimeve të para nënkupton:

Pjesa hyrëse - njohje reciproke, hyrje në temën dhe qëllimin e punëtorisë, arritja e marrëveshjes së përbashkët për rregullat e punës (pushime, përdorimi i celularëve, adresimi, leja për të bërë fotografi, etj.), siç janë rregullat për respekt të ndërsjellë, dëgjim të të tjerëve, etj.

Pjesa qendrore:

- Prezantim i shkurtë profesional (kontribut me shkrim ose prezantim)
- Lojëra të roleve
- Aktivitete dhe ushtrime (shpesh me anë të fletëve të punës ose kontributit me shkrim)
- Shkëmbim përvojash, të menduarit, diskutim në nivel të grupit ose në grupe më të vogla (dyshe, treshe, katërshe)

Pjesa përmbyllëse nënkupton lojëra për relaksim ose aktivitet për përmbyllje të temës dhe dhënia e *detyrës së shtëpisë* me të cilën fillohet punëtorja e radhës.

Temat e 5 punëtorive të para janë:

1. *Zhvillim i hershëm në shtëpi*
2. *Fotografia e fëmijës sime*
3. *Si lozim në shtëpi?*
4. *Lexim me fëmijën në vend të leximit për fëmijën*
5. *Rutinat në familjen tonë*

Pjesa e dytë e trajnimit (5 takime) nënkupton **ndërveprim me fëmijën**, respektivisht puna prind - fëmijë në kuadër të temave vijuese:

1. *Rruga nga kopshti deri në shtëpi*
2. *Lojëra të përbashkëta me fëmijët*
3. *Lojëra të përbashkëta me fëmijët*
4. *Lexim me fëmijën*
5. *Rutina familjare*

Materialet e nevojshme: lodra, libra, komplete për lojëra simbolike, kube, letër, shkumësa me ngjyra, plastelinë...

Të gjithë pjesëmarrësve (fëmijë, prind) u ofrohet material për hartim të rrugës nga kopshti deri në shtëpi, nga një lojë/lodër, respektivisht libër, ose rutinë familjare, sipas moshës së tyre dhe u jepen udhëzime të lozin, të hartojnë një rrugë, respektivisht të lexojnë, ose për shembull, të varin rroba për t'u tharë, ashtu siç e BËJNË ZAKONISHT. Është e nevojshme që secili prej udhëheqësve të drejtohet gjatë ndërveprimit me fëmijën në lojë, lexim ose rutinë, në atë mënyrë që me dy drejtues krijohet mundësia ti qasemi çdo çifti të përbërë nga një fëmijë dhe një prind. Dyshja e trajnerëve afrohet, vëzhgon dhe mbështet aftësitë e perceptuara të prindit ("Ju lexoni së bashku me fëmijën, shikojeni se sa me kujdes i shikon fotografitë", "Ju jeni vërtetë i mirë në lojë, shikoni sa shumë kënaqet fëmija", "Ju i keni mundësuar fëmijës tuaj të jetë pjesëmarrës bashkë me ju teksa i varni rrobat për t'u tharë, fëmija ndihet i vlefshëm dhe i rëndësishëm"). Ndërhyrjet e këtilla nga drejtuesit, të shprehura me zë të lartë, u mundësojnë prindërve të tjerë të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të zotërojnë aftësi të reja për pranim dhe mësim, të bazuara në lojë dhe rutina.

Struktura e pesë takimeve tjera:

- Përshëndetje dhe njoftim me pjesëmarrësit (fëmijët dhe prindërit) dhe hyrje në temën: "Sot së bashku do të shohim se si duket rruga juaj nga shtëpia deri në kopsht, sot do të lozim/lexojmë ..."
- Shpërndarja e materialeve
- Drejtuesit u japin informata kthyesë për aftësitë prindërore në mënyrë pohuese edhe me këtë u udhëzojnë prindërit në përvetësimin dhe njohjen e aftësive për pranim dhe pjesëmarrje në lojërat dhe rutinat.

Në fund të punëtorisë së fundit, prindërve u jepet të plotësojnë një formular vlerësimi, si dhe një certifikatë.

Dhjetë takimet gjatë trajnimit të Programit kanë një kurs të menduar mirë në drejtim të arritjes së qëllimit të vendosur dhe nuk mund të realizohen në mënyrë individuale dhe as me një radhitje të ndryshme.

Këshillohet që raporti për trajnimin të përgatitet menjëherë pas realizimit të punëtorisë/takimit.

4.5. Vlerësimi

Në fund të ciklit prej pesë punëtorive, prindërve u jepet fleta e vlerësimit, i hartuar për nevojat e vlerësimit të efekteve të punëtorisë. Për çiftin drejtues hartohet fletë e veçantë për vlerësim. Të dy mënyrat për vlerësim do të jenë në formë të shkallës për vlerësim dhe do të përpuhohen në mënyrë sasiore, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të Programit në bazë të rezultateve të fituara.

4.6. Diseminimi i programit nënkupton krijimin e një bërthame të kopshteve, të cilët do të jenë modele për zgjerimin e programit në kopshtet tjera të cilët nuk janë përfshirë në trajnimin e parë. Punonjësit profesional nga kopshtet tjera përmes vizitave dhe shkëmbimeve horizontale do të kenë mundësi të realizojnë programin në kopshtet e tyre, duke e respektuar kontekstin dhe kulturën e kopshtit.

4.7. Rekomandim

- Programi për lexim Medo, Qendra për mbështetje të zhvillimit të hershëm dhe marrëdhënies familjare „Harmonia“ Novi Sad
- „Shtëpia është këndi im i parë i lojërave“, Qendra për mbështetje të zhvillimit të hershëm dhe marrëdhënies familjare „Harmonia“ Novi Sad

| | |
|-----------------------------------|---|
| Tema 1. | Zhvillimi i hershëm në shtëpi |
| Qëllimi | Kuptimi i rëndësisë së zhvillimit të hershëm dhe mundësive për mbështetje në shtëpi |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 1: „Njohuri shkencore për zhvillimin e fëmijës“ - për secilin grup të vogël • FP 2: „Çfarë është prindërimi pozitiv?“ - për secilin • pajisje për shkrim – për secilin grup të vogël • letër e madhe - 2 • markerë – 1 • letër ngjitëse – 1 • top i vogël – 1 |
| Aktiviteti hyrës (20 minuta) | <p>Trajneri dhe pjesëmarrësit qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri prezantohet dhe falënderon pjesëmarrësit për praninë e tyre. Më pas ai shpjegon shkurt programin dhe qëllimet e tij dhe si planifikohet të punohet (sa punëtori, kohëzgjatja e tyre, metodat e punës, çfarë dinamike të takimeve).</p> <p>Më pas bashkërisht vendosen rregullat që do të vlejné për të gjithë punëtoritë me qëllim të sigurimit të punës së suksesshme dhe të ndjenjës së mirë tek të gjithë pjesëmarrësit (arritja në kohë, pjesëmarrja aktive në aktivitete, shprehja e lirë e mendimit, respektimi i mendimit të tjerëve, përdorimi i telefonave celularë, fotografimi, etj...) dhe të njëjtat shkruhen shkurtimisht në një letër të madhe e cila ngjitet në një vend të dukshëm në dhomë.</p> <p>Pastaj të gjithë qëndrojnë në rreth . Në shenjën e dhënë, njëri e fillon duke ia kaluar një top të vogël tjetrit në radhë duke thënë njëkohësisht emrin e tij e kështu me radhë derisa topi të kthehet tek ai që ka nisur aktivitetin pa rënë në tokë. Gjatë kësaj kohe, trajneri mat kohën. Aktiviteti përsëritet disa herë në përpjekje për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm për të gjithë grupin.</p> |
| Aktiviteti kryesor (45 minuta) | <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri parashtron pyetje, ndërsa përgjigjet nga grupi i shënon në letër të madhe: „ Imagjinoni që jeni shpërngulur në një vend tjetër dhe duhet të mësoni gjuhën që flitet atje. Si të rritur, çfarë vështirësish do të kishit në mësim dhe për cilat arsye?“</p> <p>Pastaj pyet: „Nëse një fëmijë do të ishte shpërngulur në atë vend në moshë të vogël, a do të kishte të njëjtat vështirësi? Pse?“</p> <p>Trajnuesi bën përmbledhje duke theksuar se periudha e hershme e zhvillimit i ka mundësitë më të mëdha dhe atëherë fëmija ka entuziazmin dhe motivimin më të madh për të mësuar.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla dhe secili pranon një FP 1 dhe duhet t'i përgjigjet së bashku. Pastaj një nga një grupet lexojnë nga një pyetje dhe e thotë përgjigjen e cila sipas nevojës diskutohet me qëllim që të arrihet tek përgjigja e saktë.</p> <p>Secili pranon një FP 2, e më pas trajneri e sqaron atë.</p> |
| <p>Diskutim (15 minuta)</p> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa e rëndësishme është periudha e hershme e zhvillimit të fëmijës? 2. Çfarë është e rëndësishme që prindërit të bëjnë atëherë? Pse? 3. Kur prindërit duhet ta bëjnë këtë – në disa raste dhe ditë të veçanta ose gjatë gjithë ditës për çdo ditë? |
| <p>Aktiviteti përmbyllës (10 minuta)</p> | <p>Të gjithë qëndrojnë në një rreth. Secili nga ana e tij tregon një ngjarje të rëndësishme kur fëmija i tij ka mësuar, ka përvetësuar diçka dhe se si është ndier ai si prind në atë çast. Të tjerët më pas përshëndesin përparimin e fëmijës së tij duke e drejtuar njëkohësisht dorën e majtë në grusht para vetes, pastaj në mënyrë paralele me të dorën e djathtë në grusht e pastaj grushtet i godasin një herë njëra për tjetrën.</p> |

| | |
|---|--|
| Tema 2. | Fotografia e fëmijës sime |
| Qëllimi | Rishqyrtimi i bindjeve personale për fëmijën |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 3: „Bingo“ - për secilin • FP 4: „Fotografia e fëmijës tim“ - për secilin • FP 5: „Përshkrim i fëmijës sime“ - për secilin • pajisje për shkrim - për secilin • bojëra - për secilin |
| <p>Aktiviteti hyrës (20 minuta)</p> | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e shpalos temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Pastaj të gjithë pranojnë FP 3 dhe e plotësojnë atë në mënyrë të pavarur. Kur të gjithë të kenë përfunduar, ata ngrihen dhe në një shenjë të caktuar kërkojnë shpejt dikë me një përgjigje të ndryshme nga përgjigja e tyre në fushën e caktuar, ndërsa personi tjetër nënshkruhet në atë fushë. I njëjti pjesëmarrës mund të nënshkruajë fletën e dikujt tjetër vetëm dy herë. Pasi të mblidhet një nënshkrim, kërkohet shpejt nënshkrimi tjetër për një fushë tjetër. Sa herë që dikush mbledh nënshkrime me radhë (horizontale, vertikale ose diagonale), bërtet me zë të lartë "Bingo!"</p> |

| | |
|--------------------------------------|--|
| | <p>Pas dhjetë minutash, loja ndërpritet dhe zhvillohet një diskutim i shkurtër:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kush i ka të gjithë 16 bingot (15, 14... dhe me radhë teposhtë)? 2. Për çfarë e kishit më të lehtë të gjeni dikë për nënshkrim? E për çfarë e kishit më të vështirë? |
| Aktiviteti kryesor (40 minuta) | <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Të gjithë pranojnë FP 4 dhe në mënyrë të pavarur e vizatojnë fëmijën e tyre, më pas nën fotografi shkruajnë një porosi të shkurtër nxitëse ose motivuese drejtuar fëmijës në ligjëratë të drejtë, e me të cilin duan të mbështesin udhëtimin e tyre nëpër jetë. Pastaj një nga një e prezanton vizatimin para të tjerëve duke thënë: "Ky është ... (emri i fëmijës)" dhe e lexon porosinë.</p> <p>Më pas të gjithë pranojnë një FP 5 dhe e plotësojnë në mënyrë të pavarur duke shkruar në fushën përkatëse atë që fëmija i tyre nuk e pëlqen/nuk i pëlqen të shohë, dëgjojë, flasë/thotë, të bëjë, por edhe atë që e bën të trishtuar, të frikësuar dhe të lumtur. Më pas, në dyshe, e ndajnë atë që është shkruar fillimisht për njërin pjesë dhe më pas kalojnë në pjesën tjetër.</p> |
| Diskutim (10 minuta) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë mendoni, si fotografia e fëmijës përcakton pritjet tuaja nga ai? 2. Si e përcaktojnë ato pritje sjelljen tuaj ndaj tij? |
| Aktiviteti përmbyllës (15 minuta) | <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth, por pranë atij me të cilin kanë punuar më parë si çift. Një nga një në çift i drejtojnë njëri-tjetrit një porosi të shkurtër pozitive lidhur me atë që kanë vënë re tek tjetri personalisht deri më tani ose lidhur me atë se çfarë është shkruar dhe ndarë gjatë punës në FP 5. Të tjerët dëgjojnë me vëmendje dhe duartrokin pas çdo porosie.</p> |
| Detyrë shtëpie (5 minuta) | <p>Prindërve u jepet detyrë shtëpie të vëzhgojnë fëmijën e tyre në shtëpi dhe të gjejnë ndonjë aftësi, shkathtësi ose njohuri që ai/ajo ka dhe që nuk e kanë vënë re deri më tani; të mendojnë se si ka ndryshuar qëndrimi i tyre ndaj fëmijës, dhe në atë mënyrë ta mbështesin atë.</p> |

| | |
|------------------------|---|
| Tema 3. | Si lozim në shtëpi? |
| Qëllimi | Njohja e rëndësisë së lojës si mundësi për mësim |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 6: "Të mësuarit e fëmijës përmes lojës" - për secilin grup të vogël • pajisje për shkrim - për secilin grup të vogël • video regjistrimi nr. 1 • laptop dhe projektor – 1 |

| | |
|--|--|
| <p>Aktiviteti hyrës (15 minuta)</p> | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e shpalos temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth . Trajneri fillon një bisedë për shkëmbim të përvojave me të gjithë grupin në lidhje me detyrat e shtëpisë nga punëtorja e mëparshme.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth. Çdokush me radhë tregon një lojë të preferuar nga fëmijëria e tij duke shpjeguar pse e ka pasur lojë të preferuar dhe cili nga të moshuarit dhe fëmijët e tjerë kanë lozur me atë lojë.</p> <p>Kur të përfundojnë të gjithë, trajneri thotë se sot lojërat e fëmijëve janë mjaft të vetmuara, ata rrallë lozin me bashkëmohatarët, ndaj është e rëndësishme që prindërit të krijojnë një mjedis loje që përveç hapësirës, kohës dhe lodrave, e nënkupton edhe prindin i cili e di si të mbështet lojën.</p> |
| <p>Aktiviteti kryesor (40 minuta)</p> | <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth . Trajneri prezanton video regjistrimin nr. 1 nga një lojë fëmijërore, pastaj thekson gjithçka që fëmija ka mundur të zhvillojë gjatë lojës (kuriozitet, pavarësi, aftësi motorike, koordinim, iniciativë, të kënaqet, të lumturohet, të emërtojë...).</p> <p>Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla, kështu që secili pranon një FP 6 dhe e zgjidh atë së bashkërisht. Pasi të kenë përfunduar të gjitha grupet, çdokush në rreth me radhë, lexon dhe i përgjigjet njëres pyetje. Sipas nevojës, zhvillohet diskutim për të arritur deri te përgjigja e saktë.</p> |
| <p>Diskutim (15 minuta)</p> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë do të thotë loja për fëmijën? 2. Kur ajo në të vërtetë mund të nxit zhvillimin e fëmijës? 3. Çfarë duhet të bëjë prindi gjatë lojës së përbashkët me fëmijën për të nxitur zhvillimin e tij? 4. Kur gjatë ditës prindi mund të loz me fëmijën e tij? <p>Shënim për trajnerin: Përmes lojës, fëmija mëson dhe zhvillohet, por vetëm kur në të përfshihet në mënyrë aktive prindi i cili krijon një mjedis stimulues dhe kur vetë di ta bëjë lojën e fëmijës interesante, ta vazhdojë dhe të ofrojë sfida. Prindi ka mundësi të panumërta gjatë ditës për lojëra të shkurtra e më të gjata me fëmijën e tij, duke i njohur sfidat e lojës në jetën e përditshme apo duke i krijuar ato.</p> |
| <p>Aktiviteti përmbyllës (10 minuta)</p> | <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth. Trajneri i tregon situatat në nga një, ndërsa pas secilës pjesëmarrësit duhet të lëvizin nëpër hapësirë dhe të bëjnë gjeste sikur të ishin ai person.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Situatat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Futbollisti shënon gol • Drejtori nervoz • Fëmija i hareshëm • Vozitës i ngecur në bllokim komunikacioni • Studenti e ka kaluar provimin • Person i cili përpiqet të kap autobusin • Prindi e shikon fëmijën e tij si bën diçka me sukses • Prind i suksesshëm |
|--|--|

| | |
|-----------------------------------|--|
| Tema 4. | Lexim me fëmijën në vend të leximit fëmijës |
| Qëllimi | Njohja e rëndësisë së leximit me fëmijën |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 7: „Leximi me fëmijën“ - për secilin grup të vogël • FP 8: „Tregimi për princeshën, princin dhe Olafin“ - 1 • pajisje për shkrim - për secilin grup të vogël • libra – për secilin çift |
| Aktiviteti hyrës (15 minuta) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth dhe ndahen në çifte. Çdo çift pranon një libër. Njëri prej çifteve është në rolin e prindit, dhe tjetri në rolin e një fëmije, kështu që në sinjalin e dhënë, në kohëzgjatje prej 3 minutash, "prindi" ia lexon librin "fëmijës". Kur mbaron koha, secili çift numëron së bashku sa fjalë janë lexuar, dhe pastaj përmbledhen përgjigjet me të gjithë.</p> |
| Aktiviteti kryesor (30 minuta) | <p>Trajneri flet shkurt lidhur me rëndësinë e leximit për zhvillimin e fëmijës.</p> <p>Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla, pastaj çdokush pranon një FP 7 dhe e plotëson atë së bashku. Kur të gjithë të kenë përfunduar, secili grup në rreth me radhë lexon dhe jep përgjigje për një pyetjeje. Të tjerët dëgjojnë me kujdes dhe shtojnë vetëm nëse kanë diçka të re. Sipas nevojës, zhvillohet një diskutim lidhur me atë pse disa aspekte janë të rëndësishme.</p> |
| Diskutim (15 minuta) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Si duket situata gjatë leximit të një libri kur fëmija është dëgjues pasiv dhe si është kur ai është dëgjues aktiv? Çfarë bën prindi e çfarë bën fëmija gjatë kësaj? 2. Cila situatë e zhvillon fëmijën? Cilat porosi i pranon fëmija atëherë? Si ndjehet gjatë kësaj? |

| | |
|--------------------------------------|---|
| Aktiviteti përmbyllës (15 minuta) | Të gjithë qëndrojnë në rreth. Trajneri e lexon tregimin nga FP 8, ndërsa të tjerët duhet të bëjnë një lëvizje të caktuar, gjithmonë kur në të do të përmendet një fjalë e caktuar, edhe atë: <ul style="list-style-type: none"> • princeshë - përkulje • princ - përshëndetje • Olaf - përqaftim |
|--------------------------------------|---|

| | |
|---------------------------------|--|
| Tema 5. | Rutinat në familjen tonë |
| Qëllimi | Njohja e rutinave si mundësi për mësim dhe zhvillim të fëmijës |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 9: „Mësimi i fëmijës përmes pjesëmarrjes në rutinat dhe ritualet familjare“ - për secilin • pajisje për shkrim – për secilin grup të vogël • video regjistrimi nr. 2 • laptop dhe projektor - 1 |
| Aktiviteti hyrës (15 minuta) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e thekson temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë ndahen në treshe dhe qëndrojnë në një hapësirë të zbrazur, të gjerë. Fillimisht sqarohen dy elementet themelore të aktivitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • „shtëpi“ - dy persona nga treshi qëndrojnë duke u kapur për dore me duart ngritur lartë mbi kokë; • „banor“ - njëri nga treshi qëndron midis të dyve të cilët e përbëjnë „shtëpinë“. <p>Pastaj të gjithë treshet e bëjnë figurën e „shtëpisë“ me „banor“ në të. Njëri i cili fillimisht nuk i takon asnjërës treshe, qëndron në mjedis dhe qartë e jep njërin nga udhëzimet në vijim, të cilën të tjerët duhet shpejtë ta përmbushin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • „Shtëpitë i ndërrojnë banorët!“ - dy personat nga çdo treshe të cilët e përbëjnë „shtëpinë“ duke u mbajtur akoma për dore, e braktisin „banorin“ që e kanë dhe shpejt kërkojnë „banor“ të ri; gjatë asaj kohe të gjithë ata që janë „banorë“ qëndrojnë në vend. • „Banorët i ndërrojnë shtëpitë!“ - të gjithë „banorët“ dalin nga „shtëpitë“ e tyre dhe shpejt kërkojnë „shtëpi“ të re; „shtëpitë“ gjatë këtij udhëzimi qëndrojnë në vend. • „Tërmet!“ - të gjithë treshet ekzistuese ndahen dhe formohen treshe plotësisht të reja në të cilët dy janë „shtëpi“, ndërsa njëri është „banor“ në atë „shtëpi“. |

| | |
|--|--|
| | <p>Ai që jep udhëzime menjëherë pasi ta ketë dhënë, nxiton të hyjë vetë në ndonjë treshe (si "banor" ose si pjesë e një "shtëpie", në varësi të udhëzimit të dhënë). Ai që nuk do të jetë në asnjë treshe, e ka radhën për të dhënë udhëzime</p> |
| <p>Aktiviteti kryesor (40 minuta)</p> | <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth . Trajneri e prezanton video regjistrimin nr. 2 si shembull kur rutina është një mundësi për mësim dhe zhvillim të fëmijës. Gjatë videos ai i shpjegon aftësitë të cilat i ka prindi (ndjek sinjalet e fëmijës, vëzhgon ndryshimet, interpreton, u përgjigjet sinjaleve).</p> <p>Pastaj të gjithë pranojnë një FP 9, më pas trajneri e prezanton përmbajtjen e vizatimit.</p> <p>Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla, pastaj gjysma e tyre e plotësojnë pjesën e dytë të FP për njërin opsion (larje/banjë), dhe gjysma tjetër - për tjetrën (shitblerje). Kur të gjithë të kenë përfunduar, një nga një grupet që kanë punuar në të njëjtin opsion, në një rreth lexojnë nga një prej asaj që është shkruar derisa të shterohen të gjitha përgjigjet. Të tjerët dëgjojnë me kujdes që të mos ketë përsëritje.</p> <p>Disa përgjigje të mundshme të pranueshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • larje/banjë: të derdhë, rrëmon, spërkatë, prekë ujin, prekë sapunin dhe shkumën, emërton gjëra, percepton rendin e aktiviteteve, mëson nxehtë-ftohtë, thatë-lagësht, mëson të presë, të jetë përgjegjës... • shitblerje/pazar: si planifikohet shitblerja, të vizatojë listë ushqimesh, të mësojë të mbajë çantë, të mësojë aftësi komunikimi (përshëndetje, pyetje, përgjigje...), si maten produktet, si të arrihet në mënyrë të sigurt në një vend të caktuar... |
| <p>Diskutim (15 minuta)</p> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë mëson fëmija përmes përfshirjes së tij në rutinat dhe ritualet familjare? 2. Cilat porosi i pranon fëmija atëherë? Si ndjehet gjatë kësaj? 3. Si e siguron prindi pjesëmarrjen e fëmijës në rutinat dhe ritualet familjare? Çfarë fiton vetë ai nga kjo? |
| <p>Aktiviteti përmbyllës (15 minuta)</p> | <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth. Çdokush me radhë përmes pantomimës tregon një aktivitet në shtëpi dhe e emërton atë si diçka krejtësisht të ndryshme (p.sh.: tregon varjen e rrobave në litar dhe thotë "Përgatis drekën"). Tjetri e tregon atë që e ka paraqitur personi paraprak, ndërsa e emërton atë si një aktivitet tjetër.</p> |

5. Fletë pune

Fletë pune (FP) 1: Njohuri shkencore për zhvillimin e fëmijës

| | |
|--|------------|
| <p>10.Zhvillimi i trurit është kumulativ. Zhvillimi i disa kapaciteteve është baza për zhvillimin e mëvonshëm të kapaciteteve të tjera.</p> | <p>S P</p> |
| <p>11.Në periudhën e hershme fëmija ka mundësitë më të mëdha për zhvillim. Kur një fëmije i sigurohet zhvillim dhe mësim cilësor më herët, sigurohen rezultate më të qëndrueshme.</p> | <p>S P</p> |
| <p>12.Mjedisi nuk ndikon në zhvillimin e trurit. Truri i fëmijës nuk zhvillohet në varësi të faktit nëse ka një përvojë pozitive, negative apo mungesë të përvojës fizike/mendore me objekte, vende dhe veçanërisht me njerëz nga mjedisi i tij.</p> | <p>S P</p> |
| <p>13.Fëmija lind me nevojën për lidhje shoqërore me njerëzit e tjerë. Kultura ndikon më tej se si do të zhvillohet kjo lidhje – cilat rregulla, mënyra dhe natyra e ndërveprimit shoqëror do të ushqehen.</p> | <p>S P</p> |
| <p>14. Prindërit janë mësuesit më të rëndësishëm të fëmijës. Zhvillimi dhe mësimi i një fëmije ndikohet nga shumë njerëz (të afërm, fqinjë, miq, edukatorë), por më së shumti nga prindërit (nëna dhe babai), ndërveprimi i të cilëve me të është që në moshë të hershme dhe ofron më shumë mundësi për ndikim, ndërsa përvoja prej saj më pas ndikon në ndërveprimet e fëmijës me të tjerët në mjedis.</p> | <p>S P</p> |
| <p>15.Fëmija zhvillohet më mirë kur mjedisi ka krijuar marrëdhënie të forta afektive me të (kujdes, dashuri, siguri, mbështetje). Fëmija është më i gatshëm të zbulojë dhe vërë në dyshim karakteristikat e ndryshme të mjedisit dhe të zhvillohet përmes atij procesi kur mjedisi ka krijuar me të marrëdhënie të ngrohta, edukative, të përgjegjshme, të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe karakteristikat e fëmijës.</p> | <p>S P</p> |
| <p>16.Një fëmijë nuk lind kureshtar. Fëmija nuk dëshiron të mësojë dhe e di që në lindje.</p> | <p>S P</p> |
| <p>17. Fëmija lind me kompetenca. Fëmija nuk zhvillon kompetenca në varësi të cilësisë së lartë që i kërkon mjedisi dhe nëse ai e mbështet zhvillimin e tyre duke e trajtuar fëmijën si plot me potencial për zhvillim.</p> | <p>S P</p> |
| <p>18. Kur ka harmoni në veprimtaritë edukative në familje dhe kopsht, përfitimet për fëmijën janë më të mëdha. Ndërtimi i bashkëpunimit dhe partneritetit cilësor mes familjes dhe kopshtit mundëson bashkërendimin e veprimeve të tyre, duke nxitur zhvillimin e hershëm të çdo fëmije dhe përparim më të suksesshëm.</p> | <p>S P</p> |

FP 1: Njohuri shkencore për zhvillimin e fëmijës - përgjigje

| | |
|--|------------|
| <p>8. Zhvillimi i trurit është kumulativ.</p> <p>Zhvillimi i disa kapaciteteve është baza për zhvillimin e mëvonshëm të kapaciteteve të tjera.</p> | <p>S P</p> |
| <p>9. Në periudhën e hershme fëmija ka mundësitë më të mëdha për zhvillim.</p> <p>Kur një fëmije i sigurohet zhvillim dhe mësim cilësor më herët, sigurohen rezultate më të qëndrueshme.</p> | <p>S P</p> |
| <p>10. Mjedisi nuk ndikon në zhvillimin e trurit.</p> <p>Truri i fëmijës nuk zhvillohet në varësi të faktit nëse ka një përvojë pozitive, negative apo mungesë të përvojës fizike/mendore me objekte, vende dhe veçanërisht me njerëz nga mjedisi i tij.</p> | <p>S P</p> |
| <p>11. Fëmija lind me nevojën për lidhje shoqërore me njerëzit e tjerë.</p> <p>Kultura ndikon më tej se si do të zhvillohet kjo lidhje – cilat rregulla, mënyra dhe natyra e ndërveprimit shoqëror do të ushqehen.</p> | <p>S P</p> |
| <p>12. Prindërit janë mësuesit më të rëndësishëm të fëmijës.</p> <p>Zhvillimi dhe mësimi i një fëmije ndikohet nga shumë njerëz (të afërm, fqinjë, miq, edukatorë), por më së shumti nga prindërit (nëna dhe babai), ndërveprimi i të cilëve me të është që në moshë të hershme dhe ofron më shumë mundësi për ndikim, ndërsa përvoja prej saj më pas ndikon në ndërveprimet e fëmijës me të tjerët në mjedis.</p> | <p>S P</p> |
| <p>13. Fëmija zhvillohet më mirë kur mjedisi ka krijuar marrëdhënie të forta afektive me të (kujdes, dashuri, siguri, mbështetje).</p> <p>Fëmija është më i gatshëm të zbulojë dhe vërë në dyshim karakteristikat e ndryshme të mjedisit dhe të zhvillohet përmes atij procesi kur mjedisi ka krijuar me të marrëdhënie të ngrohta, edukative, të përgjegjshme, të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe karakteristikat e fëmijës.</p> | <p>S P</p> |
| <p>14. Një fëmijë nuk lind kureshtar.</p> <p>Fëmija nuk dëshiron të mësojë dhe e di që në lindje.</p> | <p>S P</p> |
| <p>8.Fëmija lind me kompetenca.</p> <p>Fëmija nuk zhvillon kompetenca në varësi të cilësisë së lartë që i kërkon mjedisi dhe nëse ai e mbështet zhvillimin e tyre duke e trajtuar fëmijën si plot me potencial për zhvillim.</p> | <p>S P</p> |
| <p>9.Kur ka harmoni në veprimtaritë edukative në familje dhe kopsht, përfitimet për fëmijën janë më të mëdha.</p> <p>Ndërtimi i bashkëpunimit dhe partneritetit cilësor mes familjes dhe kopshtit mundëson bashkërendimin e veprimeve të tyre, duke nxitur zhvillimin e hershëm të çdo fëmije dhe përparim më të suksesshëm.</p> | <p>S P</p> |

FP 2: Çfarë është prindërimi pozitiv?

Prindërimi pozitiv është:

a) kujdesi prindëror që fëmija të jetë i shëndetshëm, i sigurt, i ushqyer siç duhet

b) prindi të **monitorojë** fëmijën dhe t'u **përgjigjet** nevojave dhe interesave të tij

| 1-5 | FAZAT |
|-----|--|
| 1 | Prindi lidhet me fëmijën (është i gatshëm të investojë emocionalisht tek ai). |
| 2 | Fëmija ka nevoja (për të ushqyerit, sigurinë, përfshirjen sociale, stimulimin konjitiv, rregullimin dhe kanalizimin e emocioneve). |
| 3 | Fëmija jep sinjale (buzëqeshje, lëvizje, zëra, gjeste, kërkesa verbale). |
| 4 | Prindi monitoron sinjalet që jep fëmija, i interpreton ato dhe reagon në përputhje me rrethanat. |
| 5 | Fëmija mëson dhe zhvillohet. |

Kur prindi e ndjek fëmijën dhe i përgjigjet nevojave dhe interesave të tij, atëherë fëmija ndjen siguri emocionale, ngrohtësi, besim, shëndet fizik dhe mendor, në vend të stresit dhe ankthit.

c) prindi duhet ta **mbështesë** fëmijën për të eksploruar dhe komunikuar me rrethin


| 1-5 | FAZA |
|-----|---|
| 1 | Prindi beson se fëmija mund të zhvillojë shkathtësi të ndryshme. |
| 2 | Prindi krijon mundësi për fëmijën, që në moshë më të hershme, të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në bazë të kapaciteteve zhvillimore, përvojës dhe interesave të tij. |
| 3 | Fëmija merr pjesë në aktivitete të ndryshme. |
| 4 | Prindi monitoron pjesëmarrjen e fëmijës në aktivitete, e nxit dhe nuk i nënvlerëson aftësitë e tij, duke i parë ato nga këndvështrimi i tij. |
| 5 | Fëmija zhvillon aftësitë e tij, ndërsa ato i mundësojnë pjesëmarrje më cilësore në të ardhmen. |

Kur fëmija merr pjesë në aktivitete të ndryshme, ai ndjen se mendimi i tij është i rëndësishëm, zhvillon respekt të ndërsjellë, sheh se pjesëmarrja e tij mund të çojë në ndryshime, kontribuon në diçka që prindërit e konsiderojnë të rëndësishme, zhvillon respekt për veten, arsyetim, të menduarit, planifikim, parashikim, aftësinë për të shprehur, kuptuar të tjerët, realizon ndërvarësinë, ndërton përgjegjësi, mëson të zgjidhë probleme...


FP 3: Bingo

| | | | |
|--|--|--|--|
| ju pëlqen të zgjoheni herët (po ose jo) _____ | keni vëlla/motër (po ose jo) _____ | festa më e rëndësishme në familje _____ | rrjeti social që përdorni më së shumti _____ |
| ushqimi që hani më shpesh _____ | ndiqni politikën (po ose jo) _____ | pini kafe me fqinjët (po ose jo) _____ | shenja në horoskop _____ |
| detyra e shtëpisë që e urreni më së shumti _____ | jetoni në shtëpi apo banesë _____ | aktiviteti i preferuar në kohë të lirë _____ | lloji i preferuar i muzikës _____ |
| ajo që ju mërzit më shumë tek njerëzit _____ | shtetin që dëshironi të vizitoni _____ | paratë nga “java e lotarisë” do ti shpenzonit për _____ | më shumë gëzoheni kur _____ |

FP 4: Fotografia e fëmijës tim



FP 5: Përshkrimi i fëmijës sime



FP 6: Mësimi i fëmijës përmes lojës

1. Fëmija vëren diçka interesante në mjedis dhe:

- a) kthen kokën anash dhe bën sikur nuk ekziston.
- b) shikon stimulën dhe i lëndon shumë pyetje për shkak të zgjimit të kureshtjes natyrore.

2. Pas një kohe të shkurtër, fëmija:

- a) dëshiron të hulumtojë në mënyrë aktive për të gjetur përgjigje për pyetjet.
- b) thotë me vete: "Nuk më intereson, çfarë të dojë, le të jetë!"

3. Prindi vëren interesin e shprehur për fëmijën dhe:

- a) me gëzim, besim, ngrohtësi dhe respekt për këndvështrimin e tij, ai e drejton atë në atë përvojë, sepse ai e kupton se është një mundësi e mirë që fëmija të mësojë diçka.
- b) acarohet dhe i thotë: "Aman, ty të intereson çdo gjë e gjallë, nuk kam fare rehati". E gjete pikërisht tani, kur kam gjëra më të mira për të bërë!"

4. Mandej prindi:

- a) hap kompjuterin dhe i paraqet fëmijës gjithçka që lidhet me atë që e ka interesuar në terma mjaft profesionale ose i thotë: "Kur të rritesh, atëherë do të të them!"
- b) fillon një lojë me fëmijën sepse e di që është mënyra më e natyrshme e të mësuarit për të.

5. Lojën e fillon:

- a) gjithmonë prindi.
- b) mund ta fillojë dhe fëmija duke thirrur prindin me sinjale të ndryshme (i afrohet, i merr/i jep një lodër ose një send, tregon me gisht, emërton...).

6. Nëse prindi e filloi lojën, atëherë fëmija:

- a) pohon vullnetarisht nëse dëshiron të marrë pjesë.
- b) patjetër të marrë pjesë.

7. Kur fëmija luan vetë, atëherë prindi:

- a) kurrë nuk duhet të ndërhyjë në lojë.
- b) mund t'i bashkohet lojës për ta zgjatur dhe vazhduar atë duke shtuar lodra ose materiale, duke siguruar hapësirë, duke ftuar të tjerët të bashkohen.

8. Gjatë lojës, prindi:

- a) ka fjalën kryesore; vetëm ai flet dhe përcakton se çfarë dhe si të vazhdojë loja, ndërsa fëmija vetëm dëgjon.
- b) e drejton në mënyrë diskrete; nxit kureshtjen, kreativitetin dhe dëshirën e fëmijës për të luajtur, e ndihmon atë të organizojë përvojën e tij nëpërmjet monitorimit dhe vëzhgimit të kujdesshëm të lojës, e interpreton atë, e thëllon dhe e orienton të fitojë kompetenca të reja.

9. Derisa zgjat loja, fëmija:

- a) mund të ndryshojë – të jep, të merr.
- b) nuk guxon të ndryshojë asgjë.

10.Loja e prindit dhe e fëmijës mund të zhvillohet:

- a) në çdo kohë dhe hapësirë.
- b) në një kohë dhe hapësirë të përcaktuar më parë.

11.Loja luhet:

- a) vetëm me lodra të shtrenjta dhe libra me figura.
- b) me çdo gjë (fruta, perime, pjata, kuti, gurë, rërë, degë, gjethe, fjalë, fotografi, libra, gazeta, karrige...).

12.Loja duhet të jetë e tillë që fëmija:

- a) të kënaqet, gëzohet, argëtohet, të eksplorojë.
- b) mërzitet, shikon orën dhe mezi pret të mbarojë.

FP 6: Mësimi i fëmijës përmes lojës – përgjigje

1. Fëmija vëren diçka interesante në mjedis dhe:

- a) kthen kokën anash dhe bën sikur nuk ekziston.
- b) shikon stimulin dhe i linden shumë pyetje për shkak të zgjimit të kureshtjes natyrore.**

2. Pas një kohe të shkurtër, fëmija:

- a) dëshiron të hulumtojë në mënyrë aktive për të gjetur përgjigje për pyetjet.
- b) thotë me vete: "Nuk më intereson, çfarë të dojë, le të jetë!"

3. Prindi vëren interesin e shprehur për fëmijën dhe:

- a) me gëzim, besim, ngrohtësi dhe respekt për këndvështrimin e tij, ai e drejton atë në atë përvojë, sepse ai e kupton se është një mundësi e mirë që fëmija të mësojë diçka.
- b) acarohet dhe i thotë: "Aman, ty të intereson çdo gjë e gjallë, nuk kam fare rehati". E gjete pikërisht tani, kur kam gjëra më të mira për të bërë!"

4. Mandej prindi:

- a) hap kompjuterin dhe i paraqet fëmijës gjithçka që lidhet me atë që e ka interesuar në terma mjaft profesionale ose i thotë: "Kur të rritesh, atëherë do të të them!"
- b) fillon një lojë me fëmijën sepse e di që është mënyra më e natyrshme e të mësuarit për të.**

5. Lojën e fillon:

- a) gjithmonë prindi.
- b) mund ta fillojë dhe fëmija duke thirrur prindin me sinjale të ndryshme (i afrohet, i merr/i jep një lodër ose një send, tregon me gisht, emërton...).**

6. Nëse prindi e filloi lojën, atëherë fëmija:

- a) pohon vullnetarisht nëse dëshiron të marrë pjesë.
- b) patjetër të marrë pjesë.

7. Kur fëmija luan vetë, atëherë prindi:

- a) kurrë nuk duhet të ndërhyjë në lojë.
- b) mund t'i bashkohet lojës për ta zgjatur dhe vazhduar atë duke shtuar lodra ose materiale, duke siguruar hapësirë, duke ftuar të tjerët të bashkohen.**

8. Gjatë lojës, prindi:

- a) ka fjalën kryesore; vetëm ai flet dhe përcakton se çfarë dhe si të vazhdojë loja, ndërsa fëmija vetëm dëgjon.
- b) e drejton në mënyrë diskrete; nxit kureshtjen, kreativitetin dhe dëshirën e fëmijës për të luajtur, e ndihmon atë të organizojë përvojën e tij nëpërmjet monitorimit dhe vëzhgimit të kujdesshëm të lojës, e interpreton atë, e thellon dhe e orienton të fitojë kompetenca të reja.**

9. Derisa zgjat loja, fëmija:

- a) mund të ndryshojë – të jep, të merr.
- b) nuk guxon të ndryshojë asgjë.

10. Loja e prindit dhe e fëmijës mund të zhvillohet:

a) në çdo kohë dhe hapësirë.

b) në një kohë dhe hapësirë të përcaktuar më parë.

11. Loja luhet:

a) vetëm me lodra të shtrenjta dhe libra me figura.

b) me çdo gjë (fruta, perime, pjata, kuti, gurë, rërë, degë, gjethe, fjalë, fotografi, libra, gazeta, karrige...).

12. Loja duhet të jetë e tillë që fëmija:

a) të kënaqet, gëzohet, argëtohet, të eksplorojë.

b) mërzitet, shikon orën dhe mezi pret të mbarojë.

FP 7: Leximi me fëmijën

Imagjinoni një situatë ku një prind dhe një fëmijë "lexojnë" një libër së bashku! Ti je ai fëmijë!

Përgjigjuni pyetjeve më poshtë se si do të dëshironit të shkonte ajo në mënyrë që të ndiheni rehat, të argëtoheni dhe të zhvilloni kompetencat tuaja!

1. Si duhet të duket dhoma në të cilën do të "lexoni" së bashku?

2. Si do të dëshironit të uleshit me prindin?

3. Kush duhet ta mbajë librin?

4. Çfarë do të dëshironit të mund të bënit me librin?

5. Si duhet ta lexojë prindi tekstin për ta bërë atë interesant?

6. Dëshironi të diskutoni se për çfarë bëhet fjalë në libër? Dëshironi të ndjeheni të lirë të bëni pyetje? Kush duhet t'i bëj pyetje? Kush dhe si t'u përgjigjet atyre? Kur – gjatë leximit dhe/ose pas leximit?

7. Do të dëshironit gjithmonë që vetëm prindi t'ju ftojë të lexoni bashkë, apo do të ndiheni të lirë që ju të merrni iniciativë? Si do ta iniconit atë? Nga cilat shenja të juaja një prind mund të shohë se ju pëlqen të "lexoni" së bashku?

8. Kush dëshironi të vendos se çfarë dhe kur të lexoni?


9. Ku do të dëshironit të ishin librat? Në cilën dhomë? Në çfarë lartësie?

10. Do të dëshironit të shihni një libër përmes të cilit do të njihni një kulturë të ndryshme nga ajo juaja dhe fëmijë me karakteristika dhe aftësi të ndryshme?

11. Çfarë do të fitonit ju si fëmijë nga vetë përmbajtja e librit dhe çfarë në lidhje me prindin me të cilin keni "lexuar" së bashku ashtu siç keni shkruar më lart se dëshironi?

12. Përveç librave, çfarë tjetër mund të "lexoni" së bashku me prindin?

13. Përveç në shtëpi, në cilat vende të tjera mund të "lexoni" së bashku?



*Lexoni me fëmijën
që nga lindja
të paktën nga 15 minuta
disa herë në javë!*

FP 7: Leximi me fëmijën – përgjigje

Imagjinoni një situatë ku një prind dhe një fëmijë "lexojnë" një libër së bashku! Ti je ai fëmijë!

Përgjigjuni pyetjeve më poshtë se si do të dëshironit të shkonte ajo në mënyrë që të ndiheni rehat, të argëtoheni dhe të zhvilloni kompetencat tuaja!

1. Si duhet të duket dhoma në të cilën do të "lexoni" së bashku?

Televizor të fikur, pa shpërqendrime të tjera.

2. Si do të dëshironit të uleshit me prindin?

Afër njëri-tjetrit; të dy të mund ta shohin bukur librin, por edhe fytyrat e tyre.

3. Kush duhet ta mbajë librin?

Të dy.

4. Çfarë do të dëshironit të mund të bënit me librin?

Duke treguar, duke kthyer faqet, duke vënë atë në gojë.

5. Si duhet ta lexojë prindi tekstin për ta bërë atë interesant?

Me shpejtësi dhe intonacion të përshtatshëm, duke ndryshuar zërin aty ku është e nevojshme...

6. Dëshironi të diskutoni se për çfarë bëhet fjalë në libër? Dëshironi të ndjeheni të lirë të bëni pyetje? Kush duhet t'i bëj pyetje? Kush dhe si t'u përgjigjet atyre? Kur – gjatë leximit dhe/ose pas leximit?

Po, bisedë dhe pyetje gjatë leximit dhe pas tij, të dyja palët mund të bëjnë lirisht pyetje, të priten përgjigjen nga fëmija, të jepen përgjigje të qarta nga prindi.

7. Do të dëshironit gjithmonë që vetëm prindi t'ju ftojë të lexoni bashkë, apo do të ndiheni të lirë që ju të merrni iniciativë? Si do ta iniconit atë? Nga cilat shenja të juaja një prind mund të shohë se ju pëlqen të "lexoni" së bashku?

Që edhe fëmija të mund të inicojë duke ftuar verbalisht prindin ose duke treguar/duke sjellur librin...

8. Kush dëshironi të vendos se çfarë dhe kur të lexoni?

Fëmija.

9. Ku do të dëshironit të ishin librat? Në cilën dhomë? Në çfarë lartësie?

Në çdo dhomë në të cilën fëmija do të ketë qasje të lehtë dhe në një lartësi të përshtatshme për t'i arritur ato.

10. Do të dëshironit të shihni një libër përmes të cilit do të njihni një kulturë të ndryshme nga ajo juaja dhe fëmijë me karakteristika dhe aftësi të ndryshme?

Po, fëmija njihet me dallimet dhe i pranon ato si një pjesë normale e jetës së përditshme dhe botës.

11.Çfarë do të fitonit ju si fëmijë nga vetë përmbajtja e librit dhe çfarë në lidhje me prindin me të cilin keni "lexuar" së bashku ashtu siç keni shkruar më lart se dëshironi?


Pasurim të fjalorit, zhvillim të shkrim-leximit, të gjuhës shprehëse, zhvillim të të folurit, imagjinatës, të menduarit kritik, praktikim të përqendrimit, nxitje të zgjidhjes së problemeve, njohje të kulturave të veta dhe të tjera, me fëmijë me karakteristika dhe aftësi të ndryshme...; ndjenja se është i/e denjë për vëmendje, ndjenja se prindi kujdeset për nevojat dhe interesat e fëmijës, argëtim...

12.Përveç librave, çfarë tjetër mund të "lexoni" së bashku me prindin?

Prospektet e dyqaneve, gazeta, revista...

13.Përveç në shtëpi, në cilat vende të tjera mund të "lexoni" së bashku?

Në park, në bibliotekë, në supermarket, në librari, në transport publik...



FP 8: Përralla e princeshës, princit dhe Olafit

Na ishte një herë një **princeshë** dhe një Olaf. **Princeshës** i pëlqente të vishte fustane të bukur, ndërsa **Olafit** i pëlqenin shumë përqaqimet.

Një ditë u shfaq një **princ** në pyll. **Olafi** nuk e pëlqeu **princin** sepse ai nuk donte të përqafohej, mbante një armë gjahu dhe sillej i rëndësishëm.


Por, **princesha** e pëlqeu shumë **princin** dhe ra në dashuri me të.

Olafi ishte shumë i trishtuar dhe i vetmuar.

Kur erdhi dimri, **Olafi** pa një flollë dëbore. Ajo ishte e ndritur dhe e bukur dhe ai zbuloi se asaj i pëlqente edhe të përqafohej.

Princesha vuri re që **Olafi** kishte rënë në dashuri dhe i kërkoi **princit** që të bënte që dimri të zgjaste përgjithmonë. **Princi** bleu një pallat në Polin e Veriut dhe atje **princesha, princi, fjolla e borës** dhe **Olafi** jetuan të lumtur së bashku deri në fund të jetës së tyre.

FP 9: mësimnxënia e fëmijëve nëpërmjet pjesëmarrjes në rutinat dhe ritet familjare



Shkruani se çfarë mund të mësojë fëmija nëse prindi e përfshin në mënyrë aktive në rutinën e tij të larjes/blerjes/pazarit!

**PYETËSOR PËR PRINDËR PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT
“MBËSHTETJE FAMILJES PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË FËMIJËVE NË SHTËPI”**

Të nderuar prindër,

Para jush është një pyetësor vlerësimi që është anonim, ndaj ju kërkohet të jepni përgjigje të sinqerta. Përgjigjet do të përdoren ekskluzivisht për vlerësimin dhe përmirësimin e Programit.

Ju lutemi rrethoni një numër në shkallë nga 1 deri në 4 që shpreh më mirë mendimin tuaj për secilin pohim më poshtë.

1-Nuk pajtohem

2-pjesërisht pajtohem


3-Shumë pajtohem

4-Plotësisht pajtohem

Ju falënderojmë paraprakisht!

| | Pohimi | Vlerësimi |
|-----|---|------------------|
| 1. | Programi i përmbushi pritjet e mia | 1 2 3 4 |
| 2. | Punëtoritë më bënë të ri-mendoj prindërimin tim | 1 2 3 4 |
| 3. | Mësova shkathtësi të reja (lidhja, monitorimi, pranimi) | 1 2 3 4 |
| 4. | Shkëmbeva përvoja me prindër të tjerë | 1 2 3 4 |
| 5. | U ndjeva rehat dhe e pranuar nga të tjerët në punëtoritë | 1 2 3 4 |
| 6. | Tashmë fotografia për fëmijën tim është ndryshe | 1 2 3 4 |
| 7. | Tani lexoj më shpesh me fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 8. | Tani e kam të qartë se si të inkurajoj mësimin dhe zhvillimin e fëmijës tim në shtëpi | 1 2 3 4 |
| 9. | Të dashurit e mi shohin një ndryshim | 1 2 3 4 |
| 10. | Ndjej se jam një prind më i suksesshëm | 1 2 3 4 |
| 11. | I identifikoj më mirë nevojat e fëmijës tim | 1 2 3 4 |
| 12. | Luaj më shpesh me fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 13. | Vërej pika të forta tek fëmija im që nuk i njihja më parë | 1 2 3 4 |
| 14. | Fëmija im po sheh një ndryshim | 1 2 3 4 |
| 15. | Di se si stresi ndikon në prindërimin tim | 1 2 3 4 |
| 16. | Kur bëj diçka në shtëpi, di si ta përfshij fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 17. | E kuptova dëmin e ndëshkimit fizik | 1 2 3 4 |
| 18. | I vërej pikat e mia të forta dhe pikat e forta të familjes sonë | 1 2 3 4 |
| 19. | E njoh rëndësinë që të dy prindërit të kujdesen për fëmijën | 1 2 3 4 |
| 20. | Mendoj se si të kujdesem për veten si prind | 1 2 3 4 |
| 21. | Di se çfarë është zhvillimi i hershëm i fëmijës dhe pse është i rëndësishëm | 1 2 3 4 |
| 22. | Si prind kam më shumë vetëbesim | 1 2 3 4 |
| 23. | Në vendim tim, ekzistojnë shumë njerëz dhe burime në të cilat mund të mbështetem | 1 2 3 4 |

Gjithsej, në sa punëtorë keni marrë pjesë? -----



PROGRAM SPECIFIK PËR MBËSHTETJE TË PRINDËRVE TË FËMIJËVE ME PENGESA NË ZHVILLIM



1. Hyrje

Mbështetja prindërore bazohet në dinjitetin e barabartë të prindërve dhe fëmijëve, si dhe në ndërveprimin cilësor ndërmjet fëmijës dhe prindërve nga njëra anë dhe praktikuesve me prindërit nga ana tjetër. Programi specifik për mbështetjen e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara (në tekstin e mëtejme: Programi) u krijua si një program specifik, mbështetja kryesore e të cilit gjendet në prindërimin pozitiv dhe në krijimin e një mjedisi stimulues për mësim dhe zhvillim në shtëpi. Si pjesë përbërëse e këtij koncepti, Programi përmban pikënisje teorike dhe strategji konkrete që do të ndihmojnë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi prindërore për ndërveprim pozitiv me fëmijët dhe të krijojnë mundësi mësimi bazuar në lojëra dhe rutinën në shtëpi. Ekziston një konsensus i fortë se prindërit janë mësuesit kryesorë dhe më të rëndësishëm të fëmijëve. Që nga lindja e fëmijës, familja është e përfshirë në zhvillimin dhe mësimin e fëmijës. Programi bazohet në të kuptuarit e faktit se mësimi dhe zhvillimi më i hershëm i fëmijës ndodh në familje dhe se përmes kontekstit familjar themeli i të mësuarit dhe zhvillimit të fëmijës ndërtohet në të gjitha kontekstet e tjera, ndër të cilat e para është kopshti. Programi promovon rëndësinë e zhvillimit të hershëm dhe duke qenë se zhvillimi i hershëm është një periudhë e mundësive dhe ndjeshmërisë më të madhe, sa më herët të ofrohet mbështetje për pjesëmarrje cilësore të prindërve në nxitjen e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijës, aq më gjatë do të zgjasin efektet pozitive tek fëmijët. Megjithëse kjo moshë është jashtëzakonisht e rëndësishme, duket se fëmijët me pengesa në zhvillim dhe familjet e tyre gjatë asaj periudhe nuk njihen mjaftueshëm nga sistemi si përdorues që kanë nevojë për mbështetje për zhvillimin e rolit prindëror. Në këtë mënyrë mungon mbështetja për prindin, rrjedhimisht edhe për fëmijën, në realizimin e plotë të potencialit të tij. Prandaj, Programi përveç këtyre vlerave: përfshirje, fokus në marrëdhëniet, kujdes për prindin, strategji të pa dhunshme për edukim, mbështetje për përfshirjen e të dy prindërve në kujdes, promovon qasjen dhe përfshirjen në sistemin e arsimit të hershëm në Maqedoninë e Veriut. Programi parashikon vizita në shtëpi të familjet me synimin për t'u afruar familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe për të mbështetur prindërimin. Për të siguruar barazinë dhe sinergjinë e praktikave edukative të prindërve dhe edukatorëve, është e nevojshme që programet e mbështetjes për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të integrohen në programin ekzistues të institucionit parashkollor, si dhe në programe të veçanta dhe të larmishme (QENDRA KËSHILLUESE PËR PRINDËR). Mbështetja e tillë prindërore inkurajon zhvillimin e hershëm të çdo fëmije, kontribuon për suksesin në arritjen e qëllimeve të programeve dhe institucioneve parashkollore, në përmirësimin dhe promovimin e shërbimeve, si dhe paraqet bazë për bashkëpunim cilësor dhe partneritet me familjen, për pjesëmarrje aktive dhe ndërtim të një rrjeti për mbështetje sociale të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kështu, programet mbështetëse bëhen të disponueshme për të gjithë prindërit, duke respektuar specifikat e kontekstit familjar dhe duke ngritur kapacitetet dhe ndjeshmërinë e bashkëpunëtorëve/praktikantëve profesionistë në kopshte për të punuar me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Programi ofron një hapësirë të re për të punuar me familjet që nuk do të thotë “të presësh” që familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të shprehin problemet e tyre, por është proaktiv. Është i orientuar nga parandalimi i izolimit social dhe promovimin, dukshmërinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse të familjes në mënyrë që i gjithë publiku të jetë i vetëdijshëm për to, si dhe të sigurojë bashkërendimin e shërbimeve dhe burimeve.

Programi është hartuar në mënyrë që institucione dhe organizata të ndryshme (OJQ, shoqata) në komunitet të mund të zbatojnë dhe integrojnë ndërhyrjet dhe shërbimet ekzistuese për prindërit, duke ndërtuar një rrjet mbështetës për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në komunitetin lokal. Programi ndryshon perspektivën e bashkëpunëtorëve profesionistë në kopshtin e fëmijëve sepse kërkon një rishikim të praktikës së tyre dhe një ndryshim të fokusit në

pikat e forta të familjes, me supozimin se të gjitha familjet, edhe ato më të rrezikuara, kanë kapacitetin për të inkurajuar zhvillimin e fëmijës. Ndjenja e efikasitetit dhe kompetencës në rolin e prindit është një nga rezultatet e programit që kërkon reflektim dhe monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të programit për të ndërtuar kompetenca praktike dhe reflektuese, si dhe përgjegjësi profesionale të të gjithë punonjësve të kopshtit.

Mirë se vini në Programin për Mbështetje të Prindërve të Fëmijëve me Pengesa në Zhvillim!

2. Bazat teorike të programit

2.1. Marrëdhëniet dhe kujdesi cilësor janë themeli i zhvillimit të fëmijës

Rëndësia e marrëdhënieve prind-fëmijë në fëmijërinë e hershme - Hulumtimet tregojnë se zhvillimi i trurit është kumulativ dhe shumë i ndjeshëm ndaj ndikimeve mjedisore, kështu që përvojat e hershme, mjedisi dhe marrëdhëniet vendosin themelet për zhvillimin e mëvonshëm. Mësimi dhe zhvillimi nuk mund të shihen të veçuar nga mjedisi fizik dhe psikologjik në të cilin **marrëdhëniet** luajnë një rol kyç në të nxënit. Dihet se çdo ndërveprim (pozitiv, negativ ose i munguar) kontribuon në zhvillimin e trurit të fëmijës duke hedhur bazat për të mësuarit e mëvonshëm. Fëmija e përjeton botën përmes marrëdhënieve që krijon dhe zhvillon, ndërsa ato marrëdhënie formojnë dhe përcaktojnë zhvillimin dhe mësimin e tij. Duke filluar me lidhjen me kujdesin parësor në moshën më të hershme, nëpërmjet marrëdhënieve që fëmija zhvillon me të rriturit dhe fëmijët e tjerë, marrëdhëniet janë pikat fillestare dhe mbështetëse mbi të cilat mbështetet i gjithë zhvillimi dhe mësimi.

Si ndërtohen marrëdhëniet? Sipas teorisë së lidhjes afektive, lidhja zhvillohet midis prindit dhe fëmijës dhe fillon si një grup sinjalesh të lindura që ftojnë prindërit të vijnë tek fëmija (qarje, buzëqeshje, kontakt vizual, etj.). Me përsëritjen e vazhdueshme të ndërveprimeve (sinjalet dhe përgjigjet e prindërve ndaj tyre), me kalimin e kohës zhvillohet një lidhje afektive, në të cilën kontribuojnë aftësitë njohëse dhe emocionale të fëmijës dhe përvoja e kujdesit të butë dhe të vëmendshëm (Berk, 2008). Provat kërkimore tregojnë se efektet më pozitive për zhvillimin e fëmijës arrihen *nëse marrëdhëniet me fëmijën janë të ngrohta, të kujdesshme, responsive dhe të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe karakteristikat e fëmijës* (Shonkoff, Phillips, 2000).

Sistemi i kujdestarisë (caregiving system), i cili së bashku me sistemin e lidhjes afektive zhvillohet tek prindërit dhe synon të mbrojë fëmijën dhe të sigurojë kujdes cilësor për të (Bowlby, 1980 sipas Pianta, Marvin, Britner, & Borowitz, 1996). Ky sistem përmban modele të brendshme për rolin e prindërve dhe për fëmijën dhe përcakton se kur duhet të aktivizohet dhe t'i sigurojë mbrojtje fëmijës, si dhe kur duhet të çaktivizohet (kur fëmija është i qetë dhe i mbrojtur), si dhe për çfarë sjellje to të zbatohet ajo. Në kontekstin e kujdesit për një fëmijë me aftësi të kufizuara, funksionimi i suksesshëm i sistemit të kujdesit mund të prishet, duke penguar kështu zhvillimin e një lidhjeje të sigurt emocionale sepse të mësuarit se fëmija ka një paaftësi është traumatike dhe stresuese. Sistemi prindëror aktivizohet për të përmbushur funksionin e tij bazë, që është mbrojtja e fëmijës, por prindi nuk mund ta mbrojë fëmijën nga diagnoza apo paaftësia. Prandaj, sistemi i kujdestarisë është "i detyruar" të mbrohet (George & Solomon, 2008). Prandaj, disa prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara minimizojnë ose ekzagjerojnë aftësinë e kufizuar të fëmijës, por në secilin rast ata bëhen më pak të ndjeshëm gjë që çon në zhvillimin e modeleve të pasigurta të lidhjes..

Çfarë është kujdesi cilësor? – Perceptimi modern i prindërimit në fushën e zhvillimit të hershëm përmes konceptit të **kujdesit inkurajues**, përcakton komponentët më të rëndësishëm të kujdesit cilësor për fëmijën. Me këtë koncept theksohet se për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, që nga fëmijëria më e hershme, më i rëndësishëm është mjedisi në të cilin kombinohet **kujdesi i vëmendshëm**, që synon nevojat fiziologjike, emocionale dhe sociale të fëmijës, si dhe nevojat e tij për autonomi dhe **kujdes inkurajues**, i cili ofron mundësi mësimi bazuar në eksplorim, lojë dhe pjesëmarrje. Koncepti i kujdesit inkurajues (Britto PR, Lye SJ, Proulx K, et al., 2017) dallon pesë fusha të mjedisit inkurajues që janë të ndërlidhura: kujdesi shëndetësor, kujdesi ndaj të ushqyerit, kujdesi i përgjegjshëm, siguria, mundësitë e të mësuarit në fëmijërinë e hershme. Njëkohësisht, fokusi i prindërve drejt nevojave të fëmijës, aftësia e tij për të vërejtur, njohur, kuptuar dhe për t'iu **përgjigjur** atyre, pra **responsiviteti**, njihet si çelësi i konceptit. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara (sigurisht jo të gjithë) që nuk arrijnë të ripërcaktojnë funksionin

e tyre prindëror janë më pak të fokusuar në nevojat e fëmijës sepse ose nuk i shohin sinjalet e fëmijës ose i keqinterpretjnë ato. Cilësia e kujdesit është më e ulët sepse dominohet nga kujdesi i tepruar me mbështetje të vazhdueshme (modeli i pasigurt/i preokupuar) ose pritshmëritë e tepërta nga fëmija dhe kërkesat për pavarësi dhe autonomi (modeli i pasigurt/modeli shmangës). Ajo që mungon është përvoja e lidhjes së fëmijës me disponueshmërinë dhe interesin e prindërve dhe mundësia për t'u mbështetur në drejtimin dhe mbështetjen e prindërve në eksplorimin e botës përreth tyre, e cila është baza e të mësuarit dhe zhvillimit të fëmijës. Në të kundërt, dështimi për të bashkëvepruar me fëmijën i pengon prindërit të njohin më mirë fëmijën, të bëhen më të aftë, duke zhvilluar kompetenca prindërore.

Në moshën e re, çdo situatë shihet si një mundësi mësimi. Pra, fëmija mëson përmes situatave të ndryshme - lojërave (që i mundëson të eksplorojë, të jetë kreativ, të manipulojë objektet që e rrethojnë), më pas të mësojë për rite dhe rutina të ndryshme në familje si dhe në situata jetësore në të cilat merr pjesë e gjithë familja. Programi nis nga fakti se nëse ka një mjedis stimuluues, mësimi dhe zhvillimi ndodhin gjatë gjithë ditës. Së këndejmi, rëndësia e zhvillimit të aftësive të prindërve për të krijuar një mjedis të tillë në **shtëpi** theksohet në këto fusha: *koha e lirë e familjes, pjesëmarrja në rutina, lojëra të përbashkëta, biseda me fëmijën dhe leximi me fëmijën*. Në kontekstin e prindërimit të një fëmije me aftësi të kufizuara, që iu është nënshtruar trajtimeve, ndërhyrjeve të ndryshme, fakti që prindi mund të inkurajojë zhvillimin në shtëpi gjatë gjithë ditës, përmes rutinave të përditshme dhe lojës është i rëndësishëm sepse afirmon rolin e tij dhe motivon prindin të mësojë aftësi për të krijuar një mjedis stimuluues në shtëpi.

2.2. Vlerat thelbësore të programit

Arsimi gjithëpërfshirës është një vlerë thelbësore e Programit dhe bazohet në modelin social për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në kuadër të këtij modeli, pengesa nuk konsiderohet vetëm si problem i individit, por edhe si problem i shoqërisë dhe funksionimit joadekuat të institucioneve përkatëse që duhet të ndryshohet për të siguruar kushte adekuate për zhvillimin dhe përfshirjen sociale të fëmijë me aftësi të kufizuara (Radoman, 2003). Rezultatet e hulumtimit tregojnë përfitime në zhvillimin social, emocional, të të folurit dhe njohës së fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në sistemin e arsimit të hershëm, si dhe një kontribut në një ndjenjë më të ulët të stigmatizimit dhe kapacitete më të mëdha për fillimin dhe mbajtjen e ndërveprimeve të qëndrueshme me fëmijët nga popullsia e përgjithshme (Henniger, Gupta, Henniger, & Vinh 2014; Banda, Hart, & Liu-Gitz, 2010). Disponueshmëria e edukimit të hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuara u siguron atyre bashkëpunim, partneritet, shkëmbim, një ndjenjë përkatësie dhe pranimit, njohje me mënyrat për të stimuluar dhe mbështetur zhvillimin dhe mësimin e fëmijës.

Toleranca, në një kuptim më të gjerë, përkufizohet si "respektimi, pranimi dhe njohja e diversitetit të pasur [...] të mënyrave të ekzistencës njerëzore" (Alzyoud et al., 2016: 35). Të mësosh për tolerancën dhe tolerancën e të mësuarit, gjegjësisht të mësosh të dish dhe të mësosh të veprosh, të mësosh të jetosh së bashku dhe të mësosh të ekzistosh (Delors, 1998) nënkupton kultivimin e kompetencave të fituara, por edhe pranimin e kompetencave dhe përvojave të reja. Programi mbështet fuqishëm pjesëmarrjen shoqërore dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve dhe familjeve të tyre në një komunitet unik, mbështet familjet dhe fëmijët për të ndërtuar një atmosferë pranimi dhe respekti. Së këndejmi, informimi për programin dhe promovimi i programit në thelb kanë ndërtimin e vlerave të përbashkëta mes të gjitha familjeve, përfshi dhe familjet e fëmijëve me zhvillim optimal.

Pranimi të fëmijës si kompetent i paraprin aftësia e *lidhjes* me fëmijën dhe monitorimi/njohja e fëmijës. Një prind që është i interesuar të investojë emocionalisht tek fëmija, përkatësisht që është i lidhur me fëmijën, do ta monitorojë fëmijën dhe do të vërejë dhe do të njohë

sinjalet e fëmijës, do t'i interpretojë ato në përputhje me rrethanat dhe do të japë përgjigjen e duhur. Lidhja, monitorimi dhe pranimi i fëmijës janë bazat mbi të cilat ndërtohet më vonë aftësia e prindit për të krijuar mundësi mësimi dhe zhvillimi. Lidhja dhe monitorimi i fëmijës si aftësi prindërore mund të dëmtohet nga paaftësia për të njohur, interpretuar në mënyrë adekuate dhe për të kuptuar sinjalet që e bëjnë të vështirë për prindërit t'i përgjigjen siç duhet një fëmije me aftësi të kufizuara. Pranimi i fëmijës lidhet negativisht me *stresin prindëror*, i cili mund të vijë nga domeni i fëmijës (karakteristikat e fëmijës të kushtëzuara nga paaftësia ose diagnoza, serioziteti i sëmundjes së fëmijës) ose nga domeni i prindërve (ndjenja e paaftësisë për rolin e prindit, mungesa e mbështetjes sociale, statusi ekonomik, konteksti kulturor).

Të dish se një fëmijë ka aftësi të kufizuara është një nga përvojat më traumatike që ndikon në funksionimin e prindërve, por edhe në qëndrimin ndaj fëmijës, si më pak i ndjeshëm. Shprehja "pikëllim për mospasje të fëmijës së përsosur" përdoret shpesh për të përshkruar procesin në të cilin prindërit ndryshojnë idetë e tyre për pritshmëritë e fëmijës dhe pranojnë imazhin e fëmijës së tyre me vështirësi kronike shëndetësore (Marvin & Pianta, 1996). Procesi i pranimit kërkon përpunim konjitiv dhe emocional të traumës së shkaktuar nga të kuptuarit e diagnozës së fëmijës. Procesi i përshtatjes dhe pranimit të gjendjes së fëmijës kërkon përpunim konjitiv dhe emocional të përvojës nga prindërit. Nga pikëpamja konjitive, ata duhet të kuptojnë implikimet e diagnozës së fëmijës. Emocionalisht, ata duhet të përjetojnë, pranojnë dhe shprehin ndjenjën e zhgënjimit, keqardhjes, trishtimit, zemërimit dhe fajit në mënyrë që të kuptojnë rëndësinë e informacionit që fëmija i tyre ka një aftësi të kufizuar zhvillimore (Barnett, Clements, Kaplan-Estrin, Fialka, 2003). Duke e pranuar këtë gjendje, prindërit bëhen bashkëpunëtorë dhe partnerë të fokusuar te fëmija, te pikat e tij të forta dhe mënyrat për të mbështetur mësimin dhe zhvillimin në kontekstin e aftësisë së kufizuar. Prindërit që nuk e kanë pranuar këtë nuk e kanë kapërcyer krizën e shkaktuar nga njohja e aftësisë së kufizuar dhe nuk kanë zhvilluar modele të pasigurta të lidhjes afektive, përkatësisht një marrëdhënie tepër mbrojtëse ose refuzuese. Është relativisht e vështirë për ta që të interpretojnë me saktësi shenjat e fëmijës së tyre dhe në këtë mënyrë të përmbushin rolin e tyre të kujdestarisë si prindër në përputhje me rrethanat. Të fokusuar në aftësinë e kufizuar, ata kanë pritshmëri të ulëta ose shumë të larta nga fëmija. Të gjitha familjet që përballen me stres intensiv në përgjithësi, veçanërisht stresin që ndërlidhet me kujdesin ndaj fëmijëve (sëmundje kronike, paaftësi zhvillimore të fëmijës) janë në rrezik të mos pranimit. Në këto familje duhet të punohet më intensivisht për pranimin e fëmijës, por edhe për pranimin e tyre si prindër, sidomos duke ditur që në çdo fazë të re të zhvillimit të fëmijës (të folurit, ecja etj.), prindërit përjetojnë emocione të reja të dhimbshme që lidhen me gjendjen e fëmijës (Barnett et al., 2003).

Të kuptuarit e (mos)pranimit të aftësisë së kufizuar si një faktor që ndikon në qëndrimin ndaj profesionistit është i rëndësishëm në pranimin dhe lidhjen me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara zhvillimore. Duke pranuar prindin e fëmijës me aftësi të kufizuara në zhvillim si prind që është në proces zgjidhjeje, i mundëson profesionistit që në bashkëpunim me prindërit të kuptojë këndvështrimin e prindërve, arsyen e emocioneve dhe sjelljeve të pakëndshme, të normalizojnë gjendjen, të distancohen emocionalisht dhe të mbrohen nga djegia (harxhimi) profesionale. Njohja e konceptit i drejton profesionistët te pikat e forta të familjes, gjegjësisht ato cilësi që i mundësojnë familjes të kapërcejë me sukses sfidat në rrugën drejt mirëqenies së tyre (Mackay, 2003).

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zhvillim përballen me sfida të shumta dhe shumë stresuese. Sfidat që dalin përballë familjes për rritjen e një fëmije me aftësi të kufizuara ndërlidhen me kërkesat fizike që kanë të bëjnë me rritjen e nevojës për t'u kujdesur për fëmijën, por edhe me kërkesat në nivel emocional për shkak të emocioneve jashtëzakonisht të vështira të përjetuara nga prindërit. Megjithëse prindërit e fëmijëve me zhvillim optimal përballen me kriza zhvillimi si fillimi në kopsht dhe stresi zhvillimor, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara

përballen me të njëjtat sfida por edhe me sfida të tjera shtesë. Në çdo moment historik zhvillimor (fëmija nuk flet, nuk ka ecur), ata përballen me emocione të pakëndshme (frikë, shqetësim, trishtim) dhe me kërkesë për të ripërcaktuar pritshmëritë e tyre nga fëmija dhe kujdesi. Hulumtimet kanë treguar se riformulimi është strategjia më e përdorur për përballimin e stresit midis prindërve të fëmijëve me paralizë cerebrale sepse i ndihmon prindërit të ripërcaktojnë situatën e tyre të vështirë për ta bërë atë më kuptimplotë dhe të pranueshme (Krstic & Oros, 2012). Ndjenja e trishtimit, e frikës, ndryshimi i pritshmërive dhe shpresës për të ardhmen, ndjenja e fajit, përgjegjësisë dhe turpit, zemërimi i shprehur drejtuar profesionistëve që punojnë me fëmijën, çojnë në dëmtim të vetëvlerësimit dhe dobësim të vetëbesimit, si dhe besimin e prindërve në veten e tyre si dikush që kujdeset dhe mbron fëmijën. Kjo kontribuon në ballafaqimin e vazhdueshëm me nevojat e fëmijës, pamundësinë e njohjes së ndjeshme të nevojave të fëmijës dhe dëmtimin e cilësisë së kujdesit ndaj fëmijës për shkak të mospranimit të diagnozës ose paaftësisë së fëmijës.

Pranimi i tipareve, ndjenjave dhe sjelljeve të fëmijës suaj dhe pranimi i vetes si prind, pa gjykuar, ju ndihmon të kuptoni se prindërimi sjell sfida të ndryshme. Ky pranim nuk do të thotë heqje dorë nga përgjegjësia për rritjen dhe drejtimin e fëmijës, por do të thotë të pranosh se sfidat dhe gabimet janë pjesë përbërëse e prindërimit. Prindërit që nuk e pranojnë këtë, ballafaqohen vazhdimisht me nevojat e fëmijës sepse nuk mund t'i njohin me ndjeshmëri nevojat e fëmijës, gjë që kontribuon në dëmtimin e cilësisë së kujdesit. Dështimi për të bashkëvepruar me fëmijën cenon vetëvlerësimin dhe besimin e prindërve në veten e tyre si dikush që kujdeset dhe mbron fëmijën. Vlerësimi negativ i aftësisë së prindërve çon në mospranimin e vetes si prind dhe si pasojë ka tërheqje dhe distancim nga bashkëveprimi me fëmijën, si dhe çon në një cilësi gjithnjë e më të ulët të kujdesit.

Pjesëmarrja e fëmijës kushtëzohet edhe nga bindjet dhe vlerat që prindërit kanë për fëmijën. Kur fëmija pranohet si i tillë, me fokus në forcën, aftësitë, shkathtësitë dhe potencialet e tij, praktika edukative e të rriturve mund të ofrojë një mori mundësish për pjesëmarrjen e fëmijës në jetën e familjes dhe në kopsht. Fëmijët mësojnë duke marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta (rutina familjare, rite, lojëra) me të rriturit dhe fëmijët e tjerë. Përveç mënyrave të të kuptuarit të fëmijës, pjesëmarrja e fëmijës ndikohet edhe nga njohuritë e prindërve për mënyrën se si fëmija mëson dhe nga cilësia e marrëdhënieve me fëmijën dhe rreth tij. Që prindi të pranojë fëmijën me aftësi të kufizuara zhvillimore dhe të sigurojë pjesëmarrjen e tij, është e nevojshme të ripërcaktohet funksioni i tij prindëror në një kuadër koherent (çfarë nënkupton jesh prind i një fëmije me aftësi të kufizuara zhvillimore). Është po aq e rëndësishme të përqendrohemi te fëmija i vërtetë, këtu dhe tani, dhe të fokusohemi në pikat e tij të forta. Nëse prindi ka pritshmëri shumë të larta nga fëmija, mjedisi rreth fëmijës do të kërkojë shumë dhe fëmija nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë. Nga ana tjetër, nëse prindi vendos para fëmijës stimuj që janë më të vegjël në raport me forcën e tij, pjesëmarrja e fëmijës nuk ka kuptim, nuk është sfidë dhe fëmija nuk merr pjesë. Aftësia për të gjetur një ekuilibër të mirë midis autonomisë dhe mbështetjes, të njohurës dhe të panjohurës, është gjithashtu e vështirë për prindërit e fëmijëve me zhvillim optimal. Pjesëmarrja është një koncept kyç në qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut ndaj arsimit. Edhe pse Konventa për të Drejtat e Fëmijës thekson të drejtën për arsimim të çdo fëmije, duke u regjistruar në kopshtin e fëmijëve, fëmija e realizon të drejtën e tij për arsimim. Vetëm me pjesëmarrjen aktive në lojë, mësim, rutina dhe rite në kopsht mund të flitet për realizimin e të drejtave të fëmijës në arsim. Duke qenë se pjesëmarrja e një fëmije tani në masë të madhe përcakton pjesëmarrjen në të ardhmen dhe procesin që mundëson të mësuarit, është e rëndësishme të hiqen barrierat ndaj pjesëmarrjes. Mënyra e pjesëmarrjes së fëmijëve përcaktohet nga kapacitetet zhvillimore të fëmijëve, përvoja dhe interesat e tyre, moshë në kontekstin e aftësisë së kufizuar. Mënyra e reagimit dhe respekti i të rriturve të afërt të cilët i takojnë fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore rrit dhe mbështet zhvillimin e kompetencave. Përqendrimi i prindërve në pikat e forta të fëmijës dhe në kapacitetet "këtu dhe tani" mbështet pranimin dhe pjesëmarrjen e fëmijës.

Pra, pengesat për pjesëmarrje mund të vijnë nga të rriturit, gjegjësisht nga bindjet e tyre dhe mënyra e të kuptuarit të fëmijës. Pjesëmarrja e fëmijës mund të ndikohet nga njohuritë e prindërve dhe edukatorëve se si fëmija mëson një stil specifik të të mësuarit, shprehjes, kërkimit, cilësia e marrëdhënieve me fëmijën dhe rreth fëmijës (mbrojtje/refuzim). Mbrojtja e tepruar e fëmijës e bën të pamundur pjesëmarrjen, ashtu si qëndrimi refuzues sepse në të dyja rastet pritishtëritë e prindërve nuk do të përputhen me nevojat e fëmijës. Ndonjëherë, pengesat për pjesëmarrje vijnë edhe nga fëmija, nga serioziteti i paaftësisë, prandaj është e rëndësishme që prindërit të drejtohen drejt forcës së fëmijës që çon në pranimin e fëmijës dhe zhvillimin e aftësive për të krijuar një mjedis në të cilin fëmija mund të marrë pjesë. Duke ditur se shpeshherë rutinat e familjes dhe funksionimi i familjes prishen nga kujdesi për një fëmijë me aftësi të kufizuara, është e rëndësishme që profesionistët të kuptojnë kontekstin e familjes dhe të jenë të ndjeshëm.

Njëlloj si me pjesëmarrjen dhe pranimin e fëmijës me aftësi të kufizuara në zhvillimin e marrëdhënieve fëmijë-prind, profesionistët, si një proces paralel, duhet të zhvillojnë aftësitë për pranimin dhe pjesëmarrjen e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopsht në raport prind - bashkëpunëtor profesional. Pranimi nënkupton braktisjen e qasjes tradicionale dhe rolin e "ekspertit" që ofron njohuri dhe kalimin në qasjen dhe rolin modern të partnerëve. Një qasje e partneritetit prindëror do të thotë që prindërit janë të përfshirë në vendimmarrje, se këndvështrimi i tyre vlerësohet dhe çmohet sepse ata janë ekspertët që e njohin më mirë fëmijën e tyre. Në këtë drejtim, komunikimi me prindërit përfshin lidhjen dhe monitorimin e reagimeve të prindërve për të kuptuar këndvështrimin e prindërve.

Ky program fokusohet në rolin e rëndësishëm të prindërve dhe kujdestarëve ligjor për të formuar një mjedis stimulues, ndërsa aftësitë joadekuate prindërore janë shkaqet kryesore të *ndëshkimit trupor* të fëmijëve. Hulumtimet tregojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore janë në rrezik më të madh për t'u ndëshkuar fizikisht. Mospranimi i fëmijës dhe fokusimi tek aftësia e kufizuar çon në pritishtëri shumë të larta ose shumë të ulëta të fëmijës me aftësi të kufizuara, gjë që i bën prindërit më të prirur për të reaguar në mënyrë të dhunshme. Prindërimi pozitiv i mbështet prindërit për të zbatuar strategji të prindërimit jo të dhunshëm duke zhvilluar dy aftësi të rëndësishme – *pranimin e fëmijës dhe udhëheqjen e fëmijës nëpër situata* (ofrimin e strukturës). *Pranimi i fëmijës* nënkupton që fëmija e di që ndjehet i dashur (duke treguar dashuri) pavarësisht nga rrethanat. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara shpeshherë nuk e shohin fëmijën për shkak të aftësisë së kufizuar. Prandaj është e rëndësishme që prindi të njohë dhe të kuptojë sjelljen dhe emocionet e fëmijës së tij, të jetë në gjendje të vendosë veten në pozicionin e fëmijës dhe të njohë nevojat, si dhe në sjelljen e fëmijës të jetë në gjendje të njohë nevojën, iniciativën dhe interesin. Të udhëzosh fëmijën nëpër situata do të thotë t'i japësh fëmijës udhëzime të qarta për sjelljet e pritura, të sigurtat dhe të dobishme, t'i shpjegosh fëmijës arsyet e kërkesës së prindit dhe të mbështesësh dhe ndihmosh fëmijën të kapërcejë me sukses sfidat, të jesh një model pozitiv dhe të zgjidhin sfidat së bashku. Edukatorët dhe përkëdhelësit mund t'ua mësojnë prindërve këto aftësi dhe të përshtatin strategji dhe aftësi të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve pa dhunë.

Të dish që një fëmijë ka aftësi të kufizuara është traumatike dhe stresuese për familjen. Disa njerëz "nxjerrin" rritje psikologjike pozitive nga përvojat e vështira të jetës, jo si rezultat i një mrekullie, por i vendosmërisë për të kapërcyer sa më shumë stresin dhe fatkeqësitë (Lazarus, 2003). Për disa prindër, stresi është aq i fortë sa që i bën të ndjehen të pafuqishëm. Stresi i përditshëm që ndërlidhet me rolin e prindit të një fëmije me aftësi të kufizuara zhvillimore rritet në mënyrë që prindërit të ndihen gjithnjë e më tepër në depresion, të pafuqishëm dhe të pavlerë (Crnic, Friedrich, & Greenberg, 2002). Kërkesat e shtuara për kujdesin ndaj një fëmije me aftësi të kufizuara zhvillimore mund të kenë pasoja në **shëndetin** fizik dhe **mendor të prindërve**. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë nevojë për mbështetje për të zotëruar strategji

për tejkalimin dhe kanalizimin e emocioneve të pakëndshme, për të kërkuar ndihmë nga familja e gjerë dhe burime nga komuniteti, për të patur si mbështetje të parë një person të besuar që mund të jetë edhe një bashkëpunëtor profesional në kopsht. Është e rëndësishme të jesh një hap përpara prindërve dhe të veprësh në përputhje me stresin e përjetuar nga prindi (për t'i ofruar prindit strategji për të kapërcyer stresin) dhe për të mundësuar ndërveprim, lidhje dhe një marrëdhënie cilësore midis prindërve dhe fëmijës. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zhvillim nuk janë të sigurt se cili do të jetë rezultati i gjendjes shëndetësore të fëmijës dhe prognoza e zhvillimit të tij në të ardhmen, ata janë të ngarkuar me kontrole dhe procedura më të shpeshta mjekësore si dhe me kërkesa specifike të kushtëzuara nga sëmundja e fëmijës. Stresi në familje mund të përforcohet nga qëndrimet negative sociale ndaj personave me aftësi të kufizuara, nevoja për kujdes të zgjatur fizik, pikëllimi i panjohur i prindërve për shkak të pritjeve të porealizuara si dhe barra financiare, përgjegjësitë dhe shqetësimet që lidhen me të ardhmen e fëmijës në jetën e mëvonshme (Dyson, 1993, sipas Krstić, 2013). Përveç kësaj, ka një ridefinim të roleve në familje, për shembull, nëse nëna do të kthehet në punë dhe do të ketë një rol jashtë amësisë apo jo, gjë që mund të çojë në ulje të të ardhurave, por edhe në ulje të pavarësisë së nënës (Langridge, 2002, sipas Krstić, 2013). Të preokupuar me kujdesin për një fëmijë me aftësi të kufizuara zhvillimore, prindërit priren të neglizhojnë veten. Është e rëndësishme të kuptohet se është e pamundur të krijohen kushte të mira për zhvillimin e fëmijës nëse nuk kujdesemi për prindërit dhe kujdestarët dhe nëse nuk jemi me ta me intensitetin që ata kanë nevojë. Ekzistojnë dëshmi se mirëqenia emocionale e prindërve/kujdestarëve dhe shëndeti mendor i prindërve janë kritike për kujdesin dhe zhvillimin cilësor të fëmijëve. Në mënyrë që prindërit të ofrojnë kujdes cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore, ata duhet të kenë të tjerë që i mbështesin dhe kujdesen për ta. Prindërit që përdorin mbështetje institucionale e kapërcejnë më lehtë stresin, veçanërisht nëse fëmija i tyre ka një formë më të rëndë të paaftësive zhvillimore (Krstić & Oros, 2012).

Prandaj, kujdesi për mirëqenien emocionale dhe shëndetin mendor të prindërve përfshin inkurajimin e prindërve që të kujdesen për veten, të kërkojnë mbështetje dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre për të përballur sfidat e prindërimit.

2.3. Rutinat në familje dhe lojërat si mundësi për zhvillim

Një fëmijë mëson më së miri në marrëdhëniet e karakterizuara nga besimi, siguria, ngrohtësia dhe respekti për këndvështrimin e fëmijës. Kjo marrëdhënie midis prindërve dhe fëmijës nxit vullnetin e fëmijës për të mësuar me të rriturin. Stimujt "fshihen" në *përditshmërinë e familjes, në kohën e lirë të familjes, në ritualet e familjes* sepse janë të pasura me sfida dhe mundësi mësimi dhe zhvillimi. Në këtë mënyrë, shumica e punëve të shtëpisë mund të bëhen një mundësi për të shijuar dhe kaluar kohë cilësore me fëmijën, një kohë kur prindërit mund të kryejnë detyrat e tyre të zakonshme dhe në të njëjtën kohë t'i ofrojnë fëmijës një sërë stimuluesh të vlefshëm për zhvillim. Pjesëmarrja e fëmijëve në rutinat dhe ritet e jetës familjare nxitet më rrallë në familjet e fëmijëve me pengesa zhvillimore (Mancini dhe Coster 2004; Rosenberg et al. 2010a).

Aftësia e një fëmije për të "përdorur" stimujt do të varet nga aftësitë e kujdesit ndaj fëmijëve, ndaj është e domosdoshme që prindërit të mbështeten në aftësitë e të mësuarit që do të rrisin cilësinë e marrëdhënieve fëmijë-prind dhe cilësinë e kujdesit që hedh themelet për zhvillimin e mëtejshëm dhe mësimin e fëmijës. Aftësitë që një prind duhet të ketë që rutinat të shndërrohen në mundësi për mësim dhe zhvillim janë:

- Vëzhgon me kujdes nevojat e fëmijës, monitoron si i paraqet ato për të njohur sa më mirë mënyrën se si reagon fëmija në situata të ndryshme.
- I përgjigjet vazhdimisht sinjaleve të fëmijës dhe e mbështet fëmijën për të përmbushur nevojat e tij.
- Çdo formë të iniciativës së fëmijës (buzëqeshje, lëvizje, vështrim, drejtim i gishtit), prindi i përgjigjet (me buzëqeshje, imitim, duke e drejtuar vëmendjen tek objekti i interesit të

fëmijës, duke e emërtuar atë). Në këtë mënyrë do të zgjerohet edhe më shumë ndërveprimi dhe do të ofrohen mundësi shtesë për të nxitur zhvillimin.

- Ndjek me kujdes atë që ka tërhequr vëmendjen e fëmijës, mbështet dhe nxit iniciativën në drejtimin që tregon fëmija. Për shembull, nëse fëmija tregon librin me figura, prindi mund të thotë: "Shiko librin me figura, eja të lexojmë së bashku".
- I mundëson fëmijës të jetë sa më i pavarur në aktivitetet që dëshiron të kryejë dhe ta mbështesë atë në atë proces pikërisht atë sa t'i sigurojë fëmijës kushte për të arritur qëllimin e tij, gjë që ai nuk duhet ta bëjë atë në vend të fëmijës. Prandaj, është e rëndësishme që prindi të besojë se fëmija është kompetent dhe i aftë, gati për të mësuar dhe për t'u zhvilluar.
- Bisedon me fëmijën, i flet fëmijës (emërton gjërat që bën fëmija) dhe i përshkruan fëmijës situatat e ndryshme gjatë veshjes, përgatitjes së vakteve, daljes në pazar ose ndonjë aktiviteti tjetër.

Përveç aftësive prindërore të sipërpërmendura që ndërtojnë një mjedis stimulues, është gjithashtu e rëndësishme që mjedisi fizik të pasqyrojë pikat e forta të fëmijës. Një prind i ndjeshëm di si ta përshtatë pjesëmarrjen e fëmijës në kontekstin e aftësisë së kufizuar, i cili nuk është një kufizim për zhvillimin e marrëdhënieve më të mira, por kërkon një mjedis fizik të ndryshëm. Aftësia e prindit për të mundësuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e fëmijës në rutina mbështetet në pranimin dhe njohuritë e fëmijës për interesat e fëmijës dhe repertorin e aftësive për ndërveprim me mjedisin. Për shembull, një fëmijë me shikim të dëmtuar mund të prekë, të njohë dhe të emërtojë pjesët e rrobave, çfarë është e madhe dhe çfarë është e vogël, e rëndë, e lehtë, e lagur dhe të tjera, së bashku me një prind të ndjeshëm, i cili i jep mbështetje atij që do ta kthejë rutinën në lojë dhe kënaqësi. Një rutinë e tillë është e mbushur me marrëdhënie, të qeshura, biseda, afërsi me prindin, është argëtuese për fëmijën, ka kuptim për të dhe nxit zhvillimin dhe mësimin. Pjesëmarrja e fëmijës në rutina si një stimul zhvillimi është sigurisht një risi për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që i motivon prindërit të zotërojnë mënyrat për t'i vënë në dispozicion fëmijës sa më shumë stimuj. Ekzistimi i rutinave të lojës dhe nxitja e përditshme e zhvillimit dhe mësimin në familje, gjatë gjithë ditës, është një informacion i rëndësishëm për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zhvillim. Përvetësimi i aftësive nga ana e tij fillon më shumë ndërveprime me fëmijën, çon në një ri-mendim të imazhit të fëmijës (me fokus në forcën e fëmijës), ndërton kompetencat prindërore dhe ofron një mundësi që prindi të njohë fëmijën dhe të riafirmojë rolin e tij. Për fëmijën, pjesëmarrja në rutina do ta lejojë atë të krijojë marrëdhënie me prindin, të ketë ndjenjë të përkatësisë, të kontribuojë, të zhvillojë aftësi, të ketë komunikim me të rriturit në përvojën e këndshme shoqërore të familjes.

Fëmija mëson duke luajtur, ndërsa të *mësuarit* përmes lojës nënkupton krijimin e situatave në të cilat fëmija mund të luajë me përvojat e fituara. Një stimul loje mund të jetë çdo ndryshim, risi, interes nga mjedisi, që tërheq vëmendjen e fëmijës dhe fëmija dëshiron të angazhohet në të. Ky Program promovon idenë që të gjithë fëmijët të kenë qasje në lojëra cilësore si një mundësi për të mësuar dhe zhvilluar potencialin e tyre në një mjedis familjar. Aktivitete të tilla si leximi, këndimi i këngëve dhe vallëzimi, lëvizja, loja në shesh lojërash, shëtitjet paraqesin lojë. Fëmija do të mësojë për veten dhe botën përreth tij dhe do të zhvillojë aftësi të ndryshme përmes lojës, gjithmonë pranë prindërve dhe në ndërveprim me ta. Loja është një aktivitet që nënkupton udhëzime të matura të prindërve/të rriturve që nuk shuan kureshtjen, kreativitetin dhe dëshirën e fëmijës për të luajtur, por i ndihmon fëmijët të organizojnë përvojën e tyre. Kjo kërkon që të rriturit të monitorojnë dhe vëzhgojnë me kujdes lojën e fëmijës, të interpretojnë, vënë në dyshim, thellojnë dhe drejtojnë përvetësimin e njohurive të reja dhe aftësive prindërore. Prindi që është i lidhur me fëmijën e pranon fëmijën, e monitoron fëmijën (vëren, interpreton sinjalet e fëmijës dhe jep përgjigjen e duhur), kupton këndvështrimin e fëmijës, vëzhgon me kujdes, i përgjigjet fëmijës, kupton se çfarë tregon sjellja e fëmijës, në mënyrë të përshtatshme, interpreton interesat, ndjenjat, opinionet dhe synimet e fëmijës, krijon me mjeshtëri të mësuarit përmes lojës. Në kua-

drin e edukimit të fëmijëve me pengesa në zhvillim prindërit nganjëherë për nuk e shikojnë fëmijën për shkak të paaftësisë së tij, përkatësisht nuk i dallojnë nevojat e kujdesit nga nevojat për mbështetje të zhvillimit. Loja me fëmijën, e cila nuk synon t'i mësojë fëmijës apo të krijojë një enigmë, por njihet si një mundësi ndërveprimi, shkëmbimi afërsie dhe kënaqësie, është një nxitje për zhvillimin e fëmijës. Leximi me fëmijën si një nga ritet është një lloj mësimi përmes lojës (duke luajtur me fjalët, personazhet, etj.), i cili është një stimul i plotë vetëm kur përfshin ndërveprim me prindin. Libri është vetëm një mjet për të tërhequr vëmendjen e fëmijës dhe fëmija mund të zgjedhë se çfarë dhe me kë dëshiron të lexojë. Edhe pse në fillim, prindi e nis leximin, më vonë pjesëmarrja e fëmijës nënkupton që fëmija fillon leximin (do të sjellë librin, do të tregojë me gisht), që nënkupton se disponueshmëria e librit në raft ose në dysheme është gjithashtu e rëndësishme për pjesëmarrjen e tij. Gjithashtu, fëmija ka të drejtë të zgjedhë me kë dhe çfarë dëshiron të lexojë. Prindi duhet të mbajë me mjeshtëri kontaktin ballë për ballë (të heqë zhurmën, televizorin dhe shpërqendrimet e tjera), të vazhdojë ndërveprimin dhe të sigurojë afërsinë fizike (në mënyrë që ai të shohë fytyrën e fëmijës) si karakteristika të rëndësishme që i mundëson një ndërveprim të këndshëm fëmijës në çdo aktivitet, duke përfshirë leximin e përbashkët. Leximi me fëmijën i jep prindit mundësinë të monitorojë fëmijën, të vërejë sinjalet, të kuptojë sinjalet e fëmijës dhe të përgjigjet në përputhje me rrethanat, duke praktikuar aftësitë dhe kompetencat e tij prindërore, duke zhvilluar vullnetin dhe aftësinë për të monitoruar nevojat dhe reagimet e fëmijës, duke u mbështetur në iniciativat e fëmijës, për të pritur me durim përgjigjen e fëmijës dhe për të mbështetur pjesëmarrjen e tij dhe në këtë mënyrë të hedhin themelet e marrëdhënieve të sigurta, të ngrohta dhe përvojave pozitive për fëmijën. Një prind që di të bëjë pyetje, të bëjë tinguj të ndryshëm që shoqërojnë ligjërimin, ta kthejë tregimin në lojë dhe të përshtatë udhëzimet e leximit sipas mënyrës se si fëmijët përvetësojnë të kuptuarit dhe zgjidhin detyrat, do ta bëjë leximin një mundësi shumë stimuluese për zhvillim dhe mësim. Prandaj, leximi me fëmijën konsiderohet një formë e stimulimit të zhvillimit, në veçanti për familjet e fëmijëve me pengesa në zhvillim.

2.4. E drejta e mbështetjes për prindin dhe fëmijën

E drejta e çdo fëmije për një mjedis stimulues buron nga fakti se zhvillimi i hershëm është periudha e ndjeshmërisë më të madhe dhe mundësive më të mëdha për të mësuar dhe për zhvillim. Mbështetja e zhvillimit të hershëm njihet si një ndër prioritetet në dokumentet e mëposhtme:

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës thekson se fëmija ka të drejtë të zhvillohet në "masë më të madhe të mundshme" dhe se shtetet nënshkruese duhet të ofrojnë "ndihmë të përshtatshme për prindërit dhe kujdestarët ligjorë për të kryer përgjegjësitë e tyre për rritjen e fëmijëve dhe zhvillimin të institucioneve, objekteve dhe shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve."

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara kujton se "nëse fëmijët e vegjël me aftësi të kufizuara identifikohen herët dhe marrin mbështetje, ka më shumë gjasa që ata të kalojnë pa probleme në mjedisin arsimor gjithëpërfshirës parashkollor dhe fillor." Kjo konventë thekson gjithashtu rolin e familjes për zhvillimin e fëmijës dhe rolin e shtetit për ofrimin e mbështetjes për familjen.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) theksojnë se investimi në zhvillimin e hershëm të fëmijëve është bërë jo vetëm një objektiv në vetvete, por edhe një kusht për arritjen e shumë objektivave të tjera të zhvillimit të qëndrueshëm për të zhdukur varfërinë dhe urinë dhe për të përmirësuar ushqimin e fëmijëve, për të siguruar jetë të shëndetshme, për të siguruar mësim gjatë gjithë jetës, arritje të barazisë gjinore dhe reduktim të pabarazisë. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm përfshijnë synimin e mëposhtëm kryesor për zhvillimin e fëmijërisë së hershme "Deri në vitin 2030, t'u sigurohet të gjitha vajzave dhe djemve të kenë qasje në kujdes cilësor, si dhe arsim parashkollor për t'i përgatitur ata për arsimin fillor." Në këtë kuptim, Objektivat për

Zhvillim të Qëndrueshëm përfaqësojnë një mundësi historike për prioritizimin e investimeve në zhvillimin e fëmijërisë së hershme.

Udhëzimet e OKB-së për kujdesin alternativ për fëmijët theksojnë se "organizatat dhe autoritetet kompetente duhet të bëjnë çdo përpjekje për të parandaluar ndarjen e fëmijëve nga prindërit dhe kujdestarët parësor, përveç rasteve kur interesi më i mirë i fëmijës e kërkon këtë" (neni 154).

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara ose sëmundje kronike përballen me sfida të mëdha si ofrimi i trajtimeve dhe procedurave të përshtatshme terapeutike për fëmijë, por edhe sfida të natyrës sociale si mbështetja sociale, izolimi, përjashtimi (Leonard, Brust, & Nelson, 1993). Gjithashtu, familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara shpeshherë përballen me izolim social për shkak të stigmatizimit nga shoqëria. Disa prindër kanë vështirësi me mjedisin e fëmijës së tyre gjë që ndikon në ndjenjën e tyre të identitetit. Këta prindër mund të përfitojnë nga takimi me prindër të tjerë të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të reduktuar ndjenjën e tyre të tjetërsimit dhe për të pranuar gradualisht rrethanat e veçanta të jetës së tyre (Boström et al., 2010). Në kohët moderne, të gjithë prindërit përballen me sfida të shumta, të cilave u duhet shtuar dhe sfidat e shumta dhe të panumërta të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Programi thekson se procesi i të mësuarit për prindërimin është shumë më tepër se sa edukim sepse i ndihmon prindërit të afirmohen në rolin e prindërve dhe të përmirësojnë prindërimin e tyre. Mënyra e ofrimit të mbështetjes për prindërit është përmes një programi grupor i cili përkufizohet si një proces që përfshin zgjerimin e mprehtësisë dhe të kuptuarit, përvetësimin e njohurive dhe aftësive për zhvillimin e prindërve dhe fëmijëve të tyre dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre. Prindërit shihen se kanë kapacitet për të mësuar nga përvoja e përditshme në rolin e tyre prindëror. Së këndejmi, si qëllim përfundimtar i programit për prindërit në modelin modern, theksohet "ngritja e kapaciteteve", me qëllim aktivizimin e pikave të forta, mundësive dhe kompetencave të prindërve për ndryshime.

3. Mbështetja kryesore e programit

Programi specifik për mbështetjen e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara ofron një qasje prindërore, një koncept edukativ dhe strategji specifike që mbështesin zhvillimin e vlerave prindërore, njohurive, aftësive për ndërveprim pozitiv me fëmijët.

Për fëmijën, situata e të mësuarit, para së gjithash, do të thotë disponueshmëria e një *NXI-TJEJE* interesante që e bën fëmijën të *mendojë* më thellë. Më pas, nënkupton edhe mundësi që fëmija të gjejë një përgjigje për pyetjen e tij duke ndjekur *kureshtjen* e tij të natyrshme, interesin e tij, duke zbatuar atë që di dhe është në gjendje, duke hulumtuar në mënyrë aktive, duke u përpjekur dhe manipuluar ata që ai i konsideron si faktorë kyç të fenomenit që i ka shkaktuar interes. Fëmija menaxhon në *mënyrë aktive* procesin e tij njohës. Ai e ndryshon realitetin dhe e përshtat atë me vetveten, në mënyrë që të jetë më e lehtë për të gjetur një "emër" për atë që përpiket të kuptojë në mënyrë që të krijojë rrethana në të cilat mund të shijojë të mësuarit dhe në të cilat të mësuarit të çon në rezultate të sigurta. Nuk ekziston asnjë stimul i vetëm që në vetvete do të çojë në një hap të madh përpara të zhvillimit nëse nuk ka asnjë të rritur që di ta emërtojë atë, t'i ofrojë kuptim, ta drejtojë fëmijën përmes përvojës, të zgjerojë lojën, të vazhdojë interesin dhe eksplorimin e fëmijës. Fëmija mëson më së miri në marrëdhëniet e karakterizuara nga besimi, siguria, ngrohtësia dhe respekti për këndvështrimin e fëmijës. Një marrëdhënie e tillë midis prindërve dhe fëmijës ushqen vullnetin e fëmijës për të mësuar me dikë dhe nga dikë.

Ky program nënkupton që *stimujt* për mësim dhe zhvillim gjenden në rutinat, lojërat, leximin me fëmijën në shtëpi (të mësuarit për rutinat dhe të mësuarit përmes lojës) sepse ato janë të pasura me mundësi zhvillimi, por vetëm kur bazohen në ndërveprimin me prindin. Së këndejmi, praktika edukative duhet të bazohet në *pjesëmarrjen e fëmijës në jetën e familjes dhe prindërimin pa ndëshkim*. Programi specifik për mbështetjen e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara është konceptuar mbi bazën e Programit për Prindërim Pozitiv dhe përmban të njëjtat pikënisje, vlera themelore dhe synime të parë nga prizmi i prindërimit dhe kujdesit për një fëmijë me aftësi të kufizuara. Duke marrë parasysh sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballen prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ky Program paraqet një nivel më intensiv të mbështetjes prindërore. *Kujdesi për një fëmijë me aftësi të kufizuara, shëndeti mendor i prindërve, stresi i prindërve, mospranimi i fëmijës dhe roli i prindërve* janë vetëm disa nga arsyet që cenojnë aftësitë e tyre për të krijuar një mjedisi stimulues për mësimin dhe zhvillimin e fëmijës. Krahas kërkesave normale që imponon prindërimi, familjet që rritin një fëmijë me aftësi të kufizuara ose me sëmundje kronike përballen me një sërë detyrash specifike shtesë që burojnë nga gjendja shëndetësore e fëmijës.

Duke u nisur nga rëndësia e *marrëdhënieve dhe kujdesit cilësor për fëmijën*, ky Program thekson fuqimisht rëndësinë e mundësive të të mësuarit në moshë të re, ofron mundësi për të luajtur, për të folur dhe lexuar me fëmijën, për të marrë pjesë në rutinat familjare, në aktivitete shtëpiake dhe familjare si dhe sigurimin e qasjes dhe përfshirjes në programet e mësimin të hershëm (edukim parashkollor dhe arsim).

Si koncept, ai përmban një grup masash që ndërmerren me një qëllim – nxitjen e të mësuarit dhe zhvillimit në shtëpi, përmes krijimit të një mjedisi stimulues. Një mjedis i tillë përveç atij fizik (hapësirë, kohë, lodra, materiale) përmban edhe një komponent më pak të dukshëm, por më të rëndësishëm, përkatësisht marrëdhëniet cilësore në relacion prind-fëmijë sepse marrëdhëniet janë themeli i zhvillimit. Këto masa përfshijnë strategji të ndryshme të mbështetjes së prindërve që *avancojnë njohuritë dhe aftësitë e prindërve* për rëndësinë e një mjedisi stimulues në shtëpi, *mbështesin mësimin dhe zhvillimin e fëmijës në shtëpi* (duke mësuar rreth rutinave dhe të mësuarit përmes lojës) dhe ndërtojnë një rrjet për të mbështetur *mirëqenien emocionale të prindërve në kontekstin e kujdesit të fëmijëve me aftësi të kufizuara*. Çdo familje ka rutina, rite, kohë të lirë, prandaj programi është krijuar si një qasje që synon të mbështesë prindërit e fëmijëve me

aftësi të kufizuara për të krijuar një mjedis stimulues në shtëpi për zhvillimin e fëmijës në të gjitha fushat (konjitive/njohëse, emocionale, shoqërore, motorike dhe të folurit).

Programi promovon fokusimin në marrëdhëniet dhe mbështetjen e përfshirjes së të dy prindërve në kujdesin e fëmijës. Shpeshherë, nënat kujdesen për një fëmijë me aftësi të kufizuara dhe meqenëse është e vështirë të gjendet ndihma adekuatë në kujdesin e fëmijës, një numër i madh i tyre pushojnë së punuari pas lindjes së një fëmije me aftësi të kufizuara dhe angazhimi i tyre është i fokusuar kryesisht për kujdesin ndaj fëmijëve (Krstić, 2013). Përfshirja e të dy prindërve në kujdesin e fëmijës ka efekte pozitive si në zhvillimin dhe të nxënit e fëmijës ashtu edhe në ndërtimin e aftësive prindërore të të dy prindërve. Përfshirja e babait është e rëndësishme në kontekstin e kujdesit për një fëmijë me aftësi të kufizuara dhe kërkon mbështetje për aleancë të prindërve. Mënyrat e mbështetjes në raport nënë-baba mund të jenë respektimi i nevojave emocionale të të dy prindërve, përfshirja më e madhe e babait në konsultim me profesionistët, kujdesi afatshkurtër dhe mbështetja në shtëpi në detyrat e përditshme dhe ndihma për disa nga problemet specifike të fëmijës (Bresford et al., 2007).

3.1. Për kë është ky program?

Prindërit (nënat dhe baballarët) e fëmijëve me pengesa në zhvillim - të zotërojnë strategji për kapërcimin e stresit të prindërve, të kujdesen për shëndetin e tyre mendor, të lidhen me prindër të tjerë që kanë përvoja të ngjashme, të kuptojnë dëmin e ndëshkimit fizik, të zhvillojnë aftësitë e pranimit dhe pjesëmarrjes së fëmijës, të jenë në gjendje të krijojnë një mjedis stimulues për mësimin dhe zhvillimin e fëmijës në shtëpi nëpërmjet rutinave dhe lojës, në mënyrë që të përfshihen në mënyrë më aktive në vendimmarrje, në strategjitë e mbështetjes së fëmijëve dhe në jetën dhe punën e kopshtit;

Prindërit e fëmijëve me zhvillim optimal - të zhvillojnë ndjeshmërinë ndaj diversitetit dhe të kuptojnë perspektivën dhe sfidat e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara; si partnerë të kopshtit për të kontribuar në zhvillimin e një mjedisi që siguron pjesëmarrjen dhe përfshirjen e çdo fëmije dhe prindi;

Komunitetin lokal - që të promovohet gjithëpërfshirja dhe toleranca si vlera të komunitetit dhe të ndërtohet mbështetje sociale për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara bazuar në burimet ekzistuese dhe të zhvilluara më tej në komunitet.

4. Programi i punëtorive për prindër

4.1. Qëllimi i programit dhe rezultatet për prindërit – ngritja e kapaciteteve të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të zhvilluar një mjedis stimulues për zhvillimin dhe mësimin e fëmijëve.

Në punëtori, prindërit do të kenë mundësinë të:

- Rishqyrtojnë praktikat e tyre prindërore
- Shkëmbejnë përvoja me prindërit
- Mësojnë nga njëri-tjetri
- Lidhen me ndjenjën e përkatësisë dhe pranimit
- Komunikojnë hapur dhe përfshihen aktivisht në jetën e kopshtit
- Fitojnë aftësi prindërore pozitive
- Fitojnë aftësi për strategji jo të dhunshme
- Kujdesen për veten
- Përvetësojnë strategji për tejkalimin e stresit prindëror
- Kuptojnë rëndësinë e “ndarjes” së kujdesit dhe pjesëmarrjes së babait

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara pritet të:

- Ndihen më të suksesshëm dhe më kompetent në rolin e prindërve (pranimi i vetes si prind kompetent, stres më të ulët të prindërve, ndryshime në marrëdhëniet me fëmijën, ndryshime në sjelljen e fëmijës, vetërregullim më të mirë të zemërimit, strategji më pak të papranueshme të prindërimit, njohje të pikave të forta dhe shkathtësive të veta)
- Njohin se çfarë është një mjedis stimulues dhe kujdes cilësor në kontekstin e aftësive të kufizuara (zhvillojnë aftësi për pranimin dhe pjesëmarrjen e fëmijës)
- Ndihen të respektuar dhe kompetent në kopsht
- Ndihen të mbështetur në komunitet (të informuar për burimet, përfshihet familja më e gjerë)
- Zhvillojnë vetëbesimin (strategji të pa dhunshme, strategji të përballimit të stresit, kujdes ndaj shëndetit mendor)
- Kalojnë më shumë kohë me fëmijën përmes aktiviteteve argëtuese (lojë, lexim, biseda, rutina familjare)
- Njohin pikat e tyre të forta dhe pikat e forta të familjes

4.2. Grupi i synuar - Ky program është i destinuar për prindërit (nënat, baballarët, kujdestarët ligjor, prindërit kujdestarë dhe prindërit birësues) të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

4.3. Thirrja e prindërve në trajnim - prindërit mund të ftohen në trajnim përmes komunikimit me gojë dhe me shkrim, afishe, fletëpalosje, përmes grupeve në Viber, duke postuar thirrje në faqen e internetit të kopshtit, përmes takimeve me prindër, duke përdorur burimet e informacionit në komunitetin lokal. Nëse ka nevojë, është e dëshirueshme që gjatë punëtorive të sigurohet kujdes për fëmijët në kopsht. Thelbi i punëtorive për prindërit është përqendrimi në arritjen e objektivit dhe përmbajtjes së seminarit duke ndërtuar një atmosferë pozitive përmes respektit dhe përkatësisë.

4.4. Struktura e trajnimit

Temat e punëtorisë janë:

11. Udhëtimi ynë

12. Fotografia e fëmijës tim

13. Babi dhe mami

14. A ka dalë dajaku nga parajsja?

15. Kujdesemi për prindin – kujdesemi për fëmijën

Të pesë punëtoritë kanë një ecuri kuptimplotë drejt arritjes së qëllimit të caktuar dhe nuk mund të realizohen individualisht apo në ndonjë mënyrë tjetër. Përgatitja e çiftit prindëror nënkupton zotërimin e njohurive dhe aftësive për prindërim pozitiv, ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësi së përbashkët për rezultatin dhe arritjen e qëllimit. Është mirë të ndërrohen drejtuesit e punëtorive sepse sjell dinamizëm në punë. Është e pëlqyeshme që raporti i punëtorisë të përpiqet menjëherë pas zbatimit të saj. Hapësira duhet të jetë e këndshme, mjaft e madhe. Numri i prindërve në punëtori nuk duhet të kalojë 15; mënyra e realizimit është një herë në muaj në një kohë për të cilën do të biem dakord së bashku me prindërit. Punëtoritë nuk duhet të zgjasin më shumë se 1.5 orë.

Struktura e punëtorisë përfshin:

Pjesën hyrëse – njohja me njëri-tjetrin, njohja me temën dhe qëllimin e punëtorisë, marrëveshje e përbashkët për rregullat e punës (pauzat, përdorimi i celularit, marrja e fjalës, leja për të bërë fotografi, etj.), si p.sh., rregullat për respekt të ndërsjellë, duke dëgjuar të tjerët, etj.

Pjesën qendrore

- Prezantim i shkurtër profesional (kontribut ose prezantim me shkrim)
- Lojëra me role
- Aktivitete dhe ushtrime (shpesh me një fletë pune ose me shkrim)
- Shkëmbim përvojash, reflektim, diskutim në nivel grupi ose në grupe më të vogla (dyshe, treshe, katërshe)

Pjesa e fundit përfshin një lojë relaksimi ose një aktivitet për të përmbyllur temën dhe për të dhënë *detyra shtëpie* me të cilat do të fillojë punëtorja e ardhshme. Nuk duhet këmbëngulur që të gjithë të "provojnë" në shtëpi aftësitë e përvetësuara, por është e dëshirueshme që gjatë pesë punëtorive të gjithë të kenë mundësinë në nivel të të gjithë grupit të paraqesin njohuritë dhe mësimet e tyre për fëmijën.

4.5. Vlerësimi - në fund të ciklit prej pesë punëtorish, prindërve u jepet një Fletë Vlerësimi e përpiluar me qëllim të vlerësimit të efekteve të seminarit. Për çiftin drejtues është përgatitur një fletë vlerësimi më vete. Të dyja metodat e vlerësimit do të jenë në formën e një shkalle vlerësimi dhe do të përpunohen në mënyrë sasimore që Programi të përmirësohet më tej në bazë të rezultateve të pranuar.

4.6. Shpërndarja/diseminimi i programit nënkupton krijimin e një bërthame në kopsht që do të jetë model për përhapjen e programit në kopshte të tjera që nuk kanë marrë pjesë në trajnimin e parë. Bashkëpunëtorët profesionistë nga kopshtet e tjera përmes vizitave dhe shkëmbimeve horizontale do të kenë mundësinë të zbatojnë programin në kopshtet e tyre, duke respektuar kontekstin dhe kulturën e kopshtit.

4.7. Rekomandim

- Programi "Historia jonë", Qendra për mbështetje të zhvillimit të hershëm dhe marrëdhënieve familjare "Harmonia" Novi Sad
- Programi "Na vizitoni", Qendra për mbështetje të zhvillimit të hershëm dhe marrëdhënieve familjare "Harmonia" Novi Sad

| | |
|---------------------------------|--|
| Tema 1. | Udhëtimi ynë |
| Qëllimi | Të kuptuarit e ndryshimeve dhe mënyrat e përshtatjes ndaj ndryshimeve |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 1: "Mirëserdhët në Kanada!" - për të gjithë • letër e madhe – 1 • markerë – 1 • shirit ngjitës – 1 • top i vogël – 1 |
| Aktiviteti hyrës (20 min.) | <p>Trajneri dhe pjesëmarrësit ulen në rreth. Trajneri prezantohet dhe falënderon pjesëmarrësit për praninë e tyre. Më pas ai shpjegon shkurt programin me qëllimet e tij dhe si planifikohet të funksionojë (sa punëtori, kohëzgjatja e tyre, metodat e punës, çfarë dinamike të takimeve).</p> <p>Pastaj, së bashku bien dakord për rregullat që do të vlejnjë për të gjitha punëtoritë për të siguruar punë të suksesshme dhe një ndjenjë të mirë për të gjithë pjesëmarrësit (arritja në kohë, pjesëmarrja aktive në aktivitete, shprehja e lirë e mendimit, respektimi i mendimit të të tjerëve, përdorimi i telefonave celularë, shkrepja e fotografive...) dhe të njëjtat shkruhen shkurtimisht në një copë letre të madhe që do të ngjitet në një vend të dukshëm në dhomë.</p> <p>Pastaj, të gjithë qëndrojnë në rreth. Në një sinjal të caktuar, njëri fillon duke ia kaluar topin e vogël tjetrit duke thënë njëkohësisht emrin e tij dhe kështu me radhë derisa të kthehet tek ai që filloi aktivitetin pa rënë topi në tokë. Gjatë kësaj kohe, trajneri mat kohën. Aktiviteti përsëritet disa herë në përpjekje për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm për të gjithë grupin.</p> |
| Aktiviteti kryesor (30 min.) | <p>Të gjithë ulen në rreth. Trajneri fillon një bisedë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kujtojeni shtatzëninë – që nga momenti kur e morët vesh, gjatë nëntë muajve e deri në lindje. Për çfarë po mendonit, çfarë po blinit, çfarë po planifikonit? 2. Kush ishte me ju, kush ju jepte mbështetje? <p>Pastaj të gjithë marrin nga një FP 1 dhe e lexojnë atë.</p> |
| Diskutim (20 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Cila do të ishte gjëja e parë që do të bënit në Kanada? 2. Cila përvojë e mëparshme e juaja do t'ju ndihmonte? Cilat janë aftësitë tuaja? Çfarë njohurie keni? 3. Kush do t'ju ndihmonte nga familja? Si? 4. Besoni se do të kishit sukses? |
| Aktiviteti përmbyllës (10 min.) | Të gjithë qëndrojnë në rreth dhe një nga një tregojnë se çfarë ndjenjash kanë pasur gjatë punëtorisë |
| Detyra shtëpie (10 min.) | Të gjithë marrin Fletën e punës 1 me vete, kështu që kudo në atë tregimi zëvendësojnë fjalën "Kanada" me emrin e fëmijës së tyre. |

| | |
|------------------------|--|
| Tema 2. | Fotografia e fëmijës tim |
| Qëllimi | Ri-mendimi i bindjeve tona ndaj fëmijës |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 2: "Bingo" – për të gjithë • FP 3: "Fotografia e fëmijës tim" – për të gjithë • FP 4: "Përshkrimi i fëmijës tim" – për të gjithë • vegla shkrimi – për të gjithë • bojëra – për të gjithë |

| | |
|--|---|
| <p>Aktiviteti hyrës (20 min.)</p> | <p>Trajneri i mirëpret pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe shpalos temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë ulen në rreth. Pastaj të gjithë marrin FP 2 dhe e plotësojnë atë në mënyrë të pavarur. Kur të gjithë të kenë mbaruar, çohen në këmbë dhe në një shenjë të caktuar kërkojnë shpejt dikë me një përgjigje të ndryshme nga ajo e tyre në një fushë të caktuar, kështu që personi tjetër nënshkruhet në atë fushë. I njëjti pjesëmarrës mund të nënshkruajë fletën e dikujt tjetër vetëm dy herë. Pasi të mblidh një nënshkrim, kërkohet shpejt nënshkrimi tjetër për një fushë tjetër. Sa herë që dikush mbledh nënshkrime në një kolonë (horizontale, vertikale ose diagonale), bërtet me zë të lartë "Bingo!"</p> <p>Pas rreth dhjetë minutash, loja ndalet dhe zhvillohet një diskutim i shkurtër:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kush i ka të gjitha 16 bingot (15, 14... dhe në renditje zbritëse) 2. Cila ishte gjëja më e lehtë për ju që të gjenit dikë që të nënshkruante për ju? Dhe cila ishte më e vështira për ju? |
| <p>Aktiviteti kryesor (40 min.)</p> | <p>Të gjithë ulen në rreth. Të gjithë marrin fletën e punës FP 3 dhe në mënyrë të pavarur e vizatojnë fëmijën e tyre, ndërsa nën foto shkruajnë një mesazh të shkurtër inkurajues ose motivues drejtuar fëmijës në fjalim të drejtpërdrejtë, me të cilin duan të mbështesin udhëtimin e tyre nëpër jetë. Pastaj një nga një i prezantojnë vizatimin të tjerëve duke thënë: "Ky është ... (emri i fëmijës)" dhe lexon mesazhin.</p> <p>Pastaj, secili merr një FP 4 dhe e plotëson në mënyrë të pavarur duke shkruar në fushën përkatëse atë që fëmijës së tyre nuk i pëlqen/nuk i pëlqen të shohë, dëgjojë, flasë/thotë, të bëjë, por edhe atë që e bën të trishtuar, të frikësuar dhe të lumtur. Më pas, në çifte, ndajnë atë që është shkruar fillimisht për njërin pjesë dhe më pas kalojnë në pjesën tjetër.</p> |
| <p>Diskutim (10 min.)</p> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë mendoni, si i përcakton fotografia e fëmijës pritshmëritë tuaja prej tij 2. Si e përcaktojnë ato pritshmëri sjelljen tuaj ndaj tij? |
| <p>Aktiviteti përmbyllës (15 min.)</p> | <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth, por pranë atij me të cilin kanë punuar më parë në çift. Një nga një në çifte i dërgojnë njëri-tjetrit një mesazh të shkurtër pozitiv lidhur me atë që kanë vënë re deri tani tek tjetri personalisht ose çfarë është shkruar dhe shkëmbyer gjatë punës në FP 4. Të tjerët dëgjojnë me vëmendje dhe duartrokasin pas çdo mesazhi.</p> |
| <p>Detyra shtëpie (5 min.)</p> | <p>Prindërve u jepen detyra shtëpie për të çuar në shtëpi fotografinë që i bënë fëmijës.</p> |

| | |
|---------------------------------------|--|
| <p>Tema 3.</p> | <p>Babi dhe mami</p> |
| <p>Qëllimi</p> | <p>Të kuptuarit e rëndësisë së përfshirjes së baballarëve në kujdesin e fëmijëve</p> |
| <p>Materialet e nevojshme</p> | <ul style="list-style-type: none"> • letër – për çdo grup të vogël • vegla shkrimi – për çdo grup të vogël |
| <p>Aktiviteti hyrës (20 min.)</p> | <p>Trajneri i mirëpret pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe shpalos temën e punëtorisë.</p> |

| | |
|--------------------------------|---|
| | <p>Të gjithë ulen në rreth. Trajneri drejton një bisedë për të shkëmbyer përvoja me të gjithë grupin në lidhje me detyrat e shtëpisë nga punëtorja e mëparshme.</p> <p>Pastaj të gjithë qëndrojnë në rreth. Njëri fillon duke thënë: "Babi!" njëkohësisht kthen kokën djathtas. Kjo është një shenjë që personi të cilit i drejtohet me atë fjalë duhet ta përcjellë më tutje në të njëjtën mënyrë. Secili ka të drejtë të thotë një herë në aktivitet: "Shkrip!" që është sinjali për të filluar të thonë fjalën "Mami!" që përcillet më tej në drejtim të kundërt derisa dikush të thotë përsëri: "Shkrip!", dhe përsëri të ndërrohet fjala dhe drejtimi kujt i përcillet ajo fjalë. Aktiviteti përfundon kur të gjithë në rreth e kanë përdorur një herë fjalën "Shkrip!" dhe kur e njëjta fjalë të jetë përcjellë në të gjithë rrethin.</p> |
| Aktiviteti kryesor (50 min.) | <p>Të gjithë ndahen në grupe të vogla. Gjysmës së grupeve u caktohet detyrë që të përshkruajnë (dhe të shkruajnë si tregim) një nënë stereotipike dhe çfarë bën ajo zakonisht (çfarë aktiviteteve tipike ajo ndërmerr) që ndërlidhen me kujdesin dhe zhvillimin e fëmijës që nga lindja deri në regjistrimin në shkollë dhe çdo fjali ta filloje me "Ajo...". Gjysma tjetër e grupeve punojnë në të njëjtën mënyrë, por përshkruajnë një baba stereotipik, duke filluar çdo fjalë me "Ai". Disa aktivitete të mundshme që mund të përfshihen në përshkrim mund të jenë: përgatitja e një vakti, ushqyerja, mësimi i fëmijës për të ngrënë në mënyrë të pavarur, ndërrimi i pelenave, ndërrimi i rrobave, çuarja në kopsht, loja, mësimi i ecjes, ngasja e biçikletës, mbajtja në dorë e një shkumësi me ngjyrë...). Më pas secili grup lexon tregimin e tij siç është shkruar.</p> <p>Pastaj, secili grup lexon tregimin e njëjtë, por duke e zëvendësuar fjalën "ajo" me "ai" kudo dhe anasjelltas.</p> |
| Diskutim (10 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 6. Si ju dukën historitë e shtrembëruara? Pse? 7. Pse zakonisht nënat përfshihen në disa aktivitete dhe baballarët në aktivitete të tjera? 8. A ka dallime reale në aftësitë e tyre për kujdesin ndaj fëmijëve?? 9. Si do të ishte ideale? Kur do të ndiheshin më bukur fëmijët? Pse? Nëse do të zhvilloheshin më shumë? 10. Si mund ta ndihmojnë prindërit njëri-tjetrin në përfshirjen e ndërsjellë në aktivitete dhe në shpërndarjen e tyre të barabartë? Çfarë do të përfitonin edhe ata nga një prindërim i tillë i përbashkët? |
| Aktiviteti përmbyllës (5 min.) | <p>Të gjithë ndahen në çifte. Njëri nga çifti fillon me pantonimë të bëjë aktivitete të ndryshme shtëpiake, ndërsa tjetri e imiton atë. Pas pak, rolet ndryshojnë.</p> |
| Detyra shtëpie (5 min.) | <p>Prindërve u jepet për detyrë të ndajnë përvojat e fëmijërisë me partnerin e tyre ose një person tjetër të rëndësishëm rreth asaj se sa të përfshirë ishin baballarët e tyre në kujdesin për ta kur ata ishin fëmijë.</p> |

| | |
|---------|--------------------------------|
| Tema 4. | A ka dalë dajaku nga parajsja? |
|---------|--------------------------------|

| | |
|---------------------------------|---|
| Qëllimi | Përvetësimi i strategjive për edukim pa dhunë |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 5: „Dënimi fizik kundrejt prindërimit pozitiv“ - për secilin • FP 6: “Çfarë në vend të dënimit fizik?” – për secilin • letër e madhe - për secilin grup të vogël • vegla shkrimi – për secilin • bojëra - për secilin grup të vogël • shirit ngjitës - 1 |
| Aktiviteti hyrës (20 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e shpalos temën e punëtorisë. Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Trajneri nis bisedë për këmbim të përvojave me tërë grupin lidhur me detyrën e shtëpisë nga punëtorja paraprake.</p> <p>Pastaj çdokujt i jepet FP 5, ndërsa trajneri para të gjithëve e prezanton përmbajtjen e vizatimit për arsyet e dënimit fizik.</p> <p>Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla, dhe secili u përgjigjet pyetjeve në FP, pas së cilës një grup në rreth lexon një nga një ato që janë shkruar derisa të shterohen të gjitha përgjigjet e pyetjes së parë dhe më pas të pyetjes së dytë. Ndërkohë, të tjerët dëgjojnë me vëmendje që të mos ketë përsëritje.</p> <p>Disa nga përgjigjet e mundshme të pranueshme janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 3. I keqkuptuar, rebel, i frikësuar, i padëshiruar, gabim, i lënduar... 4. Sjellja ndryshon vetëm për momentin sepse nuk ka përmbajtje që do t'i tregojë fëmijës se si të veprojnë ndryshe në të ardhmen. <p>Pastaj trajneri e prezanton edhe pjesën e dytë të FP-së së njëjtë për prindërim pozitiv.</p> |
| Aktiviteti kryesor (20 min.) | Çdokujt i jepet FP 6 dhe u përgjigjet kërkesave në të. Pastaj për çdonjërin kërkesë lexohen nga disa përgjigje nga ana e vullnetarëve dhe analizohen me qëllim të fitohen ata që janë të dëshirueshme. |
| Aktiviteti përmbyllës (15 min.) | Të gjithë ndahen në grupe të vogla, pastaj çdonjëri harton nga një afishe me temë: “Ndal dënimit fizik të fëmijëve”. Në fund, çdo grup e prezanton afishen e vetë para të tjerëve e pastaj ata varen në vend të dukshëm në sallë. |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërve u jepet detyrë shtëpie që në takimin e radhës të sjellin batanije apo shall të fëmijës, e cila ka ndonjë kuptim të veçantë. |

| | |
|----------------------------|---|
| Tema 5. | Kujdesemi për prindin – kujdesemi për fëmijën |
| Qëllimi | Forcimi i vetëdijes së prindërve për rëndësinë e kujdesit për veten në kontekst të prindërimit |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • shalle dhe batanije nga fëmijët (të sjella nga pjesëmarrësit) • karrige – më tepër (në varësi nga hapësira) |
| Aktiviteti hyrës (15 min.) | <p>Trajneri i përshëndet pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe e shpalos temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Çdokush shkurtimisht rrëfen kush ia ka dhënë emrin dhe çfarë domethënie ka ai.</p> |

| | |
|------------------------------------|---|
| Aktiviteti kryesor (30 min.) | Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth dhe mbulohen me shallin ose batanijen që kanë sjellë, pastaj një nga një ata tregojnë historinë duke i përfshirë pyetjet e mëposhtme: 5. Si mbërriti ajo batanije/shall në shtëpinë tuaj? 6. Për çfarë përdoret shalli/batanija? 7. Çfarë kujtimesh keni me atë? 8. Çfarë ndjenjash ju zgjon? |
| Diskutim (20 min.) | 4. Çfarë do të thotë për foshnjën kur e mbështjell/mbulon me një shall/batanije?? 5. Kush është "manteli juaj mbështetës" në prindërimin tuaj në të tashmen? Si? 6. Sa dhe pse është e rëndësishme kjo për ju? |
| Aktiviteti përmbyllës (20 min.) | Të gjithë ndahen në çifte. Njërit në çift i mbyllen sytë me shallin/batanijen e tij dhe tjetri e merr për dore dhe e çon në mënyrë të sigurt përmes një rreshti karrigesh të cilat duhet të kalohen në mënyrë zigzag. Më pas rolet ndryshojnë. |
| Detyra shtëpie (5 min.) | Prindërve u jepet detyrë shtëpie të mendojnë se për kë janë ata një batanije mbështetëse në familje. |
| | Prindërve u jepet fletë për vlerësim dhe certifikatë. |

5. Fletë pune

Fletë pune (FP) 1: Mirë se vini në Kanada!

Është korrik. Jeni me pushime dhe po udhëtoni për në Australi. Ju prisni që gjithçka të jetë ndryshe, po prisni me padurim, jeni duke u përgatitur për të për një kohë të gjatë. E gjithë familja mezi e pret atë ngjarje, të gjithë janë të emocionuar, të paduruar. Prej kohësh i keni blerë të gjitha gjërat e nevojshme, i keni paketuar. Valixhet i keni bërë gati, gjithçka që ju nevojitet është në to. Keni planifikuar Australinë për një kohë të gjatë. Pas shkollës dhe martesës, vetëm Australia ishte në mendjen tuaj. Ju e dini se do të keni sukses dhe edhe nëse përballeni me disa sfida, të gjithë do t'ju ndihmojnë. Kur të mbërrini në Australi, do të shihni të gjitha sfidat, por edhe të gjitha mundësitë. Mbase nuk do të jeni në gjendje të bëni gjithçka që keni dashur të bëni deri tani, nuk do të keni kohë të mjaftueshme, por megjithatë Australia është ëndrra juaj.


Aeroplani ulet, ju zbrisni dhe ndjeni se gjithçka është disi ndryshe, keni ftohtë dhe jeni shumë të pasigurt. Të thonë që keni zbritur në Kanada. Ju shpjegoni se keni hipur në një avion për në Australi, se po shkoni atje, por askush nuk ju dëgjon. Të gjithë ju buzëqeshin dhe ju thonë se gjithçka do të jetë mirë. Burri/gruaja ju shikon me habi dhe ai/ajo nuk e beson këtë, pyet se ku keni gabuar. Njerëzit përreth shpejtojnë diku, askush nuk ka një shpjegim se çfarë ka ndodhur. Ata po ju thërrasin për t'ju uruar për mbërritjen tuaj në Australi. Nuk dini t'i shpjegoni, nuk ju pëlqejnë thirrjet e tyre. Ju vjen të qani, të bërtisni. Pastaj shikon përreth, e shihni Kanadanë dhe kuptoni që është një vend i bukur. Nuk është aq nxehtë sa Australia, por është një vend shumë i bukur, i gjithi i bardhë dhe me shkëlqim. Ka fuqi magjike për t'ju mbajtur aty, të gëzuar dhe të qetë. Në Kanada nuk mund të marrësh reze dielli, por mund të luash gjithë ditën në dëborë. Nuk mund t'i shihni kangurët, por prandaj ka drerë brilopatë. Mund të arrini gjithçka që keni ëndërruar, por duhet të ndryshoni mënyrën se si shijoni Kanadanë. Së pari do të zotëroni gjuhën. Kjo është arsyeja pse duhet të lidheni me Kanadanë, të kuptoni atë që ju flet dhe ta pranoni atë vend siç është, me të gjitha pikat e forta dhe të dobëta. Kanadaja do të bëhet familja juaj sepse ju jeni të zotët.

Mirë se vini në Kanada!


FP 2: Bingo

| | | | |
|---|---|--|---|
| ju pëlqen të zgjoheni herët (po ose jo) _____ | keni vëlla/motër (po ose jo) _____ | festa më e rëndësishme në familje _____ | rrjeti social që përdorni më së shumti _____ |
| ushqimi që hani më shpesh _____ | ndiqni politikën (po ose jo) _____ | pini kafe me fqinjët (po ose jo) _____ | shenja në horoskop _____ |
| detyra e shtëpisë që e urreni më së shumti _____ | jetoni në shtëpi apo banesë _____ | aktiviteti i preferuar në kohë të lirë _____ | lloji i preferuar i muzikës _____ |
| ajo që ju mërzit më shumë tek njerëzit _____ | shtetin që dëshironi të vizitoni _____ | paratë nga “java e lotarisë” do ti shpenzonit për _____ | më shumë gëzoheni kur _____ |

FP 3: Fotografia e fëmijës tim





FP 4: Përshkrimi i fëmijës tim



FP 5: Ndëshkimi trupor kundrejt prindërimit pozitiv

1. Si ndihet fëmija kur ndëshkohet fizikisht?

2. A e mëson ndëshkimi fizik fëmijën se si të sillet saktë në të ardhmen dhe të mos përsëris sjelljen për të cilën është dënuar? Pse?



FP 6: Çfarë duhet në vend të ndëshkimit fizik?

Është koha për të fjetur. Lodrat janë shpërndarë kudo nëpër dhomë, pavarësisht se tashmë i keni thënë disa herë fëmijës t'i mbledh. Fëmija refuzon t'i vendosë ato në vend. Si mund ta drejtoni me sukses fëmijën në këtë situatë në vend që të ndëshkohet fizikisht?

7. Bëjini të qartë se jeni të zemëruar, përshkruani se cili është problemi dhe sulmoni atë (shpjegoni pasojat që mund të ndodhin për shkak të problemit), jo fëmijën!

8. Bëjini të qarta pritshmëritë tuaja!

9. Tregoni se si mund të zgjidhet problemi tani ose në të ardhmen (mund të futet edhe loja mandej)!

10. Ofroni zgjedhje!

11. (nëse sjellja e padëshiruar vazhdon) Paralajmëroni fëmijën për atë që do të pasojë (pasojë e natyrshme e sjelljes, por assesi ndëshkim fizik)!

12. Nëse sjellja e padëshiruar vazhdon, jini këmbëngulës për atë që u tha më parë.

FP 10: Çfarë duhet në vend të ndëshkimit fizik? - përgjigje

Është koha për të fjetur. Lodrat janë shpërndarë kudo nëpër dhomë, pavarësisht se tashmë i keni thënë disa herë fëmijës t'i mbledh. Fëmija refuzon t'i vendosë ato në vend. Si mund ta drejtoni me sukses fëmijën në këtë situatë në vend që të ndëshkohet fizikisht?

7. Bëjini të qartë se jeni të zemëruar, përshkruani se cili është problemi dhe sulmoni atë (shpjegoni pasojat që mund të ndodhin për shkak të problemit), jo fëmijën!

Jam shumë i/e zemëruar që po të kërkoj disa herë të mbledhësh lodrat, ndërsa ato janë ende në dysheme, në krevat, në tavolinë. Nëse ato qëndrojnë kështu, dikush mund të pengohet, të shkelë njërën dhe të thyhet, ndërsa nuk mund të shtrihesh rehat në një shtrat plot me lodra.

8. Bëjini të qarta pritshmëritë tuaja!

Është koha për të fjetur dhe duhet t'i vendosësh lodrat në vendet e tyre.

9. Tregoni se si mund të zgjidhet problemi tani ose në të ardhmen (mund të futet edhe loja mandej)!

Mund të luajmë një këngë dhe derisa zgjat kënga – vendos kubet në shportë, librat në raft, shkumësat me bojë në kuti.

10. Ofroni zgjedhje!

Dëshiron së pari t'i heqësh lodrat, pastaj të veshësh pizhamet, apo të veshësh pizhamet së pari dhe më pas të heqësh lodrat?

11. (nëse sjellja e padëshiruar vazhdon) Paralajmëroni fëmijën për atë që do të pasojë (pasojë e natyrshme e sjelljes, por assesi ndëshkim fizik)!

Nëse nuk i vë lodrat në vendin e tyre para se të shkosh në shtrat dhe njëra prej tyre thyhet për shkak të kësaj, nuk do të blejmë një të re këtë muaj. Paratë për këtë janë shpenzuar.

12. Nëse sjellja e padëshiruar vazhdon, jini këmbëngulës për atë që u tha më parë.

**PYETËSOR PËR PRINDËR PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT
“MBËSHTETJE PRINDËRVE ME FËMIJË ME PENGESA NË ZHVILLIM”**

Të nderuar prindër,

Para jush është një pyetësor vlerësimi që është anonim, ndaj ju kërkohet të jepni përgjigje të sinqerta. Përgjigjet do të përdoren ekskluzivisht për vlerësimin dhe përmirësimin e Programit.


Ju lutemi rrethoni një numër në shkallë nga 1 deri në 4 që shpreh më mirë mendimin tuaj për secilin pohim më poshtë.

- 1-Nuk pajtohem*
- 2-pjesërisht pajtohem*
- 3-Shumë pajtohem*
- 4-Plotësisht pajtohem*

Ju falënderojmë paraprakisht!

| | Pohimi | Vlerësimi |
|-----|---|------------------|
| 1. | Programi i përmbushi pritjet e mia | 1 2 3 4 |
| 2. | Punëtoritë më bënë të ri-mendoj prindërimin tim | 1 2 3 4 |
| 3. | Mësova shkathtësi të reja (lidhja, monitorimi, pranimi) | 1 2 3 4 |
| 4. | Shkëmbeva përvoja me prindër të tjerë | 1 2 3 4 |
| 5. | U ndjeva rehat dhe e pranuar nga të tjerët në punëtoritë | 1 2 3 4 |
| 6. | Tashmë fotografia për fëmijën tim është ndryshe | 1 2 3 4 |
| 7. | Tani lexoj më shpesh me fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 8. | Tani e kam të qartë se si të inkurajoj mësimin dhe zhvillimin e fëmijës tim në shtëpi | 1 2 3 4 |
| 9. | Të dashurit e mi shohin një ndryshim | 1 2 3 4 |
| 10. | Ndjej se jam një prind më i suksesshëm | 1 2 3 4 |
| 11. | I identifikoj më mirë nevojat e fëmijës tim | 1 2 3 4 |
| 12. | Luaj më shpesh me fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 13. | Vërej pika të forta tek fëmija im që nuk i njihja më parë | 1 2 3 4 |
| 14. | Fëmija im po sheh një ndryshim | 1 2 3 4 |
| 15. | Di se si stresi ndikon në prindërimin tim | 1 2 3 4 |
| 16. | Kur bëj diçka në shtëpi, di si ta përfshij fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 17. | E kuptova dëmin e ndëshkimit fizik | 1 2 3 4 |
| 18. | I vërej pikat e mia të forta dhe pikat e forta të familjes sonë | 1 2 3 4 |
| 19. | E njoh rëndësinë që të dy prindërit të kujdesen për fëmijën | 1 2 3 4 |
| 20. | Mendoj se si të kujdesem për veten si prind | 1 2 3 4 |
| 21. | Di se çfarë është zhvillimi i hershëm i fëmijës dhe pse është i rëndësishëm | 1 2 3 4 |
| 22. | Si prind kam më shumë vetëbesim | 1 2 3 4 |
| 23. | Në vendim tim, ekzistojnë shumë njerëz dhe burime në të cilat mund të mbështetem | 1 2 3 4 |

Gjithsej, në sa punëtori keni marrë pjesë? -----



PROGRAM SPECIFIK PËR MBËSHTETJE TË PRINDËRVE TË FËMIJËVE NGA MJEDISE TË NDRYSHME SHUMËKULTURORE



1.Hyrje

Multikulturalizmi është një tipar i kohëve moderne që kërkon delikatesë në krijimin e çdo aspekti të politikave arsimore, e për rrjedhojë të arsimit parashkollor, në mënyrë që të ruhet autenticiteti i një kulture të caktuar. Familjet ndryshojnë nga njëra-tjetra në shumë karakteristika, si dhe në kulturat e tyre familjare dhe kjo ndikon në përvojat e fëmijës. Gjatë zgjedhjes së mënyrave të përshtatshme të mbështetjes për prindërit, është e nevojshme të respektohen dallimet kulturore në lidhje me pushtetin, punën/punësimin, qëndrimin ndaj kopshtit, qëndrimin ndaj fëmijërisë, përvojat shoqërore, vlerat dhe mënyrat e disiplinimit (Stacy Jork, 2003).

Programi specifik për mbështetjen e prindërve të fëmijëve nga mjedisë të ndryshme shumë-kulturore (në tekstin e mëtejshëm: Programi) është konceptuar në bazë të programit prindëror pozitiv të Programit të Mbështetjes së Familjes për mësimin dhe zhvillimin në shtëpi dhe përmban të njëjtat pikënisje, vlera themelore dhe synime të perceptuar përmes prizmit të prindërimit në një mjedis shumë-kulturore që respekton specifikat e secilës kulturë të pranishme në Maqedoninë e Veriut (maqedonas, shqiptarë, rom, turq, serb, etj.). Pjesëmarrja e familjes në kopsht nënkupton shumë më tepër sesa pjesëmarrja në ngjarjet dhe aktivitetet e ndryshme në kopsht. Prindërit janë "mësuesit e parë" të fëmijës, ndaj është i rëndësishëm partneriteti me prindërit që fëmijët të mos zgjedhin mes kulturës së kopshtit dhe kulturës së familjes. Të mësuarit për kulturën e çdo fëmije forcon kompetencën e bashkëpunëtorit profesional dhe kontribuon për kuptimin e specifikës dhe përshtatjes së programit për çdo fëmijë, ndërsa kjo zhvillon te fëmijët një ndjenjë pranimi dhe përkatësie dhe parandalon përjashtimin social. Qëndrimet dhe bindjet e të rriturve shpesh ngjyrosen nga paragjykimet që jo vetëm ulin pritshmëritë nga fëmijët, por edhe zhvlerësojnë rolin dhe kompetencat e prindërve. Përfshirja e secilës familje në planifikimin dhe marrjen e vendimeve në lidhje me fëmijët e tyre, mirëpritja e tyre çdo ditë, përfshirja e prindërve në aktivitete që nxisin mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve, pranimi i nismave prindërore e të tjera, janë mënyra që prindërit të bëhen pjesë e "një komunitetit që mëson". Përveç mundësisë që profesionistët të njohin familjen dhe të mësojnë prej saj, me këtë sigurohet që interesat, njohuritë, vlerat dhe kultura e familjes të jenë pjesë e integruar e procesit mësimor të fëmijëve.

**Mirë se vini në Programin për Mbështetje të Prindërve të Fëmijëve
me Pengesa në Zhvillim!**

2. Bazat teorike të programit

2.1. Marrëdhëniet dhe kujdesi cilësor janë themeli i zhvillimit të fëmijës

Duke u nisur nga rëndësia e **marrëdhënieve dhe kujdesit cilësor për fëmijën**, Programi thekson rëndësinë e krijimit të mundësive për të mësuar në moshë të re, për ofrimin e mundësive për lojë, bisedë dhe lexim me fëmijën, pjesëmarrje në rutinat familjare, aktivitete shtëpiake dhe familjare, si dhe për sigurimin e qasjes dhe përfshirjes në programet e mësimi të hershëm (edukim parashkollor dhe arsim).

Rëndësia e marrëdhënieve prind-fëmijë në fëmijërinë e hershme - Hulumtimet tregojnë se zhvillimi i trurit është kumulativ dhe shumë i ndjeshëm ndaj ndikimeve mjedisore, kështu që përvojat e hershme, mjedisi dhe marrëdhëniet vendosin themelet për zhvillimin e mëvonshëm. Mësimi dhe zhvillimi nuk mund të shihen të veçuar nga mjedisi fizik dhe psikologjik në të cilin **marrëdhëniet** luajnë një rol kyç në të nxënit. Dihet se çdo ndërveprim (pozitiv, negativ ose i munguar) kontribuon në zhvillimin e trurit të fëmijës duke hedhur bazat për të mësuarit e mëvonshëm. Fëmija e përjeton botën përmes marrëdhënieve që krijon dhe zhvillon, ndërsa ato marrëdhënie formojnë dhe përcaktojnë zhvillimin dhe mësimin e tij.

Si ndërtohen marrëdhëniet? Sipas teorisë së lidhjes afektive, lidhja zhvillohet midis prindit dhe fëmijës dhe fillon si një grup sinjalesh të lindura që ftojnë prindërit të vijnë tek fëmija (qarje, buzëqeshje, kontakt vizual, etj.). Me përsëritjen e vazhdueshme të ndërveprimeve (sinjalet dhe përgjigjet e prindërve ndaj tyre), me kalimin e kohës zhvillohet një lidhje afektive, në të cilën kontribuojnë aftësitë njohëse dhe emocionale të fëmijës dhe përvoja e kujdesit të butë dhe të vëmendshëm (Berk, 2008). Provat kërkimore tregojnë se efektet më pozitive për zhvillimin e fëmijës arrihen *nëse marrëdhëniet me fëmijën janë të ngrohta, të kujdesshme, të përgjegjshme dhe të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe karakteristikat e fëmijës* (Shonkoff, Phillips, 2000).

Çfarë është kujdesi cilësor? – Pamja moderne e prindërimit në fushën e zhvillimit të hershëm përmes konceptit të **kujdesit inkurajues**, përcakton komponentët më të rëndësishëm të kujdesit cilësor për fëmijën. Me këtë koncept theksohet se për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, që nga fëmijëria më e hershme, më i rëndësishëm është mjedisi në të cilin kombinohet **kujdesi i vëmendshëm**, që synon nevojat fiziologjike, emocionale dhe sociale të fëmijës, si dhe nevojat e tij për autonomi dhe **kujdes inkurajues**, i cili ofron mundësi mësimi bazuar në eksplorim, lojë dhe pjesëmarrje. Koncepti i kujdesit inkurajues (Britto PR, Lye SJ, Proulx K, et al., 2017) dallon pesë fusha të mjedisit inkurajues që janë të ndërlidhura: kujdesi shëndetësor, kujdesi ndaj të ushqyerit, kujdesi i përgjegjshëm, siguria, mundësitë e të mësuarit në fëmijërinë e hershme. Njëkohësisht, fokusi i prindërve drejt nevojave të fëmijës, aftësia e tij për të vërejtur, njohur, kuptuar dhe për t'iu **përgjigjur** atyre, pra **responsiviteti**, njihet si çelësi i konceptit.

| Aktiviteti kryesor (30 min.) | Trajneri shpjegon shkurt për rëndësinë e leximit për zhvillimin e fëmijës. Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla, kështu që secili merr një FP 10 dhe e plotësojnë atë së bashku. Kur të gjithë të kenë mbaruar, secili grup në rreth lexon me radhë dhe i përgjigjet një pyetjeje. Të tjerët dëgjojnë me kujdes dhe shtojnë vetëm nëse kanë diçka të re. Nëse është e nevojshme, zhvillohet një diskutim se pse janë të rëndësishme disa pikëpamje. |
| Diskutim (15 min.) | 1. Si duket situata gjatë leximit të një libri kur fëmija është dëgjues pasiv dhe si është kur është dëgjues aktiv? Çfarë bën prindi dhe çfarë bën fëmija? 2. Cila situatë e zhvillon fëmijën? Çfarë mesazhesh pranon fëmija atëherë? Si ndihet mandej? |
| Aktiviteti përmbyllës (15 min.) | Të gjithë qëndrojnë në rreth. Trajneri lexon tregimin e fletës së punës FP 11, ndërsa të tjerët duhet të bëjnë një lëvizje të caktuar sa herë që përmendet një fjalë e caktuar në të, p.sh.: • princesha – përkulje • princi – përshëndetje • Olafi – përqaftim |

| | |
|-------------------------------|--|
| Tema 7. | Rutinat në familjen tonë |
| Qëllimi | Të kuptuarit e rutinave si mundësi për mësimin dhe zhvillimin e fëmijës |
| Materialet e nevojshme | <ul style="list-style-type: none"> • FP 12: "Mësimi i fëmijëve përmes pjesëmarrjes në rutinat dhe ritet familjare" - për të gjithë • vegla shkrimi – për çdo grup të vogël • video nr. 2 • laptop dhe projektor – 1 |
| Aktiviteti hyrës (15 min.) | <p>Trajneri i mirëpret pjesëmarrësit, i falënderon për pjesëmarrjen e tyre dhe shpalos temën e punëtorisë.</p> <p>Të gjithë ndahen në treshe dhe qëndrojnë në një hapësirë bosh e të gjerë. Së pari, shpjegohen dy elementët bazë të aktivitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • "shtëpia" - dy persona nga treshja qëndrojnë duke mbajtur njëri-tjetrin me duart e ngritura lart mbi kokë; • "qiramarrësi" - njëri nga treshja qëndron midis atyre që bëjnë "shtëpinë". <p>Pastaj të gjithë treshet e bëjnë figurën e tyre të një "shtëpie" me një "qiramarrës" në të. Ai që fillimisht nuk i përket asnjërës prej treshëve qëndron në mes dhe jep qartë një nga udhëzimet e mëposhtme, të cilat të tjerët duhet t'i zbatojnë shpejt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • "Shtëpitë ndërrojnë qiramarrësit!" – të dy nga secila treshe që bëjnë "shtëpinë" duke u kapur ende për dore, largohen nga "qiramarrësi" që kanë dhe kërkojnë shpejt një "qiramarrës" të ri; gjatë asaj kohe të gjithë ata që janë "qiramarrës" qëndrojnë në vend. |

| | |
|------------------------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • "Qiramarrësit ndërrojnë shtëpi!" – të gjithë "qiramarrësit" largohen nga "shtëpitë" e tyre dhe kërkojnë shpejt një "shtëpi" të re; "shtëpitë" në këtë udhëzim qëndrojnë në vend. • "Tërmet!" – ndahen të gjitha treshet ekzistuese dhe formohen treshë krejtësisht të reja në të cilat dy janë "shtëpi" dhe një "qiramarrës" në atë "shtëpi". <p>Ai që jep udhëzime menjëherë pasi jepet udhëzimi, nxiton të hyjë vetë në një treshë (si "qiramarrës" ose si pjesë e një "shtëpie", në varësi të udhëzimit të dhënë). Ai që nuk do të jetë në asnjë treshë, e ka radhën për të dhënë udhëzime.</p> |
| Aktiviteti kryesor (40 min.) | <p>Të gjithë ulen në rreth. Trajneri paraqet videon nr. 2 si shembull kur rutina është një mundësi për mësimin dhe zhvillimin e fëmijës. Gjatë videos ai shpjegon aftësitë që prindi ka (monitoron sinjalet e fëmijës, vëzhgon ndryshimet, interpreton, u përgjigjet sinjaleve).</p> <p>Pastaj të gjithë marrin nga një FP 12 dhe trajneri prezanton përmbajtjen e vizatimit.</p> <p>Pastaj të gjithë ndahen në grupe të vogla, kështu që gjysma e tyre plotësojnë pjesën e dytë të FP-së për një opsion (bëj banjo), dhe gjysma tjetër - për tjetrën (bëj pazar). Kur të gjithë të kenë mbaruar, grupet një nga një që kanë punuar në të njëjtin opsion, në rreth, lexon nga një nga ato që janë shkruar derisa të shterohen të gjitha përgjigjet. Të tjerët dëgjojnë me kujdes që të mos ketë përsëritje.</p> <p>Disa përgjigje të mundshme të pranueshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • bëj banjo: derdhja, spërkatja, prekja e ujit, prekja e sapunit dhe shkumës, emërtimi i gjërave, mëson renditjen e aktiviteteve, mëson nxehtë-ftohtë, thatë-lagur, mëson të pret, të jetë... • bëj pazar: si planifikohet një pazar, si shkruhet një listë ushqimore, si mëson të mbahen qeset, si mëson aftësitë e komunikimit (të përshëndetjes, të pyes, të përgjigjet...), si maten produktet, si të mbërrijë në mënyrë të sigurt një vend të caktuar... |
| Diskutim (15 min.) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë mëson fëmija nëpërmjet përfshirjes së tij në rutinat dhe ritet familjare? 2. Çfarë mesazhesh pranon fëmija atëherë? Si ndihet mandej? 3. Si e siguron prindi pjesëmarrjen e fëmijës në rutinat dhe ritet familjare? Çfarë përfiton ai prej tyre? |
| Aktiviteti përmbyllës (15 min.) | <p>Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secili me radhë bën një pantomimë për një aktivitet në shtëpi dhe e emërton atë si diçka krejtësisht të ndryshme (p.sh.: tregon rrobat e varura në litar dhe thotë "Po bëj drekën"). Tjetri tregon atë që tha i mëparshmi, duke e emërtuar atë si një aktivitet tjetër.</p> |
| | <p>Prindërve u jepet një Fletë vlerësimi për të plotësuar dhe në fund nga një certifikatë.</p> |

5. Fletë pune

Fletë pune (FP) 1: Çfarë është kultura?



Burri dhe gruaja nuk janë vetëm vetvetja; ato janë gjithashtu lagjja në të cilën kanë lindur, banesa apo ferma ku kanë mësuar të ecin, lojërat që kanë luajtur si fëmijë, historitë që kanë dëgjuar, ushqimi që kanë ngrënë, shkolla që kanë vijuar, sportet që kanë ndjekur, poetët që kanë lexuar dhe perëndinë në të cilin kanë besuar.

Somerset Maugham

FP 2: Kuiz kulturor

| | |
|--|--|
| 1. Çfarë do të thotë <i>Shukar Dive</i> ? | |
| 2. Si quhet muaji i agjërimit te myslimanet? | |
| 3. Si quhet personazhi i përrallave popullore maqedonase i cili vazhdimisht i vë në majë të gishtit të tjerët? | |
| 4. Cila kafshë shfaqet më shpesh në simbolet shqiptare? | |
| 5. Emërtoni të paktën dy instrumente që përdoren në muzikën tradicionale rome! | |
| 6. Cili është emri i vërtetë i Skënderbeut? | |
| 7. Si quhet në turqisht qyteti i Manastirit? | |
| 8. Çfarë ushqimi nuk duhet të hanë besimtarët ortodoksë gjatë agjërimit? | |
| 9. Si quhet veshja tradicionale e grave rome? | |
| 10. Theksoni një valle tradicionale maqedonase! | |
| 11. Në cilat bashkësi etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut përgatitet bakllavaja për kremtime? | |
| 12. Cili alfabet ka më pak shkronja ndërmjet alfabeve maqedonase, shqipe dhe turke? | |
| 13. Në cilin muaj të vitit festohet dita e Shën Gjergjit? | |
| 14. A lejohet myslimanët të pinë ujë gjatë ditës, përderisa agjërojnë? | |
| 15. Çfarë do të thotë <i>Merhaba</i> ? | |

FP 2: Kuiz kulturor – përgjigje

| | |
|--|------------------------------|
| 1. Çfarë do të thotë <i>Shukar Dive</i> ? | Mirëdita (në gjuhën rome) |
| 2. Si quhet muaji i agjërimit te myslimanët? | Ramazani |
| 3. Si quhet personazhi i përrallave popullore maqedonase i cili vazhdimisht i vë në majë të gishtit të tjerët? | Itar Pejo |
| 4. Cila kafshë shfaqet më shpesh në simbolet shqiptare? | Shqiponja |
| 5. Emërtoni të paktën dy instrumente që përdoren në muzikën tradicionale rome! | daulle, dajre, fizarmonikë |
| 6. Cili është emri i vërtetë i Skënderbeut? | Gjergj Kastrioti |
| 7. Si quhet në turqisht qyteti i Manastirit? | Manastiri |
| 8. Çfarë ushqimi nuk duhet të hanë besimtarët ortodoksë gjatë agjërimit? | Me prejardhje shtazore |
| 9. Si quhet veshja tradicionale e grave rome? | Shalvare |
| 10. Përmendni një valle tradicionale maqedonase! | Pajdushka, Pravo, Eleno Mome |
| 11. Në cilat bashkësi etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut përgatitet bakllavaja për kremtime? | Të gjitha |
| 12. Cili alfabet ka më pak shkronja ndërmjet alfabeve maqedonase, shqipe dhe turke? | Turke (29 shkronja) |
| 13. Në cilin muaj të vitit festohet dita e Shën Gjergjit? | Maj |
| 14. A lejohet myslimanët të pinë ujë gjatë ditës, përderisa agjërojnë? | Jo |
| 15. Çfarë do të thotë <i>Merhaba</i> ? | Përshëndetje (në turqisht) |

FP 3: Mësimi i fëmijëve në familje për të respektuar kulturat e tjera

Si duhet të jenë librat?

Si duhet të jenë lodrat dhe lojërat?

Çfarë mund të bëhet në kohën e lirë?

Me cilët fëmijë duhet të ketë kontakt dhe si duhet të jetë ai?

Si mund të jenë vetë prindërit një shembull pozitiv identifikimi?

FP 3: Mësimi i fëmijëve në familje për të respektuar kulturat e tjera - përgjigje

Si duhet të jenë librat? Si duhet të jenë lodrat dhe lojërat?

Të përfshihen personazhe nga kultura të ndryshme të portretizuara në një rol kompetent, me ndërveprim pozitiv me njëri-tjetrin, duke zbuluar ngjashmëri dhe dallime midis kulturave...

Çfarë mund të bëhet në kohën e lirë?

Të shikohen seriale për fëmijë në të cilat ka pjesëtarë të kulturave të ndryshme, shfaqje televizive për ta, duke vizituar objekte dhe monumente të rëndësishme të kulturave të ndryshme, duke dëgjuar muzikë nga kultura të ndryshme...

Me cilët fëmijë duhet të ketë kontakt dhe si duhet të jetë ai?

Kontakt duhet të ketë me fëmijë që i përkasin kulturave të ndryshme, të krijohet një ndërveprim i barabartë me ta, kontakt sa më të rregullt dhe të zgjasë më shumë...

Si mund të jenë vetë prindërit një shembull pozitiv identifikimi?

Të mësojnë fëmijën për kulturën e vet dhe kulturat e tjera, të reagojnë kur shprehen ose manifestohen paragjykime, të nxisin kontakte të fëmijës me fëmijët e kulturave të tjera në baza më të rregullta dhe më të gjata, për të qenë një shembull pozitiv identifikimi për fëmijën, të zhvillojnë bisedë të hapur për ngjashmëritë dhe dallimet mes kulturave sa herë që jepet mundësia dhe pa bërë vlerësime...

FP 4: Njohuri shkencore për zhvillimin e fëmijës

| | |
|---|------------|
| <p>19.Zhvillimi i trurit është kumulativ.</p> <p>Zhvillimi i disa kapaciteteve është baza për zhvillimin e mëvonshëm të kapaciteteve të tjera.</p> | <p>S P</p> |
| <p>20.Në periudhën e hershme fëmija ka mundësitë më të mëdha për zhvillim.</p> <p>Kur një fëmije i sigurohet zhvillim dhe mësim cilësor më herët, sigurohen rezultate më të qëndrueshme.</p> | <p>S P</p> |
| <p>21.Mjedisi nuk ndikon në zhvillimin e trurit.</p> <p>Truri i fëmijës nuk zhvillohet në varësi të faktit nëse ka një përvojë pozitive, negative apo mungesë të përvojës fizike/mendore me objekte, vende dhe veçanërisht me njerëz nga mjedisi i tij.</p> | <p>S P</p> |
| <p>22.Fëmija lind me nevojën për lidhje shoqërore me njerëzit e tjerë.</p> <p>Kultura ndikon më tej se si do të zhvillohet kjo lidhje – cilat rregulla, mënyra dhe natyra e ndërveprimit shoqëror do të ushqehen.</p> | <p>S P</p> |
| <p>23.Prindërit janë mësuesit më të rëndësishëm të fëmijës.</p> <p>Zhvillimi dhe mësimi i një fëmije ndikohet nga shumë njerëz (të afërm, fqinjë, miq, edukatorë), por më së shumti nga prindërit (nëna dhe babai), ndërveprimi i të cilëve me të është që në moshë të hershme dhe ofron më shumë mundësi për ndikim, ndërsa përvoja prej saj më pas ndikon në ndërveprimet e fëmijës me të tjerët në mjedis.</p> | <p>S P</p> |
| <p>24.Fëmija zhvillohet më mirë kur mjedisi ka krijuar marrëdhënie të forta afektive me të (kujdes, dashuri, siguri, mbështetje).</p> <p>Fëmija është më i gatshëm të zbulojë dhe vërë në dyshim karakteristikat e ndryshme të mjedisit dhe të zhvillohet përmes atij procesi kur mjedisi ka krijuar me të marrëdhënie të ngrohta, edukative, të përgjegjshme, të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe karakteristikat e fëmijës.</p> | <p>S P</p> |
| <p>25.Një fëmijë nuk lind kureshtar.</p> <p>Fëmija nuk dëshiron të mësojë dhe e di që në lindje.</p> | <p>S P</p> |
| <p>26. Fëmija lind me kompetenca.</p> <p>Fëmija nuk zhvillon kompetenca në varësi të cilësisë së lartë që i kërkon mjedisi dhe nëse ai e mbështet zhvillimin e tyre duke e trajtuar fëmijën si plot me potencial për zhvillim.</p> | <p>S P</p> |
| <p>27. Kur ka harmoni në veprimtaritë edukative në familje dhe kopsht, përfitimet për fëmijën janë më të mëdha.</p> <p>Ndërtimi i bashkëpunimit dhe partneritetit cilësor mes familjes dhe kopshtit mundëson bashkërendimin e veprimeve të tyre, duke nxitur zhvillimin e hershëm të çdo fëmije dhe përparim më të suksesshëm.</p> | <p>S P</p> |

FP 4: Njohuri shkencore për zhvillimin e fëmijës - përgjigje

| | |
|--|-------------------------------|
| <p>15.Zhvillimi i trurit është kumulativ.</p> <p>Zhvillimi i disa kapaciteteve është baza për zhvillimin e mëvonshëm të kapaciteteve të tjera.</p> | <p>S P</p> |
| <p>16.Në periudhën e hershme fëmija ka mundësitë më të mëdha për zhvillim.</p> <p>Kur një fëmije i sigurohet zhvillim dhe mësim cilësor më herët, sigurohen rezultate më të qëndrueshme.</p> | <p>S P</p> |
| <p>17. Mjedisi nuk ndikon në zhvillimin e trurit.</p> <p>Truri i fëmijës nuk zhvillohet në varësi të faktit nëse ka një përvojë pozitive, negative apo mungesë të përvojës fizike/mendore me objekte, vende dhe veçanërisht me njerëz nga mjedisi i tij.</p> | <p>S P</p> |
| <p>18. Fëmija lind me nevojën për lidhje shoqërore me njerëzit e tjerë.</p> <p>Kultura ndikon më tej se si do të zhvillohet kjo lidhje – cilat rregulla, mënyra dhe natyra e ndërveprimit shoqëror do të ushqehen.</p> | <p>S P</p> |
| <p>19. Prindërit janë mësuesit më të rëndësishëm të fëmijës.</p> <p>Zhvillimi dhe mësimi i një fëmije ndikohet nga shumë njerëz (të afërm, fqinjë, miq, edukatorë), por më së shumti nga prindërit (nëna dhe babai), ndërveprimi i të cilëve me të është që në moshë të hershme dhe ofron më shumë mundësi për ndikim, ndërsa përvoja prej saj më pas ndikon në ndërveprimet e fëmijës me të tjerët në mjedis.</p> | <p>S P</p> |
| <p>20. Fëmija zhvillohet më mirë kur mjedisi ka krijuar marrëdhënie të forta afektive me të (kujdes, dashuri, siguri, mbështetje).</p> <p>Fëmija është më i gatshëm të zbulojë dhe vërë në dyshim karakteristikat e ndryshme të mjedisit dhe të zhvillohet përmes atij procesi kur mjedisi ka krijuar me të marrëdhënie të ngrohta, edukative, të përgjegjshme, të udhëhequra nga nevojat, interesat dhe karakteristikat e fëmijës.</p> | <p>S P</p> |
| <p>21. Një fëmijë nuk lind kureshtar.</p> <p>Fëmija nuk dëshiron të mësojë dhe e di që në lindje.</p> | <p>S P</p> |
| <p>8.Fëmija lind me kompetenca.</p> <p>Fëmija nuk zhvillon kompetenca në varësi të cilësisë së lartë që i kërkon mjedisi dhe nëse ai e mbështet zhvillimin e tyre duke e trajtuar fëmijën si plot me potencial për zhvillim.</p> | <p>S P</p> |
| <p>9.Kur ka harmoni në veprimtaritë edukative në familje dhe kopsht, përfitimet për fëmijën janë më të mëdha.</p> <p>Ndërtimi i bashkëpunimit dhe partneritetit cilësor mes familjes dhe kopshtit mundëson bashkërendimin e veprimeve të tyre, duke nxitur zhvillimin e hershëm të çdo fëmije dhe përparim më të suksesshëm.</p> | <p>S P</p> |

FP 5: Çfarë është prindërimi pozitiv?

Prindërimi pozitiv është:

a) kujdesi prindëror që fëmija të jetë i shëndetshëm, i sigurt, i ushqyer siç duhet

b) prindi të **monitorojë** fëmijën dhe t'u **përgjigjet** nevojave dhe interesave të tij

| 1-5 | FAZAT |
|-----|--|
| 1 | Prindi lidhet me fëmijën (është i gatshëm të investojë emocionalisht tek ai). |
| 2 | Fëmija ka nevoja (për të ushqyerit, sigurinë, përfshirjen sociale, stimulimin konjitiv, rregullimin dhe kanalizimin e emocioneve). |
| 3 | Fëmija jep sinjale (buzëqeshje, lëvizje, zëra, gjeeste, kërkesa verbale). |
| 4 | Prindi monitoron sinjalet që jep fëmija, i interpreton ato dhe reagon në përputhje me rrethanat. |
| 5 | Fëmija mëson dhe zhvillohet. |

Kur prindi e ndjek fëmijën dhe i përgjigjet nevojave dhe interesave të tij, atëherë fëmija ndjen siguri emocionale, ngrohtësi, besim, shëndet fizik dhe mendor, në vend të stresit dhe ankthit.

c) prindi duhet ta **mbështesë** fëmijën për të eksploruar dhe komunikuar me rrethin


| 1-5 | FAZA |
|-----|---|
| 1 | Prindi beson se fëmija mund të zhvillojë shkathtësi të ndryshme. |
| 2 | Prindi krijon mundësi për fëmijën, që në moshë më të hershme, të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në bazë të kapaciteteve zhvillimore, përvojës dhe interesave të tij. |
| 3 | Fëmija merr pjesë në aktivitete të ndryshme. |
| 4 | Prindi monitoron pjesëmarrjen e fëmijës në aktivitete, e nxit dhe nuk i nënvlerëson aftësitë e tij, duke i parë ato nga këndvështrimi i tij. |
| 5 | Fëmija zhvillon aftësitë e tij, ndërsa ato i mundësojnë pjesëmarrje më cilësore në të ardhmen. |

Kur fëmija merr pjesë në aktivitete të ndryshme, ai ndjen se mendimi i tij është i rëndësishëm, zhvillon respekt të ndërsjellë, sheh se pjesëmarrja e tij mund të çojë në ndryshime, kontribuon në diçka që prindërit e konsiderojnë të rëndësishme, zhvillon respekt për veten, arsyetim, të menduarit, planifikim, parashikim, aftësinë për të shprehur, kuptuar të tjerët, realizon ndërvarësinë, ndërton përgjegjësi, mëson të zgjidhë probleme...


FP 6: Bingo

| | | | |
|--|--|---|--|
| <p>ju pëlqen të zgjoheni herët (po ose jo)</p> <p>_____</p> | <p>keni vëlla/motër (po ose jo)</p> <p>_____</p> | <p>festa më e rëndësishme në familje</p> <p>_____</p> | <p>rrjeti social që përdorni më së shumti</p> <p>_____</p> |
| <p>ushqimi që hani më shpesh</p> <p>_____</p> | <p>ndiqni politikën (po ose jo)</p> <p>_____</p> | <p>pini kafe me fqinjët (po ose jo)</p> <p>_____</p> | <p>shenja në horoskop</p> <p>_____</p> |
| <p>detyra e shtëpisë që e urreni më së shumti</p> <p>_____</p> | <p>jetoni në shtëpi apo banesë</p> <p>_____</p> | <p>aktiviteti i preferuar në kohë të lirë</p> <p>_____</p> | <p>lloji i preferuar i muzikës</p> <p>_____</p> |
| <p>ajo që ju mërzit më shumë tek njerëzit</p> <p>_____</p> | <p>shtetin që dëshironi të vizitoni</p> <p>_____</p> | <p>paratë nga "java e lotarisë" do ti shpenzonit për</p> <p>_____</p> | <p>më shumë gëzoheni kur</p> <p>_____</p> |

FP 7: Fotografia e fëmijës sime



FP 8: Përshkrimi i fëmijës sime



FP 9: Mësimi i fëmijës përmes lojës

4. Fëmija vëren diçka interesante në mjedis dhe:

- a) kthen kokën anash dhe bën sikur nuk ekziston.
- b) shikon stimulën dhe i linden shumë pyetje për shkak të zgjimit të kureshtjes natyrore.

5. Pas një kohe të shkurtër, fëmija:

- a) dëshiron të hulumtojë në mënyrë aktive për të gjetur përgjigje për pyetjet.
- b) thotë me vete: "Nuk më intereson, çfarë të dojë, le të jetë!"

6. Prindi vëren interesin e shprehur për fëmijën dhe:

- a) me gëzim, besim, ngrohtësi dhe respekt për këndvështrimin e tij, ai e drejton atë në atë përvojë, sepse ai e kupton se është një mundësi e mirë që fëmija të mësojë diçka.
- b) acarohet dhe i thotë: "Aman, ty të intereson çdo gjë e gjallë, nuk kam fare rehati". E gjete pikërisht tani, kur kam gjëra më të mira për të bërë!"

13. Mandej prindi:

- a) hap kompjuterin dhe i paraqet fëmijës gjithçka që lidhet me atë që e ka interesuar në terma mjaft profesionale ose i thotë: "Kur të rritesh, atëherë do të të them!"
- b) fillon një lojë me fëmijën sepse e di që është mënyra më e natyrshme e të mësuarit për të.

14. Lojën e fillon:

- a) gjithmonë prindi.
- b) mund ta fillojë dhe fëmija duke thirrur prindin me sinjale të ndryshme (i afrohet, i merr/i jep një lodër ose një send, tregon me gisht, emërton...).

15. Nëse prindi e filloi lojën, atëherë fëmija:

- a) pohon vullnetarisht nëse dëshiron të marrë pjesë.
- b) patjetër të marrë pjesë.

16. Kur fëmija luan vetë, atëherë prindi:

- a) kurrë nuk duhet të ndërhyjë në lojë.
- b) mund t'i bashkohet lojës për ta zgjatur dhe vazhduar atë duke shtuar lodra ose materiale, duke siguruar hapësirë, duke ftuar të tjerët të bashkohen.

17. Gjatë lojës, prindi:

- a) ka fjalën kryesore; vetëm ai flet dhe përcakton se çfarë dhe si të vazhdojë loja, ndërsa fëmija vetëm dëgjon.
- b) e drejton në mënyrë diskrete; nxit kureshtjen, kreativitetin dhe dëshirën e fëmijës për të luajtur, e ndihmon atë të organizojë përvojën e tij nëpërmjet monitorimit dhe vëzhgimit të kujdesshëm të lojës, e interpreton atë, e thellon dhe e orienton të fitojë kompetenca të reja.

18. Derisa zgjat loja, fëmija:

- a) mund të ndryshojë – të jep, të merr.
- b) nuk guxon të ndryshojë asgjë.

19. Loja e prindit dhe e fëmijës mund të zhvillohet:

- a) në çdo kohë dhe hapësirë.
- b) në një kohë dhe hapësirë të përcaktuar më parë.

20. Loja luhet:

- a) vetëm me lodra të shtrenjta dhe libra me figura.
- b) me çdo gjë (fruta, perime, pjata, kuti, gurë, rërë, degë, gjethe, fjalë, fotografi, libra, gazeta, karrige...).

21. Loja duhet të jetë e tillë që fëmija:

- a) të kënaqet, gëzohet, argëtohet, të eksplorojë.
- b) mërzitet, shikon orën dhe mezi pret të mbarojë.

FP 9: Mësimi i fëmijës përmes lojës – përgjigje

13. Fëmija vëren diçka interesante në mjedis dhe:

a) kthen kokën anash dhe bën sikur nuk ekziston.

b) shikon stimulin dhe i linden shumë pyetje për shkak të zgjimit të kureshtjes natyrore.

14. Pas një kohe të shkurtër, fëmija:

a) dëshiron të hulumtojë në mënyrë aktive për të gjetur përgjigje për pyetjet.

b) thotë me vete: "Nuk më intereson, çfarë të dojë, le të jetë!"

15. Prindi vëren interesin e shprehur për fëmijën dhe:

a) me gëzim, besim, ngrohtësi dhe respekt për këndvështrimin e tij, ai e drejton atë në atë përvojë, sepse ai e kupton se është një mundësi e mirë që fëmija të mësojë diçka.

b) acarohet dhe i thotë: "Aman, ty të intereson çdo gjë e gjallë, nuk kam fare rehati". E gjete pikërisht tani, kur kam gjëra më të mira për të bërë!"

16. Mandej prindi:

a) hap kompjuterin dhe i paraqet fëmijës gjithçka që lidhet me atë që e ka interesuar në terma mjaft profesionale ose i thotë: "Kur të rritesh, atëherë do të të them!"

b) fillon një lojë me fëmijën sepse e di që është mënyra më e natyrshme e të mësuarit për të.

17. Lojën e fillon:

a) gjithmonë prindi.

b) mund ta fillojë dhe fëmija duke thirrur prindin me sinjale të ndryshme (i afrohet, i merr/i jep një lodër ose një send, tregon me gisht, emërton...).

18. Nëse prindi e filloi lojën, atëherë fëmija:

a) pohon vullnetarisht nëse dëshiron të marrë pjesë.

b) patjetër të marrë pjesë.

19. Kur fëmija luan vetë, atëherë prindi:

a) kurrë nuk duhet të ndërhyjë në lojë.

b) mund t'i bashkohet lojës për ta zgjatur dhe vazhduar atë duke shtuar lodra ose materiale, duke siguruar hapësirë, duke ftuar të tjerët të bashkohen.

20. Gjatë lojës, prindi:

a) ka fjalën kryesore; vetëm ai flet dhe përcakton se çfarë dhe si të vazhdojë loja, ndërsa fëmija vetëm dëgjon.

b) e drejton në mënyrë diskrete; nxit kureshtjen, kreativitetin dhe dëshirën e fëmijës për të luajtur, e ndihmon atë të organizojë përvojën e tij nëpërmjet monitorimit dhe vëzhgimit të kujdesshëm të lojës, e interpreton atë, e thellon dhe e orienton të fitojë kompetenca të reja.

21. Derisa zgjat loja, fëmija:

a) mund të ndryshojë – të jep, të merr.

b) nuk guxon të ndryshojë asgjë.

22. Loja e prindit dhe e fëmijës mund të zhvillohet:

a) në çdo kohë dhe hapësirë.

b) në një kohë dhe hapësirë të përcaktuar më parë.

23. Loja luhet:

a) vetëm me lodra të shtrenjta dhe libra me figura.

b) me çdo gjë (fruta, perime, pjata, kuti, gurë, rërë, degë, gjethe, fjalë, fotografi, libra, gazeta, karrige...).

24. Loja duhet të jetë e tillë që fëmija:

a) të kënaqet, gëzohet, argëtohet, të eksplorojë.

b) mërzitet, shikon orën dhe mezi pret të mbarojë.

FP 10: Leximi me fëmijën

Imagjinoni një situatë ku një prind dhe një fëmijë "lexojnë" një libër së bashku! Ti je ai fëmijë!

Përgjigjuni pyetjeve më poshtë se si do të dëshironit të shkonte ajo në mënyrë që të ndiheni rehat, të argëtoheni dhe të zhvilloni kompetencat tuaja!

14.Si duhet të duket dhoma në të cilën do të "lexoni" së bashku?

15.Si do të dëshironit të uleshit me prindin?

16.Kush duhet ta mbajë librin?

17.Çfarë do të dëshironit të mund të bënit me librin?

18.Si duhet ta lexojë prindi tekstin për ta bërë atë interesant?

19.Dëshironi të diskutoni se për çfarë bëhet fjalë në libër? Dëshironi të ndjeheni të lirë të bëni pyetje? Kush duhet t'i bëj pyetje? Kush dhe si t'u përgjigjet atyre? Kur – gjatë leximit dhe/ose pas leximit?

20.Do të dëshironit gjithmonë që vetëm prindi t'ju ftojë të lexoni bashkë, apo do të ndiheni të lirë që ju të merrni iniciativë? Si do ta iniconit atë? Nga cilat shenja të juaja një prind mund të shohë se ju pëlqen të "lexoni" së bashku?

21. Kush dëshironi të vendos se çfarë dhe kur të lexoni?


22. Ku do të dëshironit të ishin librat? Në cilën dhomë? Në çfarë lartësie?

23. Do të dëshironit të shihni një libër përmes të cilit do të njihni një kulturë të ndryshme nga ajo juaja dhe fëmijë me karakteristika dhe aftësi të ndryshme?

24. Çfarë do të fitonit ju si fëmijë nga vetë përmbajtja e librit dhe çfarë në lidhje me prindin me të cilin keni "lexuar" së bashku ashtu siç keni shkruar më lart se dëshironi?

25. Përveç librave, çfarë tjetër mund të "lexoni" së bashku me prindin?

26. Përveç në shtëpi, në cilat vende të tjera mund të "lexoni" së bashku?



FP 10: Leximi me fëmijën – përgjigje

Imagjinoni një situatë ku një prind dhe një fëmijë "lexojnë" një libër së bashku! Ti je ai fëmijë!

Përgjigjuni pyetjeve më poshtë se si do të dëshironit të shkonte ajo në mënyrë që të ndiheni rehat, të argëtoheni dhe të zhvilloni kompetencat tuaja!

14. Si duhet të duket dhoma në të cilën do të "lexoni" së bashku?

Televizor të fikur, pa shpërqendrime të tjera.

15. Si do të dëshironit të uleshit me prindin?

Afër njëri-tjetrit; të dy të mund ta shohin bukur librin, por edhe fytyrat e tyre.

16. Kush duhet ta mbajë librin?

Të dy.

17. Çfarë do të dëshironit të mund të bënit me librin?

Duke treguar, duke kthyer faqet, duke vënë atë në gojë.

18. Si duhet ta lexojë prindi tekstin për ta bërë atë interesant?

Me shpejtësi dhe intonacion të përshtatshëm, duke ndryshuar zërin aty ku është e nevojshme...

19. Dëshironi të diskutoni se për çfarë bëhet fjalë në libër? Dëshironi të ndjeheni të lirë të bëni pyetje? Kush duhet t'i bëj pyetje? Kush dhe si t'u përgjigjet atyre? Kur – gjatë leximit dhe/ose pas leximit?

Po, bisedë dhe pyetje gjatë leximit dhe pas tij, të dyja palët mund të bëjnë lirisht pyetje, të priten përgjigjen nga fëmija, të jepen përgjigje të qarta nga prindi.

20. Do të dëshironit gjithmonë që vetëm prindi t'ju ftojë të lexoni bashkë, apo do të ndiheni të lirë që ju të merrni iniciativë? Si do ta iniconit atë? Nga cilat shenja të juaja një prind mund të shohë se ju pëlqen të "lexoni" së bashku?

Që edhe fëmija të mund të inicojë duke ftuar verbalisht prindin ose duke treguar/duke sjellur librin...

21. Kush dëshironi të vendos se çfarë dhe kur të lexoni?

Fëmija.

22. Ku do të dëshironit të ishin librat? Në cilën dhomë? Në çfarë lartësie?

Në çdo dhomë në të cilën fëmija do të ketë qasje të lehtë dhe në një lartësi të përshtatshme për t'i arritur ato.

23. Do të dëshironit të shihni një libër përmes të cilit do të njihni një kulturë të ndryshme nga ajo juaja dhe fëmijë me karakteristika dhe aftësi të ndryshme?

Po, fëmija njihet me dallimet dhe i pranon ato si një pjesë normale e jetës së përditshme dhe botës.

24.Çfarë do të fitonit ju si fëmijë nga vetë përmbajtja e librit dhe çfarë në lidhje me prindin me të cilin keni "lexuar" së bashku ashtu siç keni shkruar më lart se dëshironi?


Pasurim të fjalorit, zhvillim të shkrim-leximit, të gjuhës shprehëse, zhvillim të të folurit, imagjinatës, të menduarit kritik, praktikim të përqendrimit, nxitje të zgjidhjes së problemeve, njohje të kulturave të veta dhe të tjera, me fëmijë me karakteristika dhe aftësi të ndryshme...; ndjenja se është i/e denjë për vëmendje, ndjenja se prindi kujdeset për nevojat dhe interesat e fëmijës, argëtim...

25.Përveç librave, çfarë tjetër mund të "lexoni" së bashku me prindin?

Prospektet e dyqaneve, gazeta, revista...

26.Përveç në shtëpi, në cilat vende të tjera mund të "lexoni" së bashku?

Në park, në bibliotekë, në supermarket, në librari, në transport publik...



FP 11: Përralla e princeshës, princit dhe Olafit

Na ishte një herë një **princeshë** dhe një **Olaf**. **Princeshës** i pëlqente të vishte fustane të bukur, ndërsa **Olafit** i pëlqenin shumë përqaqimet.

Një ditë u shfaq një **princ** në pyll. **Olafi** nuk e pëlqeu **princin** sepse ai nuk donte të përqafohej, mbante një armë gjahu dhe sillej i rëndësishëm.


Por, **princesha** e pëlqeu shumë **princin** dhe ra në dashuri me të.

Olafi ishte shumë i trishtuar dhe i vetmuar.

Kur erdhi dimri, **Olafi** pa një flollë dëbore. Ajo ishte e ndritur dhe e bukur dhe ai zbuloi se asaj i pëlqente edhe të përqafohej.

Princesha vuri re që **Olafi** kishte rënë në dashuri dhe i kërkoi **princit** që të bënte që dimri të zgjaste përgjithmonë. **Princi** bleu një pallat në Polin e Veriut dhe atje **princesha**, **princi**, **fjolla e borës** dhe **Olafi** jetuan të lumtur së bashku deri në fund të jetës së tyre.

FP 12: Mësimnxënia e fëmijëve nëpërmjet pjesëmarrjes në rutinat dhe ritet familjare



Shkruani se çfarë mund të mësojë fëmija nëse prindi e përfshin në mënyrë aktive në rutinën e tij të larjes/blerjes/pazarit!

PYETËSOR PËR PRINDËR PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT
“MBËSHTETJE PRINDËRVE TË FËMIJËVE NGA MJEDISE TË LLOJLLOJSHME
SHUMËKULTURORE”

Të nderuar prindër,

Para jush është një pyetësor vlerësimi që është anonim, ndaj ju kërkohet të jepni përgjigje të sinqerta. Përgjigjet do të përdoren ekskluzivisht për vlerësimin dhe përmirësimin e Programit.

Ju lutemi rrethoni një numër në shkallë nga 1 deri në 4 që shpreh më mirë mendimin tuaj për secilin pohim më poshtë.

1-Nuk pajtohem

2-pjesërisht pajtohem

3-Shumë pajtohem

4-Plotësisht pajtohem

Ju falënderojmë paraprakisht!

| | Pohimi | Vlerësimi |
|-----|---|------------------|
| 1. | Programi i përmbushi pritjet e mia | 1 2 3 4 |
| 2. | Punëtoritë më bënë të ri-mendoj prindërimin tim | 1 2 3 4 |
| 3. | Mësova shkathtësi të reja (lidhja, monitorimi, pranimi) | 1 2 3 4 |
| 4. | Shkëmbeva përvoja me prindër të tjerë | 1 2 3 4 |
| 5. | U ndjeva rehat dhe e pranuar nga të tjerët në punëtoritë | 1 2 3 4 |
| 6. | Tashmë fotografia për fëmijën tim është ndryshe | 1 2 3 4 |
| 7. | Tani lexoj më shpesh me fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 8. | Tani e kam të qartë se si të inkurajoj mësimin dhe zhvillimin e fëmijës tim në shtëpi | 1 2 3 4 |
| 9. | Fëmija im sheh ndryshim | 1 2 3 4 |
| 10. | Ndjej se jam një prind më i suksesshëm | 1 2 3 4 |
| 11. | I identifikoj më mirë nevojat e fëmijës sime | 1 2 3 4 |
| 12. | Luaj më shpesh me fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 13. | Vërej pika të forta tek fëmija im që nuk i njihja më parë | 1 2 3 4 |
| 14. | Fëmija im po sheh një ndryshim | 1 2 3 4 |
| 15. | Di se si stresi ndikon në prindërimin tim | 1 2 3 4 |
| 16. | Kur bëj diçka në shtëpi, di si ta përfshij fëmijën tim | 1 2 3 4 |
| 17. | E kuptova më mirë ndëshkimit fizik | 1 2 3 4 |
| 18. | I vërej pikat e mia të forta dhe pikat e forta të familjes sonë | 1 2 3 4 |
| 19. | E njoh rëndësinë që të dy prindërit të kujdesen për fëmijën | 1 2 3 4 |
| 20. | Mendoj se si të kujdesem për veten si prind | 1 2 3 4 |
| 21. | Di se çfarë është zhvillimi i hershëm i fëmijës dhe pse është i rëndësishëm | 1 2 3 4 |
| 22. | Si prind kam më shumë vetëbesim | 1 2 3 4 |
| 23. | Në vendim tim, ekzistojnë shumë njerëz dhe burime në të cilat mund të mbështetem | 1 2 3 4 |

Gjithsej, në sa punëtori keni marrë pjesë? -----

Literatura

1. Bunting L., (2004) Parenting Programmes: The Best Available Evidence, *Child. Care in Practice*, 10:4, 327–343.
2. Berk, L. E. (2008). *Psihologija cjeloživotnog razvoja*. Jastrebarsko: Naklada Slap.
3. Black M., Aboud F. (2011). Responsive feeding is embedded in a theoretical framework of responsive parenting. *The Journal of Nutrition*, 141(3), 490–494.
4. Black MM, Walker SP, Fernald LCH, Andersen CT, DiGirolamo AM, Lu C, McCoy DC, Fink G, Shawar YR, Shiffman J, Devercelli AE, Wodon QT, Vargas-Barón E, Grantham-McGregor S; Lancet Early Childhood Development Series Steering Committee. Early childhood development coming of age: science through the life course. *Lancet*. 2017 Jan 7;389(10064):77–90. doi: 10.1016/S0140-6736(16)31389-7. Epub 2016 Oct 4. PMID: 27717614; PMCID: PMC5884058.
5. Britto PR, Lye SJ, Proulx K, et al. *Nurturing care: promoting early childhood development*. *Lancet*. 2017; 389 (10064): 91–102.
6. Carbera N. (2020). Father involvement, father-child relationship and attachment in the early years. *Attachment and human development*, 22(1), 134–138.
7. Cummings M.E., Cummings J. (2002). Parenting and attachment. in: M. Bornstein (ed) *Handbook of parenting*. Lawrence Erlbaum Associates Pub., 35–55.
8. Dalli, C., White, E.J., Rockel, J., & Duhn, I. (2011). Quality early childhood education for under-two-year-olds: What should it look like? A literature review. Wellington: Victoria University of Wellington.
9. De Wolf M, van Ijzendoorn M (1997). Sensitivity and attachment: a meta-analysis of parental antecedents of infant attachment. *Child Development*, 68(4), 571–591.
10. Eshel N., Daelmans B., Cabral de Mello M., Martines J. (2006). Responsive parenting: interventions and outcomes. *Bulletin of World Health Organization*, 84, 991–998.
11. Esposito, G., Setoh, P., Shinohara, K., & Bornstein, M.H. (2017). The development of attachment: Integrating genes, brain, behavior, and environment. *Behavioural Brain Research*, 325, Part B, 87–89.
12. Moran, P. et al (2004), What works in parenting support: a review of the international evidence, London. <http://www.prb.org.uk/wwiparenting/RR574.pdf>.
13. Pettit, Gregory S; Bates, John E; Dodge, Kenneth A. (1997) *Supportive Parenting, Ecological Context, and Children's Adjustment: A Seven-Year Longitudinal Study*, Wiley.
14. Richter L. (2004). The importance of caregiver-child interactions for the survival and health development of young children: a review. Geneva: World Health Organization.
15. Rohner, R. P. i Khaleque, A. (2010). Testing Central Postulates of Parental Acceptance – Rejection Theory (PARTheory): A Meta – Analysis of Cross – Cultural Studies. *Journal of Family Theory & Review*, 2, 73–87.
16. Shonkoff JP, Phillips DA, eds. (2006). *From neurons to neighborhoods: the science of early child development*. Institute of Medicine. Washington (DC): National Academy Press.
17. Slade, A. (2006). Reflective parenting programs: Theory and development. *Psychoanalytic Inquiry*, 26(4), 640–657. <https://doi.org/10.1080/07351690701310698>
18. Britto PR, Lye SJ, Proulx K, et al. *Nurturing care: promoting early childhood development*. *Lancet*. 2017; 389 (10064): 91–102.
19. Colić, V. i Milošević, G. (2019): Učešće roditelja i vaspitača u igri dece, U: D. Pavlović Brenešević, G. Stepić i I. Prlić (ur.), *Zbornik radova "Inicijalno obrazovanje i stručno usavršavanje"*

- vaspitača - partnerstvo u građenju kvaliteta* (str. 160-175), Sremska Mitrovica, Visoka škola strukovnih studija za vaspitače i poslovne informatičare u Sremskoj Mitrovici.
20. Chen, F. (2017). Everyday family routine formation: A source of the development of emotion regulation in young children. In *Perezhivanie, Emotions and Subjectivity* (pp. 129–143). Springer, Singapore.
 21. Cummings M.E., Cummings J. (2002). Parenting and attachment. in: M. Bornstein (ed) *Handbook of parenting*. Lawrence ErlbaumAssociates Pub., 35–55.
 22. Dalli, C., White, E.J., Rockel, J., & Duhn, I. (2011). Quality early childhood education for under-two-year-olds: What should it look like? A literature review. Wellington: Victoria University of Wellington.
 23. De Wolf M, van Ijzendoorn M (1997). Sensitivity and attachment: a meta-analysis of parental antecedents of infant attachment. *Child Development*, 68(4), 571–591.
 24. Eshel N., Daelmans B., Cabral de Mello M., Martines J. (2006). Responsive parenting: interventions and outcomes. *Bulletin of World Health Organization*, 84, 991–998.
 25. Esposito, G., Setoh, P., Shinohara, K., & Bornstein, M.H. (2017). The development of attachment: Integrating genes, brain, behavior, and environment. *Behavioural Brain Research*, 325, Part B, 87–89.
 26. Ferretti, L.K., & Bub, K.L. (2017). Family routines and school readiness during the transition to kindergarten. *Early Education and Development*, 28(1), 59–77.
 27. Gardašević, A., (2021). Koliko je podržano dete u igri u kućnim uslovima. *Pedagoška stvarnost*, 67(1),26-40.
 28. Guichard, S., & Grande, C. (2019). The role of environment in explaining frequency of participation of pre-school children in home and community activities. *International Journal of Developmental Disabilities*, 65(2), 108–115.
 29. Krnjaja, Ž. (2010): Igra, stvaralaštvo, otvoreni vaspitni sistem: šta ih povezuje? *Nastava i vaspitanje*, God. 59, Br. 2, 264-277.
 30. Lester, S., W. Russel (2008): *Play for a Change: Play, Policy and Practice: A review of contemporary perspectives*. London: Play England of contemporary perspectives. London: Play England.
 31. Marjanović, A. (1987): Dečja igra i stvaralaštvo, *Predškolsko dete 1-4*, 85-101 *Nastava i vaspitanje*, God. 59, Br. 2, 264-2.
 32. Mancini, M.C., & Coster, W.J. (2004). Functional predictors of school participation by children with disabilities. *Occupational Therapy International*, 11(1), 12–25.
 33. Moran, P. et al (2004), What works in parenting support: a review of the international evidence, London. <http://www.prb.org.uk/wwiparenting/RR574.pdf>.
 34. Pešikan, A., Antić, S. (2012). Učenje i razvoj na ranim uzrastima. *Standardi za razvoj i učenje dece ranih uzrasta u Srbiji*. Beograd: Institut za psihologiju Filozofskog fakulteta: UNICEF, 85-113.
 35. Ren, L., & Fan, J. (2019). Chinese preschoolers' daily routine and its associations with parent-child relationships and child self-regulation. *International Journal of Behavioral Development*, 43(2), 179–184.
 36. Rosenberg, L., Jarus, T., & Bart, O. (2010). Development and initial validation of the Children Participation Questionnaire (CPQ). *Disability and Rehabilitation*, 32(20), 1633–1644.
 37. Richter L. (2004). The importance of caregiver-child interactions for the survival and health development of young children: a review. Geneva: World Health Organization.
 38. Shonkoff JP, Phillips DA, eds. (2006). *From neurons to neighborhoods: the science of early child development*. Institute of Medicine. Washington (DC): National Academy Press.
 39. Slade, A. (2006). Reflective parenting programs: Theory and development. *Psychoanalytic Inquiry*, 26(4), 640–657. <https://doi.org/10.1080/07351690701310698>.

40. van Kleeck, A., Gillam, R.B., Hamilton, L., & McGrath, C. (1997). The Relationship Between Middle-Class Parents' Book-Sharing, Discussion and Their Preschoolers' Abstract Language Development. *Journal of Speech, Language and Hearing Research*, 40(6), 1261-1271. 10.1044/jslhr.4006.1261.
41. Alzyoud, M. S., Khaddam, A. F. & Al-Ali, A. S. (2016). The impact of teaching tolerance on students in Jordanian schools. *British Journal of Humanities and Social Sciences*, 15, 33-52.
42. Berk, L. E. (2008). *Psihologija cjeloživotnog razvoja*. Jastrebarsko: Naklada Slap.
43. Britto PR, Lye SJ, Proulx K, et al. *Nurturing care: promoting early childhood development*. *Lancet*. 2017; 389 (10064): 91-102.
44. Delors, J. (1998). *Učenje blago u nama*. Zagreb: Educa.
45. Hidalgo, N. 1993. Multicultural teacher introspection. U: Parrz, T. And Fraser, I. (Eds.) *Freedom's Plow: Teaching in The Multicultural Classroom*. New York: Routledge.
46. Mancini, M.C., & Coster, W.J. (2004). Functional predictors of school participation by children with disabilities. *Occupational Therapy International*, 11(1), 12-25.
47. Rosenberg, L., Jarus, T., & Bart, O. (2010). Development and initial validation of the Children Participation Questionnaire (CPQ). *Disability and Rehabilitation*, 32(20), 1633-1644.
48. Shonkoff JP, Phillips DA, eds. (2006). *From neurons to neighborhoods: the science of early child development*. Institute of Medicine. Washington (DC): National Academy Press.
49. Tejlor, Č. (2003). *Politika priznanja*, u: Gatman, Ejmi (ur.), *Multikulturalizam - ispitivanje Politike priznanja*, Novi Sad, Centar za multikulturalnost.
50. York, S. (2003). *Roots and Wing: Affirming Culture in Early Childhood Programs*. St. Paul, MN: Redleaf Press.
51. Alzyoud, M. S., Khaddam, A. F. & Al-Ali, A. S. (2016). The impact of teaching tolerance on students in Jordanian schools. *British Journal of Humanities and Social Sciences*, 15, 33-52.
52. Banda, D.R., Hart, S.L., & Liu-Gitz, L. (2010). Impact of training peers and children with autism on social skills during center time activities in inclusive classrooms. *Research in Autism Spectrum Disorders*, 4, 619-625.
53. Barnett, D., Clements, M., Kaplan-Estrin, M., & Fialka, J. (2003). Building new dreams: supporting parents' adaptation to their child with special needs. *Infants and Young Children*, 16, 184-200.
54. Berk, L. E. (2008). *Psihologija cjeloživotnog razvoja*. Jastrebarsko: Naklada Slap.
55. Beresford, B., Rabiee, P., & Sloper, P. (2007). *Outcomes for parents with disabled children*. *Research Works*, 2007-03, Social Policy Research Unit, University of York: York.
56. Britto PR, Lye SJ, Proulx K, et al. *Nurturing care: promoting early childhood development*. *Lancet*. 2017; 389 (10064): 91-102.
57. Boström, P. K., Broberg, M., & Hwang, P. (2010). Parents' descriptions and experiences of young children recently diagnosed with intellectual disability. *Child: Care, Health and Development*, 36(1), 93-100.
58. Crnic, K. A., Friedrich, W. N., & Greenberg, M. T. (2002). Adaptation of families with mentally retarded children: A model of stress, coping, and family ecology. *Best of AADD: Families and developmental delay: AA collection of notable AADD journal articles across the 20th century*, 105-117.
59. Dyson, L. L. (1993). Response to the presence of a child with disabilities: Parental stress and family functioning over time. *American Journal of Mental Retardation*, 98, 207-218.
60. Delors, J. (1998). *Učenje blago u nama*. Zagreb: Educa.
61. George C., Solomon J. (2008). The caregiving system: a behavioral systems approach to parenting. in: J.Cassidy & P. Shaver (Eds.). *Handbook of attachment: Theory, research and clinical applications*. New York, London, Guilford press (pp.833-856).
62. Krstić, T. (2013). *Majke hronično ometene dece: Prihvatanje dijagnoze i prevladavanje stresa*. Neobjavljena doktorska disertacija, Univerzitet u Novom Sadu.

63. Krstić, T., & Oros, M. (2012). Coping with stress and adaptation in mothers of children with cerebral palsy. *Medicinski Pregled*, 9-10, 373-377.
64. Lazarus, R. (2003). The Lazarus manifesto for positive psychology and psychology in general. *Psychological Inquiry*, 14, 173-189.
65. Landgrige, P. (2002). Reduction of chronic sorrow: a healthy promotion role for children's community nurses? *Journal of Child Health Care*, 6(3), 157-170.
66. Leonard, B. J., Brust, J. D., & Nelson, R. P. (1993). Parental distress: caring for medically fragile children at home. *Journal of Pediatric Nursing*, 8, 22-30.
67. Marvin RS, Pianta RC. Mothers' reactions to their child's diagnosis: relations with security of attachment. *J Clin Child Psychol* 1996; 25:436-45.
68. Radoman, V. (2003): Učenici s razvojnim smetnjama u novoj školi po meri deteta; u J. Šefer, S. Maksić i S. Joksimović (prir.): *Uvažavanje različitosti i obrazovanje* (65-70). Beograd: Institut za pedagoška istraživanja.